

# PLANI ZHVILLIMOR I KOMUNËS SË KLINËS

II.

*PROPOZIMI*

KOMUNA E KLINËS

URBAN PLUS – studio e planifikimit dhe dizjanit urban



*Ky dokument është hartuar në periudhën gusht 2010-dhjetor 2012, nga studio e planifikimit dhe dizajnit urban URBAN PLUS në bashkëpunim me Komunën e Klinës, si rezultat i vlerësimeve të gjendjes ekzistuese, hulumtimeve si dhe takimeve dhe punëtorive të njëpasnjëshme.*

#### **URBAN PLUS**

Studio e planifikimit dhe dizajnit urban  
“UÇK”, 50/1-1, Prishtinë  
tel/fax: +381 (0) 38 246 056  
[info@urbanplus.com](mailto:info@urbanplus.com)  
[ee.urban-plus.com](http://ee.urban-plus.com)

## PËRMBAJTA

### **1.0 VIZIONI, PRINCIPET DHE QËLLIMET**

1.1 VIZIONI PËR KOMUNËN DHE QYTETIN NË DISA DOKUMENTE TË RËNDËSISHME TË HARTUARA PËR KOMUNËN E KLINËS

1.1.1 Plani Hapësinor I Kosovës

1.1.2 Strategjia për zhvillim rajonal- rajoni ekonomik perëndim 2010-2013

1.1.3 Projekti për shfrytëzimin e tokës bujqësore- ALUP

1.1.4 Plani zhvillimor urban i Klinës

1.2 SHTYLLAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT

1.3. PARIMET E PËRGJITHAHME TË ZHVILLIMIT

1.4. QËLLIMET AFATGJATA TË ZHVILLIMIT

1.5 PRIORITETET STRATEGJIKE

### **2.0 KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR**

2.1 KONCEPTI I ZHVILLIMI HAPËSINOR

2.1.1 FUNKSIONET E ZONAVE

2.1.2 QENDRAT DHE FUNKSIONET E TYRE SHËRBYESE

2.1.3 MOBILITETI DHE RRJETI I TRAFIKUT

### **2.2 STRUKTURA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR**

#### **2.2.1 ZHVILLIMI EKONOMIK**

2.2.1.1 AGRIKULTURA

2.2.1.2. TURIZMI

2.2.1.3 NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

#### **2.2.2 STRUKTURA E VENDBANIMEVE**

2.2.2.1 PARASHIKIMET DEMOGRAFIKE

2.2.2.2 ADMINISTRIMI TERRITORIAL

2.2.2.3 ZGJERIMI I VENDBANIMEVE

2.2.3 MOBILITETI DHE RRJETI I TRAFIKUT

2.2.3.1 RRJETI RRUGOR

**2.2.4 INFRASTRUKTURA SOCIALE**

2.2.4.1 ARSIMI

2.2.4.2 INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

2.2.4.3 INSTITUCIONET E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE ADMINISTRATIVE

2.2.4.4 SPORTI DHE REKREACIONI

**2.2.5 INFRASTRUKTURA TEKNIKE**

2.2.5.1 FURNIZIMI ME UJË I VENDBANIMEVE

2.2.5.2 RRJETI I KANALIZIMIT

2.2.5.3 FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE DHE TELEKOMUNIKIMIET

2.2.5.5 MENAXHIMI I MBETURINAVE

**2.2.6 MJEDISI DHE PEIZAZHI**

2.2.6.1 TRASHËGIMIA DHE RESURSET NATYRORE

2.2.6.2 PEIZAZHI

2.2.7 RREZIQET

2.2.7.1 MASAT E MBROTJES

**2.3 SHËNIMI I ZONAVE URBANE EKZSITUËSE DHE TË PROPOZUAR PËR ZHVILLIMIN E ARDHSHËM DHE NDËRTIMIN E ZONAVË JASHTË ZONËS URBANE**

**2.4 SHËNIMI I NDËRTIMEVE TË RËNDËSISHME, PROJEKT STRATEGJIK OSE ZONA TË VEÇANTA TË APROVUARA NË PLANIN HAPËSINOR TË KOSOVËS OSE PLANET TJERA**

**2.5 VLERËSIMI I NDIKIMIT SOCIO-EKONOMIK DHE MJEDISOR TË KORNIZËS SË PROPOZUAR**

**3.1 STRATEGJITË DHE VEPRIMET E IMPLEMENTIMIT**

**3.1.1 STRATEGJITË DHE VEPRIMET E ZHVILLIMIT EKONOMIK**

3.1.1.1 AGRIKULTURA

3.1.1.2 TURIZMI

3.1.1.4 NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

**3.1.2 STRATEGJITË DHE VEPRIMET E SISTEMIT TË TRAFIKUT DHE TRANSPORTIT**

**3.1.3 POPULLSIA, BANIMI DHE VENDBANIMET**

**3.1.4 STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR INFRASTRUKTURËN SOCIALE**

3.1.4.1 ARSIMI

3.1.4.2 SHËNDETËSIA

3.1.4.3 QENDRAT LOKALE TË KOMUNITETIT

3.1.4.4 KULTURA

3.1.4.5 SPORTI DHE REKREIMI

### **3.1.5 STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR INFRASTRUKTURËN TEKNIKE**

3.1.5.1 FURNIZIMI ME UJË

3.1.5.2 SISTEMI I KANALIZIMIT

3.1.5.3 FURNIZIMI ME RRYMË DHE RRJETI I TELEKOMUNIKIMIT

### **3.1.6 STRATEGJITË DHE VEPRIMET MJEDISORE DHE PEIZAZHORE**

#### **3.1.7 ZONAT E RREZIKSHME**

3.1.7.1 MASAT MBROJTËSE

### **3.1.8 PROJEKTET E RËNDËSISHME STRATEGJIKE APO NDËRTIMORE SI DHE ZONAT E VEÇANTA TË APROVUARA NË PLANIN HAPËSINOR TË KOSOVËS**

## **3.2 KORNIZA KOHORE, IMPLIKIMET FINANCIARE, KORNIZA INSTITUCIONALE**

### **4.0 DISPOZITAT PËR ZBATIM**

#### **4.1 UDHËZIME MBI ÇËSHTJET E INTERPRETIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR TË KOMUNËS GJATË HARTIMIT TË PLANEVE RREGULLUESE DHE PLANEVE TJERA**

#### **4.2 KUSHTE TË PËRCAKTUARA NGA QEVARIA LOKALE MBI ÇËSHTJE TË RËNDËSISHME PËR ZHVILLIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E TOKËS NË KOMUNË**

4.2.1. KUSHTET PËR PËRCAKTIMIN E DESTINIMIT TË SIPËRFAQEVE NË TERRITORIN E KOMUNËS

4.2.2 KUSHTET PËR RREGULLIMIN E HAPËSIRËS

4.2.3 KUSHTET PËR VENDOSJEN E VEPRIMTARIVE EKONOMIKE

4.2.4 KUSHTET PËR VENDOSJEN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE

4.2.5 KUSHTET PËR VENDOSJEN E KORRIDOREVE APO TRASEVE, SIPËRFAQEVE KOMUNIKUESE DHE SISTEMEVE TJERA TË INFRASTRUKTURËS

4.2.6 MASAT PËR MBROJTJEN E PEIZAZHEVE, VLERAVE NATYRORE DHE TËRËSIVE KULTURO-HISTORIKE

4.2.7 MËNYRA E TRAJTIMIT TË HEDHURINAVE

4.2.8. MASAT PËR PENGIMIN E NDIKIMEVE TË DËMSHME NË MJEDIS

4.2.9 MASAT PËR PARANDALIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE SOCIALE

4.2.10 MASAT PËR ZBATIMIN E PLANIT

**4.3. DISPOZITAT LIDHUR ME KONSULTIMIN, BASHKËPUNIMIN DHE PJSËMARRJEN;**

**4.4 DISPOZITAT MBI RENDIN KRONOLOGJIK APO ETAPAT E IMPLEMENTIMIT**

**4.5 DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

***Listat e figurave, tabelave dhe hartave.***

*Fig.1. Shtyllat kryesore të zhvillimit të komunës*

*Fig.2. Koncepti*

*Fig.3. Zonat kryesore*

*Fig.4 Vendbanim I shprëndarë- Gremiku*

*Fig.5 Vendbanim I përqëndruar- Volljakë*

*Fig.6 Vendbanim me Zonë të Veçantë të mbrotjur- Budisalci*

*Fig.7. Vendbanimet joformale (gjendja 2013)*

*Tab 1. Tipet e qendrave me numrin e banorëve për zonën e mbulimit për shërbime*

*Tab 2. Numri i banorëve nëpër qendra dhe zona e mbulueshmërisë*

*Tab.3 Kategorizimi i rrugëve*

*Tab.4. Trafostacionet aktuale dhe të propozuara në vendbanime*

*Harta 1. Shfrytëzimi i tokës.*

*Harta 2. Organizimi territorial*

*Harta 3. Rrjeti rrugor*

*Harta 4. Infrastruktura sociale*

*Harta 5. Rrjeti i ujësjellësit*

*Harta 6. Rrjeti i kanalizimit*

*Harta 7. Rrjeti aktual dhe ai i propozuar i SEE dhe SK në komunën e Klinë*

*Harta 8,9,10 Zonat e Veçanta të Mbrojtura.*



## 1.0 VIZIONI



## 1.0 VIZIONI

### 1.1 VIZIONI PËR KOMUNËN DHE QYTETIN NË DISA DOKUMENTE TË RËNDËSISHME TË HARTUARA PËR KOMUNËN E KLINËS

#### 1.1.1 Plani Hapësinor I Kosovës

Në bazë të shkoqitjes hapësinore të zonave me veçanti të përbashkëta gjeografike, ekonomike dhe sociale, Klina I takon zonës së quatjur “Kopshtet e Kosovës”, të cilat karakterizohen si hapësira kulturore-turistike, shërbyese-tregtare dhe agroindustriale.

Vizioni për këtë zonë është : *“Zonë e zhvilluar kulturo-historike, agroindustriale dhe tregtare, zhvilluar në rrenjët dhe traditat e lashta, me qeveri locale të përgjegjshme dhe efikase, në bashëkpunim me qytetarët e saj dhe aktorët për zbatim të qëllimeve zhvillimore më shfrytëzim të resurseve natyrore dhe njerëzore, posaçërisht ën fushën e turizmit, afarizmit e bujqësisë”.*

Qëllimet e përgjithshme janë:

- Zhvillimi i rrjetit atraktiv të qyteteve të planfikuara
- Mbështetje e zhvillimit ekonomik lokal me promovim të NVM-ve, shfrytëzim të përparësisve konkurruese
- Zhvillimin e lidhjeve efikase brendaurbane, ndërurbane, rrjetit të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, TI-së)
- Qeverisje dhe administratë lokale efikase dhe përkrahëse në synimet për zhvillim
- Zhvillimi i turizmit malor e kulturor, veprimtarive industrial, shërbyese e tregtare, me mbrojtje të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.
- Bashkëpunim ndërkufitar për zhvillim me interest e épërbashkëta.<sup>1</sup>

#### 1.1.2 Strategjia për zhvillim rajonal - Rajoni Ekonomik ëPerëndim 2010-2013

Agjencioni për zhvillim rajonal i mbështetur nga BE-ja për zhvillimin rajonal ekonomik, ka hartuar strategjinë e parë për zonën ekonomike pernëdimore të Kosovës e cila përfshinë 6 komuna: të Gjakovës, Junikut, Deçanit, Pejës, Istogut dhe të Klinës. Kjo strategji ëepërfshinë një marrëveshje mbi një vizion të qartë për të ardhmen e këtij rajoni. Janë identifikuar 4 prioritete të zhvillimit rajonal:

- Krijimi i kushteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik
- Stimulimi i një baze innovative dhe konkurruese të biznesit
- Zhvillim i kapitalit njerëzor në rajonin perëndimor të Kosovës

---

<sup>1</sup> Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Instituti I Planifikimit Hapësinor (2010) PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS-STRATEGJIA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR 2010-2020. Faqe 153-155.

- Zhvillimi i qëndrueshëm i bazuar në komunitet.

Nga analizat e profilit rajonal të mbështetura në të dhënrat e grumbulluara është përcaktuar një vizion i cili bazohet në bukuritë natyrore dhe pozitën strategjike si përparësi kryesore të rajonit. Nga këto ka rezultuar ***vizioni i rajonit perëndimor të Kosovës si një vend për të jetuar, punuar, pushuar dhe investuar për të ardhmen*** i cili bazohen në:

- Zhvillimin e kontrolluar dhe të duhur në tri zonat: malet, zonën zhvillimore (grupe të bazuar në korridorin rajonal të transportit Istog-Gjakovë) dhe zonën e bujqësore.
- Një linjë qarkulluese e transportit rajonal kryesisht e bazuar në hekurudhat ekzistuese dhe lidhjet ‘kyçë’ dhe të ringjallura; Klinë-aeroporti ndërkombëtar dhe Prishtinë; Prizren-Shqipëri; Junik-Gjakovë-Shqipëri; Deçan-Shqipëri-Malii zi; Pejë-Mali i zi dhe Istog-Mitrovicë-Serbi.
- Cilësi ëe lartë e jetës për banorët e saj.<sup>2</sup>

### 1.1.3 Projekti për shfrytëzimin e tokës bujqësore- ALUP

Projekti për menaxhimin e tokave rurale të komunës së Klinës përshkruan zhvillimet e dëshiruara në 10 vitet e ardhshme ku vëmendje të posaçme i kushtohet fshatërave. Plani për menaxhimin e tokave rurale si mjet për përmirësimin e kualitetit të mjedisit nuk është destinuar vetëm për përmirësimin e bujqësisë por paraqet edhe mjetet strategjike për përmirësimin e strukturës së zonave rurale, pylltarisë, natyrës, peizazhit, rekreacionit në natyrë dhe mjedisin. PMTR-ja është në përputhje me prioritetet e planifikimit hapësinor kombëtar, vendor dhe komunal dhe garanton një politikë të planifikimit të qëndrueshëm. Komponente kryesore janë planet për veprim në mjedis dhe planet sektoriale.

Janë 11 planet të veprimit që mbulojnë fushën e bujqësisë, pylltarisë dhe mjedisit:

- Plani i veprimit në bujqësi përfshinë çështjet e shkallës së ultë të prodhimtarisë dhe sistemit bujqësor, ujites, plleshmërisë së tokës dhe ndotjes së tokës, ndërtimit në tokën bujqësore, vështirësitë ne marketingun e prodhimit bujqësor, sigurisë së ushqimit, kapitalit investues për ësfermerë, mundësisë së të hyrave jashtë fermës në zonat rurale, keqorganizmi i fermerëve që rezulton me përfimtime të vogla nga projektet dhe inovacionet.
- Plani i veprimit ënë pylltari përshinë çështjet e prerjes ilegale të drunjëve nga toka e APK-së, keqësimit të kualitetit të pyjeve dhe humbjes së habitatit të botës shtazore në étokat e APK-së dhe ëato private, pamundësia e ofrimit të të ardhurave nga potencialet

<sup>2</sup> “STRATEGJIA PËR ZHVILLIM RAJONAL PËR RAJONIN EKONOMIK PERËNDIM”. Projekt i financuar nga BE-ja , menaxhuar nga zyrja ndërlidhëse e Komisionit Evripian dhe implementuar nga WEST Regional Development Agency .fq 18

e pyjeve për pronarët vendor privat ose të NSH-ve, mosshfrytëzimi i tokës së APK-së për qëllime të pylltarisë.

- Plani i veprimit në mjedis për ujërat përfshinë çështjet si furnizimi me ujë dhe kualiteti i tij, ujërat e zeza komunale dhe industriale të cilat, të patrajtura, shkarkohenënë lumenjë dhe épërrska, ndotja e rrjedhave ujore nga mbeturinat shtëpiake dhe industriale, humbja e sasisve të mëdha ujore nga popullata dhe mbrojtja nga përmbytjet.
- Plani i veprimit në mjedis për mbeturinat trajton çështjet si: hudhja e pakontrolluar e mbeturinave shtëpiake në veçanti në zonat rurale, hudhja jo e drejtë e mbeturianve të rrezikshme kimike dhe biologjike.
- Plani i veprimiti në mjedis për energjinë dhe kualitetin e ajrit trajton çështjen e furnizimit të parregullt dhe joefikas me energji, ndotja e ajrit si rezultat i djegieve të të gjitha llojeve të mbeturinave.
- Plani i veprimiti në mjedis lidhur me ruajtjen e natyrës përfshinë çështjet e mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore, Kanjonin e Mirushës si parkën natyrore, nxjerrja e rërës dhe zhavorit nga shtretërit e lumenjëve dhe brigjeve të tyre, erozioni i dheut në tokën bujqësore dhe tokën pyjore të shpyllëzuar.<sup>3</sup>

#### 1.1.4 Plani zhvillimor urban i Klinës

Vizioni sipas Planit Zhvillimor Urban e orienton zhvillimin e qytetit duke u bazuar në potencialet e Klinës dhe duke investuar në zhvillimin e tyre si dhe mbrojtje. Duke u artikuluar me synimet strategjike për zhvillim, vizioni, qytetin e Klinës e parashev si “qytet bujqësor”, “eko-qytet” apo “qytet me turizëm ekologjik”. Qëllimet e të tri variantave janë: mbrojtja e tokës bujqësore, përkrahja e prodhimit bujqësor, përforcimi i balansit ekologjik, inkurajimi ëi agroturizmit, inkurajimi ëi ndërmarrjeve për të zhvilluar vikend-ëturizmin, përkrahje të themelimit të agjensioneve turistikë etj..

Deklarata e vizionit për qytetin e Klinës është: “*Klina, qytet me zhvillim të qëndrueshëm të bazuar në bujqësi, resurse natyrore dhe vlerat e trashëgimisë kulturore*”<sup>4</sup>

<sup>3</sup> N. Jewell, E.Krasniqi, A.Kusel, A. Zhuri (2007) PROJEKTI PËR MENAXHIMIN E TOKËS BUJQËSORE- PLANI PËR MENAXHIMIN E TOKAVE RURALE NË KLINË . faqe 77-95.

<sup>4</sup> Kuvendi Komunal I Klinës &Urban Plus (2005) PLANI ZHVILLIMOR URBAN- KLINË. Faqe 11.

## 1.2 SHTYLLAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT

Duke u bazuar në potencialet e janë theksuar katër shtylla kryesore mbi të cilat mund të ndëtohet vizioni i komunës së Klinës. Ato janë :

- BUJQËSIA- me tokën e punueshme, klimë dhe hidrografinë e zhvilluar
- TURIZMI- me pasuritë natyrore : monumentin e natyrës “Mirusha”, grykën e lumit Klinë, lumenjtë, trashëgiminë e pasur kulturore me rreth 70 monumente.
- INDUSTRIA-potenciale për industri përpunuese ose ushqimore, për përpunimin e drurit, gurit.
- NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME-pozita gjeografike, fuqia punëtore locale, biznese të orientuara kah potencialet ekzistuese.



Fig. shtyllat kryesore të zhvillimit- vizioni

## DEKLARATA E VIZIONIT

*“Komuna e Klinës - qendër rajonale e zhvillimit bujqësor, me shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve natyrore, nyje e transporrit rajonal, mikpritëse dhe atraktive, me qytetarë aktiv dhe të motivuar.”*

### 1.3. PARIMET E PËRGJITHSHME TË ZHVILLIMIT

Parimet e përgjithshme të zhvillimit mundësojnë një kornizë udhëzimesh të gjëra të cilat burojnë nga dokumente të rëndësishme të planifikimit dhe zhvillimit në nivelin lokal, kosovar, evropian dhe univerzal botëror:

- Ligji mbi Planifikimin Hapësinor
- Parimet Udhëzuese për zhvillimin e Qëndrueshëm Hapësinor të BE-ESDP
- Parimet e zhvillimit të qëndrueshëm– Agjenda 21

Më poshtë janë specifikuar parimet e rëndësishme për Planin Zhvillimor të komunës së Klinës.

Zhvillimi planifikuar hapësinor	Zhvillimi i ardhshëm i Klinës do të duhej të bazohet në plane dhe vendime të duhura
Zhvillimi i balancuar	Klina, për aq sa është e mundshme, duhet të synojë zhvillimin e balancuar në të gjitha trevat e komunës
Zhvillimi i qëndrueshëm	Ka për qëllim shfrytëzimin racional të resurseve natyrore dhe balancimin e zhvillimit social, ekonomik dhe mjedisor
Simulimi i sinergjive dhe shmangja e konflikteve potenciale	Princip i cili kërkon të integrojë zhvillimet nëpër sektorë të cilat mund të veprojnë më lehtë së bashku dhe balancojnë konfliktet potenciale të zhvillimit (p.sh. Me komunat fqinje ose me nivelin qendror)
Subsidiariteti	Gjatë implementimit të Planit Zhvillimor të komunës, komuna do të merr përgjegjësitet lidhur me vendimet e nivelit qendror ose ndërmarrë veprime të cilat mund të zbatohen në mënyrë më efikase në nivelin lokal të qeverisjes– delegimit hierarkik të përgjegjësive
Integrimet Evropiane	Zhvillimet e parapara me Planin Zhvillimor të komunës duhet t'i kontribuojnë integrimit të Kosovës në BE
Zhvillimi komplementar	Funksioni themelor i qendrës kryesore, subqendrës apo qendrës lokale është komplementar me funksionet në qendrat dhe fshatrat tjera.

## 1.4. QËLLIMET AFATGJATA TË ZHVILLIMIT

### MJEDISI DHE NATYRA

Mbrotja e tokës bujqësore:

→ndalimi i zgjerimit i vendbanimeve në tokën bujqësore (qyteti dhe fshatrat)

- mbrotja e tokës pyjore
- mbrojtja e burimeve ujore
- mbrojtja e ujërave dhe shtretërve të lumenjëve

→eliminimi i deponive joformale në lumenj dhe pranë rrugëve

→ndalimi i shfrytëzimi të pakontrolluar të zhavorrit

- mbrotja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore
- shfrytëzimi i energjisë alternative

### ZHVILLIMI SOCIAL

- Qeverisje efikase komunale

→shërbime efikase për qytetarë

- Ngritura e kualitetit të arsimit dhe shtrirja e arsimit fillor në tërë territorine komunës në
- Ngritura e kualitetit dhe shtrirja e shërbimeve shëndëtësore primare në tërë territorin e komunës
- Zhvillimi i arsimit profesional për t'i aftësuar të rinxjtë për punë në profesionet prodhuese
- Zhvillimi i kulturës dhe sportit dhe rekreacionit në Klinë dhe fshatra

### ZHVILLIMI EKONOMIK

- Politika stimuluese për zhvillimin e bujqësisë

→shtimi i vendeve të punës

→ngritura e prodhimit bujqësor – kulturat lokale të drithërave, pemëve dhe perimeve -

→krijimi i kushteve të përshtatshme për blegëtori

- Rivitalizimi i industrisë bujqësore – produktet themelore dhe përpunimi i prodhimeve
- Zhvillimi i tregëtisë dhe shërbimeve
- Zhvillimi i eko turizmit dhe turizmit kulturor

→krijimi i një bordi lokal të turizmit

### INFRASTRUKTURA


- Ndërtimi i një sistemi efikas të rrjetit të qarkullimit në tërë komunën

- rrugët rajonale dhe lokale
- rrugë transite
- rrjeti i trafikut në qytetin e Klinës
- rrjeti i qarkullimit për këmbësorë
- asfaltimi i rrugëve në brendi të fshatrave
  - Ndërtimi qendrës së mobilitetit në klinë - stacioni i autobusëve dhe hekurudhor
  - Ndërtimi i sistemit funksional të ujësjellësit në tërë territorin e komunës
  - Ndërtimi i i sistemit efikas të kanalizimit
- kanalizmi dhe trajtimi i ujërave të zeza
- kanalizimit i ujërave atmosferik
  - Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike
- infrastruktura e vjetruar e ujitjes

## 1.5 PRIORITETET STRATEGJIKE

- Mbrojtja e tokës bujqësore
- Kufizimi i zgjerimit të vendbanimeve
- Përkrahja e turizmit përmes hartimit të planeve rregulluese
- Mbrojtja e shumëlojshmërisë së peizazheve natyrore
- Ndërtimi i një sistemi të integruar të furnizimit me ujë për tërë komunën
- Ndërtimi i një sistemi të ri dhe të ndarë të kanalizimit fekal dhe atmosferik


## 2.0 KORNIZA E ZHVILLIMIT



## 2.0 KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

### 2.1 KONCEPTI I ZHVILLIMI HAPËSINOR

Gjatë identifikimit të problemeve dhe potencialeve në komunën e Klinës, janë e identifikuar tri zona të ndryshme të cilat diferencohen në mes veti përkah karakteristikat agro-ekologjike, gjeomorfologjike si edhe përkah rrjeti hierarkik i vendbanimeve bazuar në funksionin dhe ofrimin e shërbimeve dhe rrjetin e lidhjet e trafikut me vendbajmet brenda dhe jashtë territorit të komunës.



*Fig. Koncepti*

#### 2.1.1 FUNKSIONET E ZONAVE

##### ZONA 1 - ZONA E TOKËS BUJQËSORE

Zona e bujqësisë karakterizohet me tokë bujqësore kualitative, boniteti i së cilës i takon klasës 2,3 dhe 4 dhe me hidrografi të zhvilluar. Vetëm në këtë zonë kalojnë 3 lumenjtë kryesor si: Drini i Bardhë, Lumbardhi i Pejës dhe lumi Klina. Shtrihet në një territor kryesisht rrafshinor me lartësi mbidetare prej 349-435 m.

Kjo zonë mbulon afërsisht 17 % të territorit të komunës në të cilën shtrihen numri më i madh i vendbanimeve. Nga 54 vendbanime sa e përbëjnë komunën e Klinë, 21 prej tyre janë të shtrira në këtë zonë. Në kuadër të kësaj zone gjendet qytetii Klinës, si qendra kryesore administrative

dhe subqendra e Zllakuqanit, ku do të ofrohen shërbime të cilat ndikojnë në zhvillimin social dhe ekonomik të qendrave dhe vendbanimeve tjera.

Në këtë zonë kalojnë arteriet kryesore të qarkullimit rrugor, që në territorin e komunës së Klinës shtrihen në drejtimin lindje - perëndim dhe veri-jug.

Zgjerimi urban është në konflikt me agrikulturën për shkak të okupimit të tokës kualitative bujqësore, prandaj mbrojtja e tokës bujqësore duhet të konsiderohet si faktor i rëndësishëm gjatë alokimit të tokës për ndërtim. Bazuar në resurset, potencialet e zhvillimit dhe numrin e popullsisë që jeton dhe punon, kjo zonë është quajtur zona e bujqësisë.

Funksionet kryesore të zhvillimit për këtë zonë janë:

- Agrikultura – përfshi prodhimin dhe përpunimin
- Tregëtia
- Shërbimet kryesore

## ZONA 2- ZONA E KOMBINUAR

Karaterisohet me shumëlojshmëri të shfrytëzimit dhe potencial për zhvillimin e bujqësisë dhe blegorisë. Mbulon pjesën më të madhe të teritorit të komunës, rreth 55% në të cilën bëjnë pjesë 26 vendbanime. Shtrihet në një terren pjesërisht të ndryshueshëm prej 435-563 m, me tokë heterogjene, pjesërisht pyje dhe pjesërisht kullosa me potencial mesatar që kryesisht shfrytëzohet për prodhimtari blegtorale dhe kultura që ujiten me shira. Është Gllareva si subqendër ku do të ofrohen shërbime të cilat ndikojnë në zhvillimin social dhe ekonomik të qendrave të bashkësisë lokale dhe vendbanimeve tjera.

Sa i përket trafikut, në këtë zonë kalon rruga regionale për Skendaraj, e cila mundëson lidhjen me Skenderajn, Mitrovicën dhe pjesët tjera të veriut të Kosovës.

Bazuar në karakteristikat, shumëlojshmërinë e mjedisit dhe potencialet e zhvillimit kjo zonë është quajtur zonë e kombinuar, ku zhvillimi ekonomik mbështetet në:

- Agrikulturë- blegtori
- Apikultura
- Agroturizmi dhe turizmi rural
- Turizmi kulturor

### ZONA 3- ZONA PYJORE


Zona e emëruar “zona pyjore” përfshinë vendbanimet që shtrihen kryesisht në pjesën jugore dhe juglindore, me terren kryesisht të pjerrët me lartësi maskimale 734 m. Kjo paraqet njëherit edhe zonën me lartësi më të madhe mbidetare të territorit të komunës së Klinës, që përfshinë 28 % të sipërfaçes së tërësishme të komunës në 7 vendbane sa marrin pjesë në këtë zonë. Toka në këtë zonë i takon klasave 4-8. Njëra nga subqendrat që përfshirhen në këtë zonë është Sferka, fshtati i dytë më i madh për nga numri i banorëve, në të cilin gjenden shërbimet kryesore sociale dhe ekonomike që e shërbejnë këtë zonë.

Në këtë zonë kalon rruga nationale Prishtinë –Pejë, si arteria kryesore e qarkullimit rrugor.

Potencialet dhe resurset natyrore dhe ato nëntorkësore në këtë zonë mundësosjnë zhvillimin e një numri të madh të veprimtarive ekonomike. Bazuar në këto veprimtari funksionet kryesore të zhvillimit në këtë zonë janë:

- Natyra dhe turzimi (Mirusha, gryka e Klinës, trashëgimia natyrore, lumenjtë)
- Speleoturizmi (shprellat në kanjonin e Mirushës)
- Pylltaria
- Ndërtimtaria (guri në Gllarevë, pasuritë nëntokësore, industria e drurit)

Z1	TOKË BUJQËSORE	Z2	E KOMBINUAR	Z3	TOKË PYJORE
<p>Z1</p> <p>-TOKË KUALITATIVE -HIDROGRAFI E ZHVILLUAR -PRODHIMTARI POTENCIALE</p> <p>-349-435 m -Klasa 2</p> <p>-VENDBANIMET KRYESORE: Klina, Zllakuqani</p> <p>-LINJAT KRYESORE TË TRAFIKUT</p>	<p>Z2</p> <p>-POTENCIAL PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË -PESERISHT PYJE -PESERISHT KULLOSA</p> <p>-435-563 m -Klasa 3</p> <p>-VENDBANIMI KRYESOR: Ujëmiri</p> <p>-NEVOJË PËR PYLLËZIM</p>	<p>Z3</p> <p>-PYJE -RESURSE NËNTOKËSORE- Plakat gurore -MONUMENTI I NATYRËS "MIRUSHA" -GRYKA E LUMIT KLINE</p> <p>-563- 734 m -Klasa 4-8</p> <p>-VENDBANIMI KRYESOR: Sferkë</p> <p>-NEVOJË PËR PYLLËZIM</p>			



#### 2.1.2 QENDRAT DHE FUNKSIONET E TYRE SHËRBYESE

Qendrat e vendbaneve sigurojnë përbajtje dhe funksione të ndryshme të administratës, shërbime sociale dhe ekonomisë për banorët e vendbaneve dhe për zonat e mbulimit apo shërbimit rreth tyre. Zgjerimi i shërbimeve ose zonës së mbulimit varet nga veçoria dhe kualiteti i hapësirave për vendosjen e shërbimeve të cilat duhet të arrihen në kohë të përshatatshme të udhëtimit-arritjes. Kjo duhet të rezultojë me një hierarki qendrash me shkallë më të lartë apo më të ultë të përbatjeve dhe rrjedhimisht të zoanve më të vogla apo më të mëdha të

shërbimit. Mirëpo, çdo qendër me numër më të madh të shërbimeve përfshinë edhe shërbimet e qendrave të shkallës më të ultë dhe me një zonë më të vogël shërbimi.

Qëllimi i kësaj strukture qendrore të shërbimeve është sigurimi i shpërndarjes së përmbatjeve shërbyese në mënyrë të drejtë dhe të barabartë në një distancë të pranueshme të udhëtimit për të gjithë banorët e komuëns së Klinës.

Kjo hierarki e vendbnimeve që funksionon përmes qendrave d.m.th qendrës kryesore, subqednrës dhe qendrës locale, përbën bazën për marrjen e vendimeve për minimumin e funksioneve themelore shërbyese dhe vendosjen e objekteve për shërbimet shtesë, publike dhe private.

Për të krijuar një rrjet funksional të vendbanimeve në komunën e Klinës, është propozuar shkallëzimi i vandbanimeve sipas funksioneve dhe numrit të banorëve të cilat ato i shërbejnë:

- Qendra kryesore- urbane, mbi 25.000 banorë
- Sub-qendra , 10.000-25.000 banorë
- Qendra lokale, 3000-10.000 banorë.

Në bazë të këtyre të dhënave, rrjeti i vendbanimeve të komunës së Klinë përbëhet nga:

- Qendra kryesore urbane- Klina
- Sub-qendra- Zllakuqani, Gllareva, Grabanica, Sferka
- Qendra lokale- Budisalc, Ujëmiri, Shtupel, Jashanicë, Drenoc.

Kjo hierarki vendbanimesh duhet nënkuptuar në atë mënyrë që cdo subqendër por edhe qendra kryesore në të njëjtën kohë e luan rolin edhe të qendrave locale për zonat që gravitojnë në to. Zona e mbulimit të një qendre përfshinë largësinë të cilët banorët e kalojnë për të arritur në përmbajtet shërbyese që ofrohen aty. Zakonisht largësia e lëvizjes dhe koha jaën faktorët kryesor që ndikojnë në vendimin e banorëve se në cilën qendër do të shkojnë (shkuarja në qendrën më të afërt paraqet një cilësi të funksionimit të shërbimeve) dhe kjo nënkupton zonënë e mbulimit.

Tabela e mëposhtme paraqet zonat e mbulimit për funksione e cila varen nga distanca (udhëtimi dhe koha) si dhe qasja.

Qendra	Numri i banorëve						shkollë fillore	shkollë e mesme	QKMF	QMF	Amulancë					
	Zona e mbulimit/ shërbimeve sipas qendrave			si qendër kryesore	si subqendër	si qendër lokale										
<b>QENDRA KRYESORE</b>																
1	Klinë	5452 6390	36357 42611	10234 11995	7032 8242	2	2	1								
<b>SUB QENDRA</b>																
1	Zllakuqan	659 772		4899 5742	2333 2734	1			1							
2	Gillarevë	2196 2574		8126 9547	2678 3139	1				1						
3	Sferkë	2451 2884		4388 5142	4388 5142	1				1						
4	Grabanicë	728 854		6285 7366	2910 3411	1				1						
<b>QENDRA LOKALE</b>																
1	Budisalc	397 465			1091 1279	1				1						
2	Ujëmirë	544 638			5468 6409	1			1							
3	Jashanicë	1786 2093			3202 3753	1				1						
4	Shtupel	778 912			1475 1729	1				1						
5	Drenoc	442 518			3375 3956	1				1						

Tab. 1 Tipet e qendrave me numrin e banorëve për zonën e mbulimit për shërbime

### 2.1.3 MOBILITETI DHE RRJETI I TRAFIKUT

Kusht i domosdoshëm përfunksionimin e bazës ekonomike të një vendi është rrjeti funksional i trafikut. Ai shërben përlidhjen e njerëzve nga zonat e largëta malore në drejtim të subqendrave dhe Klinës, si qendër kryesore në komunë e Klinës.

Kategoritë e rrugëve të nivelit qëndror dhe lokal janë të përcaktuara sipas ligjit mbi rrugët nr.2003/11. Përfundimisht, rrugët nacionale dhe rajonale përgjegjëse është Ministria e Infrastrukturës. Në komunën e Klinës rrjeti rrugor përbëhet prej rrugëve që kategorizohen si nacionale, rajonale dhe lokale. Rruga nacionale Prishitnë-Pejë paraqet arterien kryesore të qarkullimit rrugor që në territorin e komunës shtrihet në drejtimin lindje-perëndim. Kjo rrugë nacionale mundëson lidhje me pjesët qëndrore dhe lindore të Kosovës, duke e përfshirë edhe kryeqytetin, ndërsa përmes degëzimeve mundëson lidhjen me shtetet fqinje, Maqedoninë dhe Serbinë. Në drejtimin perëndimor ajo mundëson lidhjen me Pejën si qendër regionale si dhe me Malin e Zi në vazhdim.

Rruga rajonale, sipas ligjit mbi rrugët, nënkupton rrugën publike e cila lidh qendrat me rëndësi ekonomike të dy apo më tepër rajoneve. Në komunën e Klinës janë: rruga rajonale për Gjakovë e cila mundëson lidhjen e Klinës me Gjakovën dhe Prizrenin si dhe në vazhdim me Shqipërinë; rruga rajonale për Istog që lidhet me rrugën nationale përmes zonës urbane të Klinës; rruga rajonale për Skendaraj, e cila mundëson lidhjen me Skendrajn, Mitrovicën dhe me pjesët tjera të veriut të Kosovës. Ky rrjet i rrugëve rajonale përveç që lidhë komunën e Klinës me komunat fqinje, ajo në vete përfshinë edhe qendërn kryesore lokale si dhe subqendrën e Gllarevës, Zllakuqanit. Ndërsa përmes nationales respektivisht rrugës kryesore lokale bëhet përfshirja e të gjitha qendrave në rrjetin e trafikut. Kjo përfshirje ka shumë rëndësi për një zhvillim të balancuar të komunës.

Rrjeti i rrugëve lokale, sipas ligjit mbi rrugët, janë rrugët që lidhin vendbanimet e një komune, ku kompetencë mbi kategorizimin dhe ndryshimin e tyre i takon qeverisë lokale. Nisur nga kjo si dhe koncepti i organizimit të rrjetit të rrugëve në nivel të komunës, rrugët lokale janë kategorizuar në:

- Rrugë kryesore lokale
- Rrugë lokale
- Rrugë tjera
- Rrugë malore

Rrjeti rrugor brenda komunës, në bazë të rëndësisë së lidhjeve funksionale në mes tyre, përbën bazën e diferencimit të standardeve kualitative të nevojshme për llojet e ndryshme të rrugëve dhe për përcaktimin e prioriteteve të përmirësimit të domosdoshëm si dhe vendimet për ndërtimin e rrugëve të reja. Rrjeti i trafikut brenda konceptit kryesor të zhvillimit ka për qëllim të përcaktojë hierarkinë e lidhjeve të rrjetit të vendbanimeve.

- Rrugë nationale Prishtinë-Pejë, éshtë korridor i cili lidh pjesët qëndrore dhe lindore të Kosovës duke e përfshirë edhe kryeqytetin, ndërsa përmes degëzimeve të mëtutjeshme mundëson lidhjen me shtetet fqinje. Maqedoninë, Malin e Zi dhe Sérbinë.
- Rrugët rajonale Klinë-Gjakovë, Klinë-Istog, Klinë-Skenderaj, janë korridore të cilat lidhin qendrën urbane dhe komunën e Klinës me komunat tjera. Korridoret e këtyre rrugëve kalojnë nëpër subqendrat Gllarevë e Zllakuqan ku së bashku me nacionalen dhe rruget kryesore lokale, krijojnë një rrjet efikas të transportit me ndikim në zhvillimin ekonomik dhe atë social.
- Rrugët kryesore lokale lidhin qendrat lokale në mes vedi si dhe me subqendrat. Koncepti i propozuar për këtë kategori parashev një rrugë përmbledhëse kryesore e cila kalon nëpër vendbanimet të cilat shtrihen në zonat më kufitare të komunës duke e krijuar një “unazë” *Gllarevë-Ujëmirë-Jashanicë-Shtupel-Zllakuqan-Budisalc-Drenoc-Grabanicë-Dollovë-Këpuz-Sferkë*. Qëllimi i këtij koncepti unazor éshtë zvogëlimi i largësisë së

vendbanimeve më të largëta si dhe të mundësojë afrimin e shërbimeve ndaj fshatrave dhe qendrave lokale duke kontribuar në zvogëlimin e migrimit dhe depopullimit të këtyre traveve.

- Rrugët locale bëjnë shkallëzimin e trafikut brenda rrjetit të përbërë nga rruget rajonale dhe kryesore locale dhe shërbejnë për lidhjen e të gjitha vendbanimeve me këto rruge. Këtu hyjnë të gjitha vednbanimet të cilat për shkak të pozitës apo ndonjë arsyet tjetër, nuk mund të kenë qasje të drejtpërdretjë me rruget kryesore locale.
- Rrugët tjera janë të gjitha lidhjet tjera që lidhin vendbanimet në mes veti.
- Rrugët malore

Një rrjet funksional i rruget do të pengonte zgjerimin e panevojshëm të vendbanimeve si dhe do ta ruante tokën bujqësore dhe peizazhet me vlerë ne territorin e komunës së Klinës.

## **2.2 STRUKTURA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR**

Kategoritë e shfrytëzimit të tokës së komunës janë:

1. Vendbanimet
2. Toka e punueshme
3. Vegjetacioni i lartë
4. Zonat me interest të veçantë
5. Lumenjtë
6. Sipërfaqet për transport
7. Qendrat

### **1. VENDBANIMET**

Sipërfaqja e vendbanimeve nënkupton sipërfaqen e ndërtuar të qednrës urbane Klinës, subqedrnave, qedrnave locale dhe fshatërave. Në kuadër të saj përfshihen banimi, infrastruktura sociale dhe fizike.

### **2. TOKA E PUNUESHME**

Paraqet tokën e cila është e shfrytëzuar për :

2a) BUJQËSI- që paraqet zonën e shfrytëzuar për kultiviin e kulturave të ndryshme bujqësore: arë, kopsht, pemishte, livadh, kullosë si dhe tokat tjera shfrytëzimi optimal i të cilave përfshinë prodhimin bujqësor dhe zhvillimin e blegtorisë duke marrë parasyh vetitë natyrore dhe kushtet ekonomike.

2b) KULLOSA- tokë e mbuluar kryesisht me vegjetacion natyror bimor e cila shërben për kullotjen, lëshuarjen dhe pushimin e bagëtisë.

### **3. VEGJETACIONI I LARTË**

Këtu përfshihen të gjitha sipërfaqet mbi 0.2 ha të populluara në mënyrë të dendur me bimësi drunore.

### **4. ZONAT ME INTEREST TË VEÇANTË**

Janë zonat të cilat për vlerat që i kanë ose shërbimet që i ofrojnë janë më interest ë posaçëm në nivel kombëtar:

4a) MONUMENTI I NATYRËS ‘MIRUSHA’- vlerë natyrore me interes kombëtar, resurs me potencial për zhvillimin e turizmit, speleoturizmit. Poashtu i rëndësishëm për zhvillimin e ekskurzioneve hulumtuese si për nevoja shkencore ashtu edhe ato arsimore.

4b) GRYKA E LUMIT KINA- nënkupton vlerë natyrore të çmuar me potencial për zhvillimin e turizmit. Për shkak të karakteristikave gjeomorfologjike, hidrologjike dhe botanike i rëndësishëm edhe për nevoja arsimore.

4c) RESURSET NËNTOKËSORE- rezerva të nevojshme për zhvillimin e miheve të mëdha të thengjillit, të rezervave të boksitit, zhavorrit dhe argjilles për prodhimin e tullave. Gjithashtu edhe të pllakave të gurit si identifikuase të komunës së Klinës.

4d) Manastiri i Budislacit

4e) Manastiri i Dollcit

4f) Hermitazhi me kishë apo Kisha e heremitëve

### **5. LUMENJTË**

Të gjitha ujërat sipërfaqësor të vazhdueshëm ose peridik siç janë: lumenjtë, pellgjet, liqenet dhe sipërfaqe të ngjajshme.

### **6. SIPËRFAQET PËR TRANSPORT**

Sipërfaqet për transport përbëhen nga korridoret për transport:

**6a) Rrugët nationale**- janë korridore të cilat lidhin Kosovën me vendet fqinje.

**6b) Rrugët rajonale**-nënkupton rrugën publike që lidh dy ose më shumë qytete të mëdha

**6c) Rrugët kryesore lokale**- janë rruget publike që lidhin qendrat e bashkësive lokale brenda komunës së Klinës.

**6ç) Rrugët lokale**- janë rruget publike që lidhin vendbaimet me rrugën kryesore lokale brenda komunës së Klinës.

**6d) Rrugët malore**- shfrytëzohet për mirëmbajten dhe monitorimin e zonave malore, pyjeve si dhe për zhvillimin e turizmit.


**6dh) Rrugët turistike**- paraqet rrugën publike që lidh pikat e rëdnësishme atraktive natyrore dhe kulturore në territorin e komunës.

## 7. QENDRAT

**7a) Qendra kryesore**- paraqesin qendrat urbane ku gjenden të gjitha shërbimet në nivel komunal

**7b) Subqendra**- janë qendra lokale ku ofrohen veprimtaritë shërbyese të decentralizuara me qëllim të zvogëlimit të qarkullimit të panevojshëm në drejtim të qednrës kryesore-Klinës, për shërbimet të cilat mund të ofrohen në kuadër të subqedrnave.

**7c). Qendrat lokale**- janë qendrat e bashkësisve lokale ku ofrohen shkërbimet në nivel të bashkësisë locale.



Harta 1. Shfrytëzimi i tokës.

## 2.2.1 ZHVILLIMI EKONOMIK

### 2.2.1.1 AGRIKULTURA

Parimet për zhvillimin e agrikulturës në komunën e Klinës duhet të bazohen në parimet e agrikulturës së qëndrueshme, e cila krahas zhvillimit ekonomik synon të arrijë edhe zhvillimin social dhe mbrojtjen e mjedisit. Ekonomia e qëndrueshme bazohet në ndërmarrje profitable me plan gjithëpërfshirës financiar, aktive në marketing dhe me menaxhim të rrezikut. Qëndrueshmëria sociale rezulton nga vendimet e mara bashkë me bujqë dhe blegtore, me qëllim që qarkullimi i parave të bëhet në ekonominë lokale dhe në mirëmbajtjen dhe përparimin e kualitetit të jetës së familjeve që merren me bujqësi, blegtori, bletari etj. Mjedisi i qëndrueshëm nënkupton – shfrytëzimin e energjisë nga aktivitetet dhe prodhimet bujqësore, shfrytëzimin e ujit dhe mineraleve, trajtimin e ujërave të zeza, trajtimin e mbeturinave përmes ricviklimit.

Bujqësi / blegtori e qëndrueshme do të thotë kultivimi i të korruarave dhe bagëtisë në atë mënyrë që të arrijnë tre objektiva në të njëjtën kohë:

- Përfitimin ekonomik
- Përfitimet sociale për familjet që merren me këtë veprimtari dhe komunitetin
- Konservimin e vlerave natyrore

Agrikultura është veprimtaria më e rëndësishme në komunën e Klinës. Kushtet jo të volitshme kanë ndikuar në shkallën e ulët të zhvillimit të agrikulturës në tërë Kosovën, e rrjedhimi sh edhe në Klinë.

Kredi jo të favorshme, politikë fiskale jo e përshtatshme, mungesa e subvencioneve për produktet vendore dhe taksa të larta të importit të farës dhe plehrave, përqindja e lartë e importit të produkteve bujqësore nga vendet fqinje me taksa të ulëta, janë faktorët kryesor që agrikulturën e bëjnë të jetë veprimtari me rrezik të madh. Rrezik tjetër me ndikim në agrikulturë konsiderohet humbja e tokës kualitative bujqësore, e shkaktuar nga zhvillimi i pa planifikuar. Nevojat për hapësira të banimit, sidomos pas luftës, si dhe situa e trashëguar pa plane zhvillimore urbane dhe komunale, janë arsyet kryesore për zgjerimin e pakontrolluar urban i cili ka pushtuar tokat kualitative në territorin e komunës së Klinës - sidomos në të ashtuquajturin rezervat bujqësor në Zonën Bujqësore. Humbja e tokës bujqësore nga ndërtimi shoqërohet edhe me problemet e ndotjes së shtuar. Derdhja e ujërave të zeza pa u trajtuar ndotin lumejt të cilët janë bazë për sistemin e ujitjes.

Plani Zhvillimor Komunal e vendos mbrojtjen e tokës kualitative bujqësore në krye të çështjeve me të cilat ky plan duhet të merret. Toka kualitative bujqësore duhet të mbrohet nga zhvillimet e paplanikuara, kurse zhvillimi i agrikulturës theksohet si një nga shtyllat e zhvillimit të komunës.

Qëllimet e mëposhtme vërtetojnë rëndësinë e saj:

- **Përqendrimi në përparësi**

Veprimtaritë e ndryshme të agrikulturës do të duhej të zhvillohen në zonat e ndryshme të komunës së Klinës.

Agrikultura duhet të zhvillohet bazuar në resurset natyrore, kualitetin e tokës bujqësore, livadhet, kushtet e volitshme klimatike si dhe pozitës të volitshme ndaj infrastrukturës rrugore. Më poshtë janë dhënë veprimtaritë bujqësore të cilat i karakterizojnë zonat kryesore funksionale të komunës:

- *Drithërat* duhet të zhvillohen në tokat me kualitet të lartë të tokës. Meqenëse tokat më kualitative janë në zonën e tokës bujqësore dhe atë të kombinuar, konsiderohet se kultivimi i drithërave është më i përshtatshëm në këto dy zona.
- *Pemtaria dhe perimtaria* - do të zhvillohen kryesisht në zonën e tokës bujqësore dhe pjesërisht në zonën e kombinuar.
- Sipërfaqet e mëdha të kullosave dhe livadheve në zonën e kombinuar ofrojnë mundësi për zhvillimin e *blegtorisë*.
- *Bletaria* është ngushtë e lidhur me pemëtarinë dhe kultivimin e luleve dhe bimëve mjekësore. Zgjojet e bletëve nuk duhet të vendosen pranë shtëpisë dhe hapësirave për rekreacion. Ato duhet të vendosen pranë nektarit dhe resurseve të polenit si dhe ujit të freskët; të janë të mbrojtura nga grabitqarët dhe nga kushte e vështira klimatike. Kjo veprimtari ka potencial të zhvillohet në zonën e kombinuar dhe pyjore.
- Kultivimi i *bimëve mjekësore* dhe *aromatike* kërkon hapësirë të mjaftueshme dhe të janë larg pluhurit. Prandaj zona më e përshtatshme për kultivimin e tyre është zona pyjore.

- **Përkrahja e sinergjive me format tjera të veprimtarive të biznesit**

Përpunimi dhe përsosja e produkteve ushqimore duhet të përqendrohet në prodhimin e pemëve dhe perimeve, prodhimin e drithërave, mjaltës si dhe kultivimin e peshkut.

Agro-turizmi mund të ofrohet nga fermerët për të gjeneruar të ardhura shtesë. Turistët mund të përjetojnë jetën e përditshme të fermës, rritjen e kafshëve, përpunimin e miellit në mullinjtë tradicional dhe të shijojnë një varg të produkteve lokale origjinale dhe specialitete.

- **Rritja e aftësive në teknologjitet prodhuese dhe marketing**

Një edukim specifik në agrikulturë lidhur me trajnimin profesional dhe arsimimin do të ndihmojë fermerët ta ngrisin produktivitetin si dhe të zhvillojnë produkte të reja.

Krijimi i një emri të mbrojtur – markë e re për prodhimet e komunës së Istogut, mund t'i zgjerojë mundësitë e marketingut. Produktet me këtë markë mund të garantojnë kualitetin dhe të ndërtojnë besimin tek konsumatorët.

#### • Rritja e efikasitetit të fermave

Ndërtimi i strukturave kooperative dhe krijimi i kushteve që fermerët të shfrytëzojnë pajisjet e blera nga kooperativa dhe të mbështeten në ndihmën e anëtarëve tjerë të kooperativës.

Rritja e madhësisë së njësive bujqësore – arave, kopshteve dhe fermave duhet të bazohet në prodhime kualitative dhe të përkrahura me politikë adekuate agrare.

#### 2.2.1.2 TURIZMI

Natyra e larmishme në komunën e Klinës me peizazhe të bukura dhe dinamike, luginat e lumejve resurset natyrore si ujëvarat e Mirushës dhe shpellat, trashëgimia kulturore – kullat, mullinjtë, xhamitë, kishat etj – përbëjnë potencialet për zhvillimin e turizmit. Edhe pse ende i paorganizuar në nivelin qendror dhe atë lokal, turizmi në komunën e Klinës ka potencial të mjaftueshëm për t'u bërë një veprimitari e rëndësishme ekonomike.

Për të pasur një zhvillim të mirëfilltë të turizmit, lokacionet me resurse dhe atraksione natyrore, siç janë fauna dhe flora - peizazhet, shpellat, pyjet dhe klima, duhet të merren në konsiderim për alokimin e investimeve. Faktorët e krijuar si transporti, konkurenca, historia, qasja në tregje dhe karakteri i komunitetit, kanë po ashtu rol te rëndësishëm në zhvillimin e turizmit.

Zhvillimi i turizmit si veprimitari ekonomike në territorin e komunës, dallohet për nga tipet e përcaktuara sipas potencialit: në zonën “bujqësore” dhe në zonën e kombinuar ku resurs kryesor është peizazhi përreth lumejve dhe motivet turistike të turizmit rural, ka mundësi të zhvillohet agroturizmi dhe turizmi rural bazuar në tokën bujqësore. Po ashtu, në bazë të trashëgimisë kulturore mund të zhvillohet edhe turizmi kulturor

Në zonën pyjore mund të zhvillohet turizmi natyror – ose ekoturizmi bazuar në motivet turistike natyrore si Monumenti natyror ‘Mirusha’ gryka e lumit Klina, pasuritë tjetra të trashëgimisë natyrore si dhe speloturizmi në shpellat e korionit të Mirushës.

Turizmi ne komunën e Klinës duhet të bazohet në kërkesat e shfrytëzuesve/vizitorëve, duke mos i cenuar vepritaritë tjetra ekonomike, posaçërisht agrikulturën si shtyllën kryesore të zhvillimit e ekonomik, si dhe natyrën dhe peizazhin gjithashtu. Turizmi duhet të mbështetet në

potencialin agrikulturor lokal duke shfrytëzuar produktet kualitative bujqësore për ta begatuar ofertën turistike.

Produkti final që do ta kënaqë shfrytëzuesin/vizitorin, varet në masë të madhe nga kualiteti i shërbimeve dhe prezantimi i atrakSIONEVE natyrore, objekteve turistike – hoteliere, komuniteti, qasja dhe mobiliteti.

Aktorët kryesor të cilët duhet ta zhvillojnë turizmin duhet të jenë bordi lokal i turizmit, ndërmarrjet komerciale si agjencitë turistike dhe individët e aftë në këtë veprimtari. Për organizim të mirëfilltë të kësaj industrie, duhet të krijohet një bord i përbërë nga aktorët kryesor në këtë industri me qëllim të krijimit të standardeve, mbrojtjen e interesave ekonomike, përfshirë këtu bizneset, turistët, komunitetin dhe interesat ambientale e kulturore. Bordi do të ndërtojë edhe bazën e të dhënavë për motivet turistike në territorin e komunës dhe më gjerë, akomodimi – me klasifikimin e përcaktuar nga MTI si aktivitete specifike që mund t'u ofrohen klientëve.

Janë tri elemente të cilat mund t'i japin drejtimin e duhur zhvillimit të ardhshëm të turizmit në komunën e Klinës.

**1. Mundësia e ardhjes** – varet nga dy faktorë – informacionin themelor mbi atraksionin turistik për t'u vizituar dhe si të arrihet deri te destinacioni i dëshiruar. Hapi i parë që komuna duhet ta bëjë tështë themelim i një bordi lokal të turizmit, i cili do të ketë përgjegjësinë për ta përgatitur bazën për të gjitha pikat dhe atraksionet që duhet vizituar, informatat për akomodimin në të gjitha kategoritë, si dhe aktivitetet që mund të zhvillohen në pikat turistike.

Transporti në lokacionet e turizmit do të jetë një çështje e ndjeshme dhe ai duhet të merr në konsiderim reduktimin ndotjes së ajrit dhe zhurmës të cilat lirohen nga automjetet. Mungesa e ofertës së një transporti efikas publik këkron përdorimin e transportit motorik individual që rritë ndotjen që pastaj ndikon në uljen e kualitetit të motiveve turistike. Prandaj, me këtë plan synohet promovimi i transportit publik. Po ashtu duhet të inkurajohet edhe çiklizmi, ecja dhe format tjera mjedisore jo ndotëse të transportit.

**2. Përbajtja** – Aktivitetet turistike janë ngushtë të lidhura me potencialet e zonave. Në tabelën e mëposhtme janë listuar aktivitetet turistike sipas resurseve themelore të zonave.

**3. Vlerat e peizazhit** - Peizazhi është informata e parë vizuale për vizitorin i cili e viziton apo kalon nëpër komunën e Klinës, prandaj është e rëndësishme që gjatë udhëtimit nëpër territorin e Klinës të konsiderohet mundësia e informimit të udhëtarë/vizitorëve lidhur me potencialet turistike të Komunës.

Turizmi dhe rekreacioni ne Komunën e Klinës bazohen në atraksionet natyrore dhe trashëgiminë kulturore. Prandaj komuna duhet të promovojë eko-turizmin, si formë e turizmit të qëndrueshëm i definuar edhe në vizion. Qëllimet e zhvillimit të turizmit në komunën e Klinës janë:

- Krijimi i zonave turistike atraktive dhe të sigurta për ata që do t'i vizitojnë këto zona - përcaktimi i hapësirave, ndërtimi i objekteve të turizmit, si dhe sigurimi i shërbimeve të cilat i plotësojnë kërkesat e popullatës vendore, atyre që punojnë dhe atyre që vizitojnë këto hapësira;
- Promovimi i potencialit turistik të zonës, për t'i ndihmuar ekonomisë vendore dhe përmirësuar kualitetin e jetës së banorëve të zonës;
- Plotësimi i kërkesave të posaçme për sport dhe rekreacion në lokacionet e përshtatshme - përkrahja dhe shtimi i mundësive për një rekreacion joformal, të qetë në pjesët e qeta të zonave turistike;

Format e identifikuara të turizmit në komunën e Klinës janë:

- Turizmi shëndetësor – gryka e lumbit Klina – mundësi për ndërtimin e qendrës rehabilituese për sëmundjet e frysma marrjes
- Turizmi natyror
  - Monumenti i natyrës Mirusha
  - Kanioni i lumbit Klina
  - Speleoturizmi
- Agroturizmi dhe turizmi rural
- Turizmi kulturor – monumentet e trashëgimisë kulturore

### **Turizmi shëndetësor**

Resurs i identifikuar për turizmin shëndetësor është mjedisi natyror i kanionit të lumbit Klina. Kjo zonë ka potencial për ndërtimin e një qendre rehabilituese për personat me sëmundje të frysma marrjes.

### **Natyra dhe turizmi**

#### **Monumenti i natyrës MIRUSHA**

Monumenti natyror ‘Mirusha’ konsiderohet një prej resurseve më atraktiv natyror në Kosovë. Lumi Mirusha, ujëvaret, liqenet e vogla që krijohen nga ujëvaret, shpellat, si dhe vlerat e florës dhe faunës në territorin parkut dhe jashtë tij, bëjnë që monumenti Mirusha të jetë një atraksion i Jashtzakonshëm për zhvillimin e turizmit natyror.

Elaborimi më i hollësishëm për zhvillimin e turizmit në Monumentin natyror ‘Mirusha’ është dhënë në Planin Hapësinor për zonën e vecantë ‘Monumenti natyror Mirusha’ të hartuar nga IPH – si zonë e vecantë nën kompetencën e MMPh.

### **Speleoturizmi**

Speleoturizmi bën pjesë në mesin e sporteve ekstreme. Ajo çka e bën të veçantë këtë tip të turizmit është kontakti me ‘natyrën e paprekur’ të ambientit të shpellës, kufizimet hapësinore dhe errësira. Zhvillimi i speleoturizmit është i paraparë në kuadër të ‘Monumentit natyror Mirusha’ ku janë të identifikuara tri shpella.

Po ashtu si atraksione të speleoturizmit konsiderohen shpella e Azem Bejtës dhe shpella e Dushit.

Zhvillimi i kësaj disipline kërkon krijimin e një organizate të vecnatë të hulumtimit të shpellave - pasi që në Kosovë mungojnë hulumtimet e mjaftueshme për ‘hapjen’ e shpellave si potencial për turizëm. Prandaj për zhvillimin e kësaj disipline si atraksion turistik në Monumentin Natyror ‘Mirusha’ janë të domosdoshme

- hulumtimet speleologjike – hulumtimet kimike, biologjike, gjeologjike, meteorologjike dhe hartografike për të ndërtuar portretet e shpellave
- hartimi i hartave precise dhe detaje për nevoja të turistëve
- menaxhimin e shpellave të hapura për vizita turistike dhe të shpellave të pahulumtuara për vizita studimore

### **Agroturizmi dhe turizmi rural**

Agroturizmi është formë e pushimeve në fshatra, përkatësisht në ferma si mjedise bujqësore. Këtu mund të përfshihen edhe ndihma në punët e fermës si pjesë e vizitës, pra është e lidhur me zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Fermerët mund të ofrojnë shërbime të akomodimit duke dhënë me qira dhoma ose shtëpi të vogla, për ata që dëshirojnë të njoftohen me aktivitetet e bujqësisë dhe blegtorisë, me natyrën dhe gjahun ose edhe vetëm të shijojnë qetësinë dhe peizazhin rural ose agrar. Megjithse një formë e re e turizmit, konsiderohet se Klina me potentialin bujqësor që ka, mund të ofrojë edhe shërbime të turizmit rural – agroturizmit.

Në kuadër të turizmit mund të konsiderohet edhe gjahu. Në komunën e Klinës ekziston një rezervat ku lejohet zhvillimi i gjahut. Ekziston edhe shoqata egjahut e cila mund të merr përsipër organizmin e këtij lloji të turizmit.

### **Turizmi kulturor**

Turizmi kulturor zhvillimin e tij e përqëndron në kulturën, traditën dhe artin e vendit. Këtu përfshihen vizitat në zona historike, në zona ku mbahen festivale ose ngjarje tjera kulturore-si festivali folklorik ‘Mujë Krasniqi’, panairi i punimeve artizanale, festivali tradicional rajonal në vjeshtë. Për zhvillimin e turizmit kulturor, komuna duhet ta zhvillojë marketingun lidhur me trashëgiminë kulturore, traditën, artin dhe kulturën.

Turizmi i trashëgimisë kulturore në komunën e Klinës bazohet në vlerat e trsashëgimisë kulturore të deklaruara dhe të listuara si vlera potenciale për mbrojtje. Zhvillimi i turizmit: ka ndikim pozitiv në aspektin ekonomik dhe shoqëror; e krijon dhe përforcon identitetin e vendit; ndihmon në mbrojtjen, konservimin e trashëgimisë kulturore; përmes traditës, si instrument, e plotëson harmoninë dhe mirëkuptimin ndërmjet njerëzve. Objektivat të cila duhet të synohen me këtë industri në kontekst të zhvillimit të qëndrueshëm janë:

- Konservimi i trashëgimisë kulturore
- Interpretimi korrekt dhe i saktë i burimeve
- Përjetimi autentik i vizitorëve
- Stimulimi i burimit të të ardhurave nga resurset kulturore

Pra, turizmi i trashëgimisë kulturore nuk merret vetëm me identifikimin, menaxhimin dhe mbrojtjen e vlerave kulturore, por duhet të merret edhe me ndikimin e turizmit në komunitet dhe rajon, të arrijë përfitime ekonomike dhe shoqërore, të sigurojë burime financiare për mbrojtje si dhe të merret me marketing dhe promovim. Për marketing të suksesshëm duhet përgatitur informata për çdo atraksion dhe t'ua ofrojë turistëve përmes internetit, librave, broshurave dhe formave tjera propaganduese.

#### 2.2.1.3 NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

Ndërmarrjet e mesme dhe të vogla janë të përqendruara kryesisht në qytetin e Klinës, ndërsa në pikëpamje të hapësirës, nuk kërkojnë kushte të posaçme të vendosjes. Shumica e aktiviteteve të banorëve është në veprimtaritë shërbyese – hoteliere dhe zejtare e cila në shumicën e rasteve zhvillohet në kuadër të objekteve të banimit përgjatë rrugëve kryesore.

Përveç veprimtarive shërbyese, pas luftës së fundit në Klinë janë themeluar edhe ndërmarrje prodhuese për nevojat e ndërtimtarisë, të cilat kanë renome edhe në mbarë Kosovën.

Megjithëse bujqësia dhe turizmi janë identifikuar si shtylla kryesore të zhvillimit, nuk ka shumë ndërmarrje të cilat shquhen si të specializuara në këto dy fusha. Për zhvillimin e bujqësisë dhe turizmit ekziston potenciali i fuqisë së re punëtore lokale. Tradita për zhvillimin e bujqësisë është një bazë e mirë që kjo degë të jetë shtyllë e zhvillimit ekonomik në Komunë.

Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përkrahet edhe nga rrjeti funksional i trafikut dhe mundësitë e lidhjeve të lehta me komunat fqinje dhe qytet e mëdha – Prishtina, Peja dhe Gjakova. Këto veçori duhet të kontribuojnë në shtimin e punësimit në rajon dhe ngrisë atraktivitetin e lokacioneve të veprimtarive ekonomike.

Veprimtaritë e përshtatshme për zhvillimin e ekonomisë rajonale mund të janë:

- Prodhimtaria dhe bizneset e përqendruara në produktet bujqësore
- Industritë/ bizneset të cilat prodhimin e bazojnë në lëndën e parë vendore
- Industritë/bizneset me kërkesa më të mëdha për fuqi punëtore
- Industria dhe bizneset me ndotje të vogël

Strategjia e zhvillimit ekonomik duhet të bazohet në shfrytëzimin e resurseve lokale – natyrore, financiare dhe njerëzore. Më poshtë janë listuar disa koncepte themelore të cilat duhet të zhvillohen nga komuna, për ta përkrahur zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme:


- Ndërmarrësit e rinj  
Ndërmarrësit e rinj luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillim. Njohuritë në teknologjinë informative, ka hapur dyert për shumë njerëz të rinj të janë të suksesshëm në nismën e bizneseve të reja
- Rol i diasporës  
Diaspora është një burim i rëndësishëm për zhvillim ekonomik për komunën e Klinës. Komuna duhet ta ketë në konsideratë këtë si një potencial për zhvillimin e NVM, përmes lidhjeve të bizneseve vendore dhe atyre ndërkombëtare.
- Ndërmarrjet në turizëm
- Turizmi në komunën e Klinës mund të kontribuojnë në shtimin e bizneseve: ndërmarrjet e turizmit, shërbimeve dhe ato të prodhimeve lokale në shërbim të turizmit.
- Roli i femrës në zhvillimin ekonomik po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. NVM janë mundësi e mirë për ato femra të cilat kanë kualifikime të nevojshme dhe iniciativë të duhur. Agrikultura dhe ekonomia e turizmit janë fusha në të cilat femra mund të luajë një rol të rëndësishëm.

### **Zona e industrisë - PARKU INDUSTRIAL / I BIZNESIT**

Zona industriale ekzistuese në qytet do të duhej të transformohej në një qendër apo park biznesi ku përveç prodhimit do të duhej të ketë edhe shërbime tjera si tregëtia dhe shërbime që përkrahin prodhimin. Meqenëse zona është e pajisur me infrastrukturë dhe ka lidhje direkte me rrugën rajonale për Skënderaj dhe me hekurudhën, konsiderohet si potenciali për t'u shndërruar në një park të suksesshëm biznesi .

PLANI ZHVILLIMOR I KOMUNËS SË KLINËS

URBAN PLUS



Harta 2. Zhvillimi ekonomik

## 2.2.2 STRUKTURA E VENDBANIMEVE

### 2.2.2.1 PARASHIKIMET DEMOGRAFIKE

Numri i banorëve, shtimi popullsisë dhe parashikimi demografik janë thelbësore për planifikimin hapësinor të një vendi. Numri i popullsisë në komunën e Klinës, në bazë të regjistrimit të fundit të bërë nga Enti Statistikor i Kosovës në vitin 2011 është 36357 banorë. Parashikimi i shtimit të popullsiësë bazohet në llogaritjet e shtimit të popullsisë si ndryshim i numrit të popullsisë në Kosovë. Në bazë të krahasimeve të periudhave të mëparshme, tregon se shtimi i popullsisë ka pësuar rënje (rënje prej 2.2% në vitin 1948-53, 2.1% në vitin 1981 dhe 1.4% në vitin 2003). Në bazë të krahasimeve është përetësuar një shkallë mesatare prej 1.6% si trend i përvetësuar në Planin Hapësinor të Kosovës.

$$B_k = B_0 \left(1 + P/100\right)^n$$

$B_k$  - numri i parashikuar i popullsisë në komunë

$B_0$  - numri i tashëm i popullsisë

$P$  - Shkalla e shtimit vjetor të popullsisë

$n$  - numri i viteve të parashikuara - 10


36357
1.6
10

### NUMRI I POPULLSISË NË KOMUNË NË VITIN 2021

Bazuar në trendet kosovare shtimi i popullsisë është ~1.6% në vit

$$B_k = B_0 \left(1 + P/100\right)^n = 36357 \left(1 + 1.6/100\right)^{10} = 42611$$

**B<sub>k</sub> = 42611**



## 2.2.2.2 ADMINISTRIMI TERRITORIAL

Administrimi territorial përmes bashkësive lokale luan rol pozitiv në ofrimin e shërbimeve administrative dhe shërbimeve tjera sociale si arsimi, shëndetësia dhe shërbime tjera ndaj qytatarëve. Plani Zhvillimor I komunës vazhdontë zhvillojë administrim territorial në komunën e klinës përmes qeverisjes lokale në administratën komunale. Në bazë të parashikimeve demografike bashkësitë likale vazhdojnë të jenë të jenë të administruara nga dhjetë njësi.

1 KLINË	KLINË	5452	6,389.88
DÉRSNIK		177	207.45
GREMINK		1127	1,320.87
DOLLC		276	323.48
		<b>7032</b>	<b>8,241.68</b>

6 JASHANICË	JASHANICË	1786	2,093.24
KÉRNICË		794	930.59
RESNIK		426	499.28
JELLOCË			
DUSH		196	229.72
		<b>3202</b>	<b>3,752.83</b>

2 ZLLAKUQAN	ZLLAKUQAN	659	772.36
KRUSHËVË		327	383.25
KRUSHEVË		585	685.63
JAGODË		195	228.54
BËRKOVË		246	288.32
RADULLOC		321	376.22
		<b>2333</b>	<b>2,734.34</b>

7 BUDISALC	BUDISALC	397	465.29
STUPË		174	203.93
RUDICË		453	530.93
NAGLLAVË		67	78.53
		<b>1091</b>	<b>1,278.68</b>

3 GLLAREVË	GLLAREVË	2196	2,573.77
RIGJEVË		482	564.92
STAPAICE			
		<b>2678</b>	<b>3,138.68</b>

8 SHTUPEL	SHTUPEL	778	911.84
RENOC		353	413.73
LESKOC			
DRANASHIQ		21	24.61
BINGJË		323	378.56
GRAPC			
		<b>1475</b>	<b>1,728.74</b>

4 SFERKË	SFERKA	2461	2,884.35
PËRQEVE		998	1,169.68
VOLLJAKË		929	1,088.81
		<b>4388</b>	<b>5,142.85</b>


9 UJËMIRE	UJËMIRE	544	637.58
SIQEVE		1306	1,530.67
GJURGJEVIK		449	526.24
DOBËRDOLL		339	397.32
ZABËRGJ		728	853.23
QABIQ		861	1,009.11
CARAVIK		1241	1,454.48
		<b>5468</b>	<b>6,408.64</b>

5 GRABANICË	GRABANICË	728	853.23
BOKSHIQ		342	400.83
CESKOVË		374	438.34
KËPUZ		622	729.00
DOLLOVË		444	520.38
DUGAJEVË		400	468.81
		<b>2910</b>	<b>3,410.59</b>

10 DRENOC	DRENOC	442	518.04
PETRIQ		188	220.34
VIDEJË		532	623.52
DEIQ		376	440.68
ZAJM		1274	1,493.16
PETRIQ. M		563	659.85
		<b>3375</b>	<b>3,955.59</b>

Tab 2. Numri i banorëve nëpër qendra dhe zona e mbulueshmërisë



### 2.2.2.3 ZGJERIMI I VENDBANIMEVE

Faktorët kryesorë që ndikojnë në zgjerimin e vendbanimeve në komunën e Klinës janë:

- Parashikimet demografike
- Dendësia e popullsisë
- Zona ekzistuese e ndërtuar
- Toka bujqësore

Zgjerimi i vendbanimeve është rezultat i shtimit natyror të popullsisë dhe migrimit. Në komunën e Klinës shtimi i popullsisë është në shkallë të lartë ndërsa dendësia e banimit është e ultë që do të thotë se indeksi i shfrytëzimit të sipërfaqes së tokës është i madh në krahasim me numrin e popullsisë. Kjo tregon për joracionalitetin e shfrytëzimit të tokës që bie ndesh me interesin e zhvillimit ekonomik në komunës, përkatësisht me zhvillimin e bujqësisë.

Në bazë të parashikimeve demografike nuk ka nevojë për zgjerimin e sipërfaqes së ndërtuar të vendbanimeve pasi që mund të shfrytëzohen sipërfaqet e zbrazëta brenda zonave të ndërtuara të vendbanimeve. Plani sygjeron ndalimin e zgjerimit të ëtejmë të vendbanimeve në këto zona dhe për ndërtimet e reja të shfrytëzohen hapësirat e lira brenda zonave të ndërtuara. Koncepti i tillë i zgjerimit të vendbanimeve- shfrytëzimi racionali i tokës ndikon edhe në zvogëlimin e kostos së infrastrukturës si dhe zvogëlimin e rrezes së shërbimeve themelore brenda vendbanimeve.

Zhvillimi i vendbanimeve duhet të bazohet në densifikimin e zonës së ndërtuar, konsolidimin e infrastrukturës ekzistuese dhe ndërtimin e asaj që mungon me kosto sa ëm të vogël.

Kriteret për zgjerimin e vendbanimeve, mbi të cilat duhet të bazohen planet që pasojnë janë:

- Densifikimi- shmangja e zgjerimit jashtë zonave të ndërtuara
- Mbrotja e tokës bujqësore
- Mbrojtja e peizazhit
- Shfrytëzimi racionali i tokës.




Fig.4 Vendbanim I shprëndarë- Gremiku




Fig.5 Vendbanim I përqëndruar- Volljakë




Fig.6 Vendbanim me Zonë të Veçantë të mbrojtur- Budisalci

#### VENDBANIMET JOFORMALE

Vendbanimet joformale në vendin tone kanë ekzistuar edhe më parë, mirëpo kryesisht kanë qenë të njoitura me emërtime të ndryshme si lagje të egra ,ilegale, të paplanifikuar, mahalla etj. Sipas Ligjit Nr. 03/L-106 për ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.2003/14 ,Neni 2 Vendbanimet Joformale përkufizohen si në vijim: janë vendbanime njerëzore të cilat nuk u mundësojnë banorëve të gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës , në veçanti banim të përshtatshëm .Si tilla, vendbanimet joformale duhet të kenë karakteristika si në vijim:

1. Zotërimi joformal i pronësisë,
2. Qasja joadekuate ose privimi në shërbime elementare,
3. Pjesëmarrja joadekuate ose mos pjesëmarrja në qeverisje dhe
4. Rrezikshmëria e lartë

VBJ e identikuara në vendin tonë, karakterizohen kryesisht me zotërim joformal të pronësisësi dhe me qasje joadekuate në shërbime elementare.Karakteristikat identifikuase do të jenë bazë për të ju çasur rregullimit të tyre.

Bazuar në të dhenat nga raporti I fundit në komunën e Klinës janë identifikuar 21 Vendbanime Joformale. Prej tyre 1 VBJ gjendet në zonën urbane , ndërsa 20 në zonën rurale. Këto janë:

Rudicë, Budisalc, Jagodë, Bërkovë, Shtupel, Bingjë, Pogragjë, Petriq I poshtëm, Drenoc, Dugajë, Grabanicë, Zajm, Klinë –zona veriore, Klinë-Dërrsnik, Dollovë, Volljakë, Strapanicë, Resnik, lagja në mes të Jashanicës dhe Jashanicës së Epërme.

Në këto vendbanime jetojnë banorë të komunitetit shqiptar, serb(ka raste të zhvendosjes pas vitit 1999 ) dhe RAE. Karakterizohen me mungesë të pjesshme të infrastrukturës sociale dhe fizike, kanë ndikim negativ në mjedis dhe zotërim joformal të pronës.

Mirëpo gjendja viteve të fundit ka ndryshuar sepse komuna ka pasur investime sidomos në fushën e infrastrukturës teknike. Në bazë të hulumtimeve në terren, analizës së shprëndarjes së infrastrukturës sociale si dhe informatave nga Drejtoria e Kadastrit lidhur me çështjet pronësore rrjedh që shumë venbanime nuk e plotësojnë kriterin e të qenit vedbanim joformal.

Në bazë të hulumtimeve, ku kriter ka qenë : zotërimi joformal I pronësisë, qasja joadekuate në shërbimet elementare, qasja jodeakuate në qeverisjë dhe rrezikshmëria e lartë ,vendbanimet joformale në komunënë e Klinës ndahen në këto kategori:

1. Vendbanimet joformale të cilat kanë zotërim joformal të pronësisë. Këtu bëjnë pjesë : Bokshiqi, Dollova, Dresniku, Drenoci, Grabanica dhe Petriqi. Shtëpitë që gjenden brenda kufirit të përcaktuar të vendbanimit joformal janë ndërtuar në pronë shoqërore.
2. Vendbanime joformal në zona të veçanta. Këtu bën pjesë Budisalci. Kufinjtë e këtij venbðbanimi janë përcaktuar me ligj të veçantë. Ky vendbanim kërkon regjim të veçantë të organizimit, zhvillimit , shfrytëzimit dhe mbrojtjes.
3. Vendbanime joformale të cilat kanë mungesë të infrastrukturës teknike. Të gjitha venbanimet pothuajse e kanë problemin lidhur me furnizimin me ujë, rrjetin e kanalzimit , telefonisë etj.

Të gjitha vendbanimet e lartëpërmenduara e plotësojnë kriterin lidhur më infrastrukturës sociale, sepse të gjitha ose e kanë ose janë janë të mbuluara nga vendbanimi përkatës. Kështu psh. Budisalci, Drenoci, Grabanica, kanë institacione arsimore dhe shëndetësore ndërsa vendbanimet tjera joformale mbulohen nga vendbanimet tjera më të afërtë. Bokshqi graviton në Grabanicë, Dollova në Grabanicë apo Gremnik, Drsniku graviton në Klinë dhe Petriqi në Petriq të Epërm apo Drenoc.

Kriteri I mbulueshmërisë më infratrukturë sociale.- Në bazë të informatave hapësinore lidhur më shtrirjen e përmbajtve publike, komuna e Klinës ka në shprëndarjë relativisht të mirë të ndërtesave arsimore dhe shëndetësore. Sa I përket ndërtesave të qerdheve , nuk mund t'a konsidrojme si kriter për shkak se qerdhet-kopshtet sipas standardeve duhet të jenë në çdo 2000 banorë. E njëjta gjë vlen edhe për shtëpitë e kulturës. Prandaj duke I marrë për bazë këto informata vijmë në përfundim që pothuajse të gjitha venbanimet joformale e potësojnë kushtin lidhur me qasjen në infrastrukturës sociale.

Kushti tjetër i plotësuar është edhe infrastruktura teknike. Viteve të fundit janë realizuar mjaft projekte. Kështu pshs. Mahalla Klinë (vendbanim joformal i cili gjendej ne zonën urbane) iu janë ndërtuar rruget, ndëruar rrjeti i ujësjellësi dhe kanalzimit. Dhë paraqet një shebull të një lagje të organizuar.

Në bazë të dhënave të lartëpërmenduara vendbanime joformale në komunën e Klinës janë: Budisalci, Bokshiqi, Dollova, Dresniku, Drenoci, Grabanica dhe Petriqi.

Raporti është hartuar në bazë të:

- Vizitës në terren
- Krahasimit të VBJ të identikuara në raportin e fundit me gjendjen aktuale (2013)
- Konsultimet e drejtëpëdrejta dhe identifikimit të kufinjëve të saktë të vendbanimeve joformale bashkë me zyrtarë të Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Urbanizmit
- Analizës hapësinorë lidhur me mbulueshmërinë e vendbanimeve nga institucionet arsimore, shëndetësore dhe kulturore.




Fig.7. Vendbanimet joformale (gjendja 2013)

### 2.2.3 MOBILITETI DHE RRJETI I TRAFIKUT

Një sistem i transportit i planifikuar dhe i ndertuar mirë është esencial për një zhvillim të drejtë dhe efikas të komunës dhe vendbanimeve të saj. Sistemi i transportit në komunën e Klinës ka dy ndikime të rëdnësishme; ndikon në rritjen e vendbanimeve duke siguruar qasjen në ngastra dhe ndikon në ekonomine vendore duke mundësuar qarkullimin e njerëzve dhe mallërave.

Komuna e Klinës lidhet me komunat fqinje përmes një rrugës nationale dhe tri rrugëve rajonale të cilat kryqëzohen në qendrën urbane. Në lindje-perëndim kalon magjistralja Prishtinë-pejë e cila e lidh Klinën me komunat në veri dhe lindje të Kosovës si dhe më tutje me Maqedoninë dhe Serbinë. Në jug kalon rruga rajonale që e lidh Klinën me Gjakovën, ndërsa në verilindje dhe veriperëndim me komunën e Skendarejat respektivisht me komunën e Skendarajt.

Pozita e vendbanimeve, kryesisht në zonën e tokës bujqësore si dhe asaj të kombinuar dhe afërsia ndërmejt tyre ofrojnë kushtë të volitshme për kompletimin e rrugëve dhe krijimin e mundësisë së lëvizjes si një faktor me ndikim në zhvillim. Rrugët e paasfaltuara nuk mundësojnë kushte të mira të transportit dhe si pasojë kemi stagnimin e zhvillimit të përgjithshëm të atyre zonave dhe migrimn e popullsisë në drejtim të subqedrnave dhe Klinës së qendër kryesore lokale su dhe qendrave rajonale si Peja dhe Prishtina.

Bazuar në dendësinë e popullsisë nëpër zonat e komuan së Klinës dhe nevojave të udhëtimit, mund të konsiderohen mundësitë e ndryshme të transportit si: autobusët dhe minibusët, si dhe shfrytëzimin e automejtve private.

Hierarkia e propozuar shërbimeve nëpër vendbanime do të duhetj të jetë bazë për sistemin e ri të transportit publik. Vendet e reja të punës afër vendbanimeve, mund të zvogëlojnë varshmërinë e banorëve nga automjetet dhe inkurajojnë shfrytëzimin e llojeve të transportit si : bicikleta, ecje dhe tranporti publik.

Principet e mëposhtme përbëjnë bazën për politikat e transportit- mobilitetit:

- Shkurtimi i distancave në mes të fshatrave dhe qendrave lokale, subqedrnave dhe Klinës si qendër kryesore lokale përmes formave të ndryshme të transportit
- Promovimi i transportit alternativ ndaj udhëtimit konvencional me veturë
- Promovimi i qasjes së sigurt në rrugë duke minimizuar numrin e pikave të qasjes përgjatë rrugës nationale dhe rrugëve rajonale si dhe atyre përbledhëse- rrugës kryesore lokale
- Ndarma në mes të trafikut tranzit dhe trafikut lokal
- Sigurimi i qasjes adekuate në ndërtesat dhe ngastrat në zonat e destinuara për zhvillim
- Promovimi i formave të zhvillimit të cilat kërkojnë përmirësim vetëm aty ku nuk do të dëmtohen resurset mjedisore

- Sigurimii nevojës reale për asfaltimin e rrugëve të reja dhe rikonstruktimin e atyre ekzistuese

#### 2.2.3.1 RRJETI RRUGOR

##### HIERARKIA E RRJETIT RRUGOR

Me qëllim të shfrytëzimit të tokës dhe planifikimit të transportit është paraqitur hierarkia e rrugëve në komunën e Klinës:

	Kategoria	Përgjegjësi
1	Rrugët nacionale	Ministria e Infrastrukturës
2	Rrugët rajonale	Ministria e Infrastrukturës
3	Rrugët kryesore lokale	Komuna
4	Rrugët lokale	Komuna
5	Rrugët tjera	Komuna

Tab.3 Kategorizimi i rrugëve

1. Rrugët nacionale janë korridore të cilat lidhin Kosovën me vendet fqinje, prandaj ato mund të konsiderohen edhe si rrugë nacionale. Funksioni i rrugës nacionale është të bartë trafikun në mes të qyteteve kryesore. Kjo kategori e rrugëve përbën rrjetin kryesor të trafikut në Kosovë dhe ato mundësojnë qarkullimin në distanca më të gjata të njerëzve dhe mallërave.
2. Funksioni i rrugëve regionale është lidhja e komunës së Klinës me komunat fqinje- Pejë, Gjakovë, Istog, Skendaraj, Malishevë. Rrugët rajonale kanë rolin edhe të rrugëve shrpendarëse . funksioni i tyre është i ngjashëm me rrugët nacionale, por trafiku nuk është i drejtuar në mënyrë të posaçme.
3. Rrugët kryesore lokale mundësojnë lidhjen e të gjitha qendrave lokale në rrjetin e rrugëve rajonale për më tej me subqednrat më të afërta dhe qendrat lokale në mes veti. Rrjeti i ri propozon një koncept të rrugës përbledhëse për t’l lidhur të gjitha vendbanimet në kufinjtë e komunës.
4. Rrugët lokale lidhin vendbanimet të cilat nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë në rrugën kryesore lokale si dhe shkallëzojnë trafikun ndërmjet rrejtit të krijuar nga rrugët nacionale, rajonale dhe rrugëve kryesore lokale.
5. Të gjita rrugët tjera të cilat lidhin dy fshatrav ose pikat tjera gjeografike rangohen si rrugë tjera.

Kjo hierarki e rrugëve ka për qëllim të ndikojë që trafiku t’l gjejë vijat më të përshtatshme dhe të minimizojë ndërhyrjet nëpër zonat në të cilin kalon. Ajo shërben edhe si bazë për përcaktimin e prioriteteve të sigurisë në rrugë, mirëmbajtjes dhe manaxhimit të trafikut.

## SISTEMI I TRANSPORTIT PUBLIK

Shërbimet e transporrit publik luajnë rol qenësor për të mundësuar lëvizjen drejt vendeve të punës, arsim, shëndetësi, tregti, përmbytje publike dhe rekreacion. Transporti publik ka rol pozitiv në luftimin e dallimeve sociale. Transporti publik brenda komunës do të bëhet me autobusë dhe minibusë duke siguruar lidhjen e vendbanimeve me qendrën urbane Klinën dhe lidhjen në mes të vendbanimeve. Përdorimi i automjeteve private është rritur në mënyrë dramatike kohët e funsit e sidomos pas luftës. Kjo formë e transporrit është njëri ndër ndotësit kryesor të ambientit, prandaj duhet investuar në përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve të transporrit publik me qëllim të inkurajimit të shfrytëzimit të transporrit publik dhe jo atij vetanak.

Rrjeti i propozuar me koncept të rrugës përbledhëse për t’l lidhur të gjitha vendbanimet në mes zonave do të mundësojnë një transport publik me efikas.

### ÇIKLISTËT, KËMBËSORËT DHE NJERËZIT ME KËRKESA TË VEÇANTA TË LËVIZJES

Zhvillimet e ardhshme do të përfshijnë arritjen e disa standardeve përmes masave për përmirësimin e qasjes së njerëzve me kërkesa të veçanta, për prindër me karrocë si dhe të ndikojnë në rritjen e numrit të çiklistëve dhe këmbësorëve.

Këto masa përfshijnë edhe sigurimin e hapësirave dhe objekteve për çiklistë dhe këbësorë. Shtigjet e sigurta për çiklistë dhe këmbësorë mundësojnë mjete alternative të lëvizjes nëpër komunë dhe mund të zvogëlojnë përdorimin e automjeteve.

- Këmbësorët

Promovimi i ecjes ka rëndësi të veçantë posaçërisht për shëndetin si formë e aktiviteti fizik, pastaj zvogëlimit të emisisonit të gazërave nga trafiku i reduktuar me vetura dhe shtimin e sigurisë në trafik. Ecja gjithnjë e më shumë bëhet aktivitet kryesor rekreativ sidomos në peizazhet natyrore.

Komuna duhet të ndërmerr masa për përmirësimin e sigurisë dhe komoditetin e këmbësorëve, me kalime në udhëkryqë, përmirësojë ndriçimin, mirëmbajtjen e shtigjeve dhe kanalizimin atmosferik. Shtigjet janë posaçërisht të rëndësishme në zonat me potenciale turistike-peizazhet e hapura, monumentin natyror. Këto shtigje duhet të jenë pjesë të planit të përgjithshmë të turizmit për tërë komunën.

Autoritetet komunale duhet t’l kushtojnë rëndësi edhe nevojave të njerëzve me aftësi të lëvizjes duke i trajtuar këto nevoja gjatë menaxhimit të trafikut, ndërtimit të rrugëve, transporrit publik dhe projekteve tjera.

- Çiklistët

Komuna duhet t’l kushtojë rëndësi të madhe zhvillimit të çiklizmit si pjesë integrale e sistemit të transportit. Rrjeti i shtigjeve të çiklistëve duhet të planifikohet me kujdes duke u bazuar jo vetëm në nevojat e udhëtimit por edhe në kërkesat e turizmit si në pjesën rrafshinore ashtu edhe atë kondrinore.

Shtimi i konsiderueshëm i ecjes dhe përdorimit të bicikletave mund të arrihet përmes promovimit kualitativ dhe publicitetit kurse pormovimi i ecjes dhe çiklizmit është i lidhur ngushtë me zhvillimin e zonave të turizmit dhe rekreacionit.

#### REDUKTIMI I TRAFIKUT DHE PARKIMI PËR ZHVILLIMET REJA

Propozimet e reja do të duhej të përgatisin masa për reduktimin e vëllimit të trafikut dhe zvogëlimin e nevojës për sipërfaqe të parkimit mbi tokë. Planet rregulluese urbane duhet t’l specifikojnë masat për këto reduktime në lokacionet përkatëse.


- Strategjia e parkimit

Strategjia e parkimit ka një rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe integrimin e përgjithshëm të shfrytëzimit të tokës dhe transportit. Zhvillimet e reja, posaçërisht në peizazh duhet të sigurojnë parkim të përshtatshëm në harmoni me udhëzimet nga Plani Hapësirnor i Kosovës.

#### 2.2.3.2. RRJETI I TRAFIKUT HEKURUDHOR

Në Klinë gjendet nyja e dytë hekurudhore e Kosovës, pas asaj të Fushë Kosovës. Në këtë nyje degëzohen drejtimet për Pejë dhe Prizren të cilat përmes Klinës lidhen me Fushë Kosovën të cilat më tej degëzohen për Shkup, Nish dhe Beograd.

Meqenëse hekurudha paraqet një potencial të pashfrytëzuar duhet të përparohet funksionimi i saj duke siguruar kushte më të mira hapësinore dhe sigurisë në vendkalime. Kjo nënkupton rivitalizimin e stacioneve ekzistuese si psh ai në Ujëmirë, Budisalc, Pogradjë, Jagodë, Carravik. Parashihet integrimi i stacionit të trenit dhe autobusëve në zonën urbane si dhe sigurimi i çdo vendkalimi të hekurudhës.



## 2.2.4 INFRASTRUKTURA SOCIALE

### 2.2.4.1 ARSIMI

#### INSTITUCIONET SHKOLLORE

- Arsimi fillor dhe i mesëm i ultë

Parimi kryesor në bazë të cilit është hartuar plani është: " *të gjithë duhet të kenë qasje në shërbimet e arsimit* " që buron nga Ligji mbi arsimin fillor dhe të mesëm. Rrjeti ekzistues i arsimt fillor në komunën e Klinës është shumë i shprëndarë dhe përfshirës. Megjithatë ekzistojnë vendbanime edhe pse nuk e kanë shkollën në kuadër të vendbanimit ato janë në kuadër të zonës së mbulimit të shkollës më të afërt ( 15 minuta ecje për fëmiun), ndërsa për vendbanimet të cilat nuk e kanë shkollën dhe nuk janë në kuadër të zonës së mbulimit të shkollës më të afërt, komuna duhet të sigurojë fonde për transport publik për në shkollë. Pra, për këto fshatra janë propozuar forma të ndryshme për sigurimin e këtij shërbimi të detyrueshëm: ndërtimin e objektit shkollor brenda zonës së mbulimit; sigurimi i transprotit publik për në shkollën ame; ndërtimi i shkollave (paraleleve të ndara) për nivelin e prë (fëmijët 6-12) dhe sigurimin e transportit publik për nivelin e dytë të shkollës filllore.

Para se të merret vendim për sigurimin e shkollës është e nevojshme të bëhet një studim fizibiliteti për të vërtetuar se cila është alternative më e qëndrueshme: sigurimi i objektit (që në këtë rast duhet siguruar edhe stafi, mirëmbajtja etj) apo të krijojë sistem të autobusit shkollor që kërkon një rrejt funksional rrugor. Studimii fizibilitetit do të propozojë shkollat e reja për disa zona ose transport të organizuar. Sipas kritereve të qendrave lokale çdo qendër lokale pir shërbimeve tjera duhet të këtë edhe shkollën filllore.

- Arsimi i mesëm i lartë

Për numrin e sotëm të popullsisë 36357 në bazë të standardeve të shërbimit (18000 banorë-një shkollë e mesme e lartë) del se nuk nevojitet shkollë e mesme. Gjithashtu edhe për numirn e parashikuar 42611 banorë sa do t’l ketë komuna në vitit 2022 arsimi mund të organizohet në dy shkollat ekzistuese. Mirépo duke pasur parasysh arsimin bazuar në potenciale ekzistuese të komunës është propozuar një shkollë e mesme profesionale.

- Nevojat e sotme-  $36357:18000=2.02 \sim 2$  (2 ekzistuese)
- Nevojat deri 2022-  $42611:18000=2.37 \sim 2$  (2 ekzistuese, por për shkak të arsimit bazuar në resurse ekzistuese të komunës +1 e re)

Arsimi në këtë nivel duhet të organizohet në tri shkolla , dy nga të cilat janë ekzistuese ( të dytat në qendrën urbane- Klinë) ndërsa tjera e propozuar. Shkolla e re duhet të jetë shkollë për përgatitje profesionale të kuardorve të reja për zhvillim. Sipas vizionit të komunës së Klinës,

bujqësia dhe turizmi janë ndër dy shtyllat kryesore për zhvillim, prandaj plani zhvillimor i komunës së Klinës propozon shkollë për arsimin profesional në lëminë e agrikulturës dhe turizëm.

Sipas kritereve për qendra dhe funksionet e tyre, shkolla e re duhet të vendoset në ndonjëren subqendër. Shkolla profesionale për zhvilliin e agrikulturës dhe turizmit preferohet të vendoset në Zajm. Për t'iushmangur udhëtimeve të gjata të përditshme nga zonat e largëta, mund të sigurohet shërbimi i vendosjes në konvikte për nxënësit e arsimit të mesëm.

#### 2.2.4.2 INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Shërbimet shëdeetësore në komunën e Klinës janë të nivelit primar. Shërbimet organizohen në tri nivele të institucioneve:

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
- Qendra e mjekësisë Familjare
- Ambulanca

Sipas MSHMS- Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenjës Sociale (MSHMS) kriteret për planifikimin e institucioneve shëndetësore janë:

- Për 100 000 banorë nevojitet 1 QKMF
- Për 10 000 banorë nevojitet 1 QMF
- Për 6 000 banorë nevojitet 1 Ambulancë

Ndërsa afërsia që duhet siguruar deri te ndërtesa më e afërt shëndetësore është mes 500-2500 m.

- Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) e cila gjendet në zonën urbane të Klinës mbulon me shërbime gjithë territorin e komunës.
- Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) janë në përputhshmëri me kriteret por në bazë të numrit të parashikuar të banorëve dhe shprëndarjes hapësinore nevojitet edhe një QMF. Ky insitucion propozohet të vednoset në Grabanicë respektivisht ambulanca ekzistuese të shëndërrohet në QMF.
- Ambulacat mund të vendosen në fashatërt me popullatë mbi 2000 e më shumë banorë dhe përkohësisht në fshatërat me më pak banorë deri sa të përmirësohet sistemi i transportit deri në vendbanimin më të afërt me ambulancë.

Për t'u arritur kualiteti i lartë i shërbimit shëndetësor, për distanca lehtë të arritshme për tërë popullatën e komunës, Qendrat e Mjekësisë Familjare në parim duhet të jenë të vendosura në të gjitha qendrat (subqendrat dhe qendrat lokale). Pasi që të gjitha qendrat lokale brenda zonës së mbulimit nuk përfshijnë numër të mjaftueshëm të popullatës që do të arsyetonte

ekonomikisht funksionimin e QMF-së, koncepti I vendosjes së këtyre qendrave në të gjitha qendrat lokale mund të jetë një qëllim afatmesëm ose afatgjatë varësisht prej zhvillimeve në të ardhmen. Në ndërkokë, shërbimet e ambulancave në qendrat lokale pjesërisht mund të zhvillohen në drejtim të QMF-së. mundësi tjetër është edhe themelimi I një Qendre të Mjekësisë Familaje të përbashkët për dy qendrat lokale me orar të shkurtuar ( gjysëm dite ose dy-tre herë në javë) ndërsa pjesën tjetër të funksionojë si ambulancë. Duhet përmenduar se sipas llogaritjeve statistikore është e nevojshme edhe një QMF e cila duhet të planifikohet në ndonjënë subqendër.

Momentalisht janë 3 QMF te cilat gjenden në Sferkë, Zllakuqan dhe Ujëmirë. QMF-ja e propozuar është planifikuar në subqendrëne re- Grabanicën. Ndërsa për subqendrën e re Gllarevë është planifikuar një ambulancë për shkak të afërsisë me QMF-në e cila gjendet në Ujëmirë.

#### 2.2.4.3 INSTITUCIONET E SHËRBIMEVE PUBLIKE DHE ADMINISTRATIVE

Komuna e Klinës momentalisht administrohet nga 9 zyre vendi nga 54 vendbanimet e saj. Të gjitha subqendrat dhe qendrat lokale duhet të kenë qendra të komunitetit. Qendra e komunitetit përveç funksioneve publike administrative do të ofrojë hapësira për kulturë, shërbime postare, bankare etj. Brenda këtyre qendrave mund të vendosen edhe shërbime tjera si sportel banke, asociacione dhe klube shoqërore, bibliotekë, klube kulturore etj. Ndërtesa e qendrës së komunitetit mund të jetë shumëfunksionale për të mundësuar veprimitari dhe aktivitete të ndryshme për komunitetin.

#### 2.2.4.4 SPORTI DHE REKREACIONI

Një ndër qëllimet afatgjata të komunës duhet të jetë sigurimi I hapësirave për sport dhe rekreim. Sporti dhe rekreacioni janë funksion I domosdoshëm për krijimin e një popullate të shëndoshë në pikëpamje fizike dhe mendore.


Hapërsirat për sport dhe rekreacion duhet të sigurohen në çdo vendbanim. Ato mund të janë në kuadër të hapësirës shkollorë, si pjesë e oborrit shkollor me shkfrytëzim të organizuar jashtë orarit të mësimit ose të veçanta varësisht nga mundësitetë dhe kërkuesat.

Hapësirat sportive në nivelin e komunës janë në Klinë- stadioni dhe palestra sportive dhe ato janë në shërbim të qytetarëve të komunës. Sporti dhe rekreacioni në hapësirat natyrore është I lidhru me llojet e sporteve të cilat janë të popullarizuara në ditët e sotme. Për sportet si të cilat mund të zhvillohen psh në Mirsuhë si alpinizmi , speleolizmi krijimin I mundësive adekuate do të jetë detyrë e planit të turizmit pasi që këto aktivitete do të janë pjesë e ofertës për turizëm.

Sipas PH, në zonën e IV-të në vendbanimet përrreth kufirit të parkut do të zhvillohet turizmi rural.<sup>5</sup>

---

<sup>5</sup> Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- Instituti për Planifikimi Hapësinor (2012) “Draft Plani Hapësinor- Monumenti I natyrës me rëndësi të veçantë ‘Ujëvarat e Mirushës” , fq 61



Harta 4. Infrastruktura sociale

## 2.2.5 INFRASTRUKTURA TEKNIKE

### 2.2.5.1 FURNIZIMI ME UJË I VENDBANIMEVE

Në bazë të numrit të planifikuar të banorëve për Komunën e Klinës sasia e nevojshme për furnizim me ujë të tërë komunës është rreth  $Q=120 \text{ l/s}$

Topografia e komunës së Klinës mundëson që të furnizohet të gjitha vendbanimet me ujë nga një qendër. Kjo mund të arrihet me anë të shtimit të dy sistemeve të reja.

Furnizimi me ujë i tërë komunës nga një qendër është shumë më ekonomik, më higjenik dhe më i lehtë për mirëmbajtje.

#### KONCEPTI I ZGJIDHJES- SISTEMI 1

Nga stacioni i pompave ekzistues, afër burimit, uji dërgohet në rezervuar mbi fshatin Qabiq dhe nga ky rezervuar do të furnizohet me ujë këto vendbanime:

1. Siqevë
2. Ujëmirë
3. Dobërdoll
4. Gjurgjevik i Madh
5. Zabërgjë
6. Qabiq
7. Caravik
8. Burim
9. Gllarevë
10. Rigjevë
11. Përqevë

Nga ky rezervuar do të mund të furnizoheshin, në rast nevoje edhe rezervuarët ekzistues të sistemit të Sferkës dhe Gremniku.

#### SISTEMI 2

Rezervuarit ekzistues mbi qytet duhet t'i shtohet edhe një rezervuar tjeter dhe nga rezervari i ri, uji me anë të pompave do të shkoj deri te rezervuari i ri i planifikuar që do të jetë mbi Leskoc.

Nga ai rezervuar do të shpërndahet rrjeti i ri i ujësjellësi i cili do të furnizoj me ujë këto vendbanime:

1. Leskoc
2. Dranashiq
3. Renoc
4. Zlakuqan

5. Radulloc
6. Krushevë e vogël
7. Gjurgjevik i Vogël
8. Rudicë
9. Stupë
10. Budisalcë
11. Nagllavë
12. Krushevë e Madhe
13. Jagodë
14. Videjë
15. Deiq
16. Zajm
17. Dollovë
18. Petriq i Poshtëm
19. Petriq i Epërmë
20. Drenoc
21. Dugajevë
22. Bokshiq

Nga ky sistem mund të furnizohet me ujë edhe vendbanimet që momentalisht kanë furnizim vetanak të ujit si: Berkova, Grabanica dhe sistemi i Qeskovës dhe Këpuzit të cilët koëpaskohe kanë problem me sasinë e ujit.

#### 2.2.5.2 RRJETI I KANALIZIMIT

Njëri nga problemet më serioze mjedisore në Kosovë është shkarkimi i ujërave të ndotura dhe të patrajuara në kanale, përroska, lumenj.

Njëri nga objektivat e parashtuar në Planin e Kosovës për Veprimin në Mjedis 2006-10 (KEAP) është rehabilitimi dhe ndërtimi i infrastrukturës (rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe objektet për trajtimin e ujërave të zeza, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe përmbushjes së nevojave të popullsisë dhe ekonomisë. KEAP-i pranon faktin se Kosova ka rezerva të resurseve të kufizuara ujore, që do të janë faktor kufizues i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. Prandaj KEAP-i fton për një plan të veprimit për ndërtimin e impianteve prioritare për trajtimin e ujërave të zeza në zonat urbane me mbi 10,000 banorë në periudhën 2006 – 2013.

Edhe pse në Klinë nuk ka objekte për trajtimin e ujërave të zeza, popullsia e Klinës dhe ekonomia vendore e bëjnë vetëm një pjese të vogël të ndotjes së resurseve ujore. Burimet kryesore të ndotjes janë komunat e epërme: të Pejës në perëndim, Istogut në veri dhe Skenderajt në veri-lindje (vendbanimet më poshtë se impianti ekzistues për pastrimin ujërave të zeza). Përkatesisht lumenjtë Lumbardhi i Pejës, Lumbardhi i Istogut dhe Lumi Klina i derdhin ujërat e ndotura dhe ujërat e zeza industriale nga këto komuna në drejtim të Klinës.

Autoritetet mjedisore duhet gjithmonë të kërkojnë nga bizneset e mëdha, në veçanti ato që prodhojnë sasi të mëdha të ujërave të zeza, ujërave të zeza me koncetrim të lartë të ndotësve ose lëndëve ushqyese, dhe mbeturinave të rrezikshme të lëngëta që të sigurojnë objektet e veta për impiantet për trajtim, të cilat që kontrollohen rregullisht nga institucionet e pavarura. Në sajë të natyrës bujqësore të ekonomisë vendore në Klinë, fokusi bie vetëm në sistemet për trajtimin e ujërave të zeza komunale (amvisërisë), të cilat mund të konsiderohen si burime kryesore të ujërave të zeza në Klinë.

Të gjitha vendbanimet që kanë sistem të kanalizimit, duke përfshirë edhe qytetin e Klinës, ujërat e zeza i shkarkojnë në lumenjtë më të afërt pa ndonjë trajtim paraprakë. Pra, janë ndotës të drejtpërdrejt të lumenjve.

Në fshatrat tjerë ku nuk ka rrjet të kanalizimit, banorët shkarkimin e ujërave të zeza e bëjnë numër gropë klasike, nëpër jaze ose kanale sipërfaqësore, kurse shtëpitë ose grup shtëpisë që kanë afër lumenj shkarkimin e ujërave të zeza e bëjnë drejtpërdrejt në lumë pa ndonjë trajtim paraprak.

#### KONCEPTI I ZGJIDHJES

Topografia e komunës së Klinës, përpos në disa vendbanime, lejon që të gjithë ujërat e zeza të koncentrohen në dy kolektor kryesor. Kolektorët kryesor do të janë në dy anët e lumit Drini i Bardhë.

Të gjitha komunat duhen të kenë impiantin për pastrimin e ujërave të zeza. Për komunën e Klinës impianti duhet të jetë në pikën më të ulët të komunës e që është në lokacionin në afersi të derdhjes së lumit Mirusha në Drini e Bardhë.

Në këta kolektor do të shkarkohen ujërat e zeza edhe të vendbanimeve që kanë sistem të kanalizimit fekale.

Nga këta kolektor ujërat e zeza do të shkarkoheshin në impiantin për pastrimin e lartpërmendor të ujërave të zeza.

Në kolektorin kryesor që do të jetë në anën e djathtë të lumit Drini i Bardhë do të shkarkoheshin ujërat e zeza që të vendbanimeve që ndodhen në anën e djathtë të lumit siç janë:

1. Stupë
2. Budisalcë
3. Nagllavë
4. Krushevë e Madhe
5. Jagodë
6. Videjë

7. Deiq
8. Zajm
9. Dollovë
10. Petriq i Poshtëm
11. Petriq i Epërmë
12. Drenoc
13. Dugajevë
14. Bokshiq
15. Grabanicë
16. Qeskovë dhe
17. Këpuz

Kurse në kolektorin tjetër kryesor që është në anën e majtë të lumit Drini i Bardhë do të shkarkoheshin ujërat e zeza nga vendbanimet që janë në anën e majtë të lumit siç janë:

1. Berkovë
2. Leskoc
3. Dranashiq
4. Zlakuqan
5. Grapc
6. Bingjë
7. Shtupel
8. Radulloc
9. Krushevë e Vogël
10. Gjurgjevik i Vogël
11. Klinë
12. Jashanicë e Epërmë
13. Kërnicë
14. Jashanicë
15. Resnik
16. Jellocë
17. Siqevë
18. Dush
19. Pogragjë
20. Gjurgjevik i Madh
21. Dërsnik
22. Dollc
23. Gremnik
24. Qupevë
25. Qabiq
26. Zabërgjë
27. Dobërdoll
28. Ujëmirë


29. Gllarevë
30. Përqevë
31. Sferkë
32. Dush i vogël
33. Volljakë

Ujërat nga kolektorët kryesor do të shkarkoheshin në impiantin kryesor të komunës së Klinës. Pasi që ka qenë e pamundur që ujërat e zeza nga Caraviku, një pjesë e Rixhevës dhe Burimi të shkarkohen në kolektorët kryesor është paraparë që:

- Caraviku të ketë impiantin vetë dhe ujërat e filtruar të shkarkohen në lumin e afërt
- Rixheva dhe Burimi do të kenë një kolektor të përbashkët dhe nga kolektori ujërat do të shkarkohen në impiant, prej nga ujërat e filtruar të shkarkohen në lumin më të afér në drejtim të Kijevës

## PLANI ZHVILLIMOR I KOMUNËS SË KLINËS


URBAN PLUS



Harta 5. Rrjeti i ujësjellësit

## PLANI ZHVILLIMOR I KOMUNËS SË KLINËS

URBAN PLUS



Harta 6.Rrjeti i kanalizimit

### 2.2.5.3 FURNIZIMI ME ENERGJI ELEKTRIKE DHE TELEKOMUNIKIMIET

Propozimet teknike të zhvillimit të rrjetit elektroenergetikë janë dhënë bazuar në procedurat bazike që aplikohen gjatë planifikimit të një SEE, si dhe nga të dhënat për numët të popullsisë të marra nga pjesa arkitektonike e projektit.

Zgjerimi i rrjetit elektroenergetik synon t'i sherbej dhe të jetë në harmoni me rritjen e numrit të banorve dhe zgjerimin e vendbanimeve në këtë periudhë. Ky sistem duhet gjithashtu ti plotësoj nevojat në rritje të sektorve të ndryshem ekonomik të kësaj komune.

Procedurat e parapara nga IEC-ja për përpilimin e planeve të sistemeve elektroenergetike janë:

- 1. Mbledhja e shënimave për rrjetin ekzistues*
- 2. Analiza e rrjetit ekzistues*
- 3. Ngarkesa aktuale dhe ajo e parashikuar*
- 4. Planifikimi optimal i lokacionit, madhësisë dhe zonës së TS 20/0.4kV.*
- 5. Planifikimi i rrjetit distributiv 20kV.*
- 6. Planifikimi i rrjetit distributiv 230/400V.*

Nga përshkrimi i gjendjes aktuale u pa se rrjeti distributiv ekzistues në pjesën më të madhe është i ndërtuar para më se 20 viteve, që dmth se linjat ajrore janë në gjendje teknike të keqe, ndërsa kabllot që tani furnizojnë shpenzuesit janë dielektrikisht të dobësuara, veqanërsisht kabllot e tensionit 10kV, të shtrira në kanale pa kanalizim kablovik. Shumica e trafostacioneve janë të tensioneve 10/0.4kV. Ndriçimi publik në vetëm disa rrugë kryesore është relativisht në gjendje të mire, por mungon në pjesën më të madhe.

Duke u nisur nga gjendja ekzistuese si dhe nga propozimeve arkitektonike, SEE distributiv dhe Sistemi Telekomunikues duhet të realizohen në përputhje me dy rekondime të dhëna në vazhdim:

- 1. REKOMANDIMET E MASTER PLANIT PER ZHVILLIMIN E SISTEMIT DISTRIBUTIV TË KOSOVËS DERI MË VITIN 2015, QË PËRFSHINË:**
  - Eliminimin gradual të TS 35/10kV dhe kalimin në TS 110/20kV
  - Kalimin nga rrjeti distributiv 10kV ne rrjetin distributiv 20kV
  - Zëvendësimin e TS 10/0.4kV me ata 20/0.4kV
  - Zëvendësimin i Linjave Ajrore 230/400V me kabllo bistek apo edhe kabllo nëntokësorë.
- 2. REGULLORET E IEC, IEEE DHE ANSI QË PËR PROJEKTE TË REJA NE VENDE URBANE, LINJAT E FURMIZIMIT ME ENERGJI ELEKTRIKE DHE ATO TË RRJETIT TELEKOMUNIKUES TË NDJEKIN TË NJEJTËN TRASË DHE TË REALIZOHEN NË TË NJEJTËN KOHË.**

Rekomandimet dhe rregulloret e lartëshënuara obligojnë që SEE dhe SK të realizohen ashtu që të plotësojnë nevojat e banorëve të komunës përfurnizim të pandërprerë me energji elektrike dhe telekomunikim.

Në tabelën tab.1 janë dhënë vlerat e fuqive të Trafostacioneve aktuale dhe atyre të propozuara në lokacionet e dhëna shtojcën 1.

TRAFOSTACIONET 10(20)/0.4kV EKZISTUESE DHE TË PROPOZUARA NË KOMUNËN E KLINËS				TS EKZISTUESE NE AMVISNI	TS EKZISTUESE NE INDUSTRI	TRAFOSTACIONE TE PROPOZUARA
Nr.	VENDBANIMI	Nr. i ban E	Nr. i ban. P	kVA	kVA	kVA
1	Klinë	5452	6,390	7270	3960	1000
2	Dollcë	276	323	100	0	160
3	Dresnik	177	207	520	0	0
4	Gremnik	1127	1,321	410	100	630
5	Zajmi	1274	1,493	320	0	1000
6	Deiqi	376	441	200	0	250
7	Videja	532	624	350	0	250
8	Krusheva e Vogel	327	383	160	0	250
9	Gjurgjevik i Vogel	734	860	460	0	400
10	Klinavc	480	563	360	0	250
11	Jagoda	195	229	250	160	0
12	Budisalc	397	465	960	0	0
13	Rudica	453	531	510	0	0
14	Krushevë e M.	585	686	570	160	160
15	Stupë	174	204	320	0	0
16	Nagllavk	67	79	50	0	0
17	Zllakuqani	659	772	460	150	250

18	Ranoci dhe Leskoci	353	414	310	0	160
19	Radulloci	321	376	420	0	0
20	Berkova	246	288	260	0	0
21	Drenoci	442	518	200	0	250
22	Grabanica	728	853	710	660	0
23	Dugajeva	400	469	200	0	250
24	Pjeterq i Ulet	188	220	100	100	160
25	Pjeterq i Eper.	563	660	260	0	400
26	Bokshiq	342	401	300	0	0
27	Dollovë	444	520	260	0	250
28	Kepuz	622	729	260	0	400
29	Qeskovë	374	438	100	0	400
30	Jashanicë	1786	2,093	760	0	1260
31	Pogradja	366	429	310	50	250
32	Resnikë +Jellovc	426	499	260	0	250
33	Dush	196	230	100	0	160
34	Gjurgjevik i madh	449	526	370	100	250
35	Ujmiri	544	638	860	0	250
36	Qabiqi	861	1,009	320	0	630
37	Siqeva	1306	1,531	510	0	1000
38	Doberdoli	339	397	370	0	0
39	Gllareva	2196	2,574	770	750	1260
40	Rixheva	482	565	320	0	250
41	Caraviku	1241	1,454	420	0	1000

42	Zabergja	728	853	160	0	630
43	Sferka	2461	2,884	740	0	2000
44	Dushi i Vogel	241	282	160	100	160
45	Volljaka	929	1,089	900	2210	0
46	Qupeva	584	684	250	0	400
47	Perqeva	998	1,170	250	0	1000
48	Shtupeli	778	912	710	0	250
49	Kerrnica	794	931	360	160	630
50	Bingja+Grapc	323	379	510	0	0
51	Dranashiq	21	25	30	0	0
<b>Gjithsej</b>		<b>36357</b>	<b>42611</b>	<b>26090</b>	<b>8660</b>	<b>18500</b>

Tab.3 Trafostacionet aktuale dhe të propozuara në vendbanime

Duke pasur për bazë ate që u tha me lart në këtë projekt janë parapa zgjedhjet e mëposhtme:

1. Trafostacionit aktual 110/20(10)kV 1x31.5 MVA duhet t'i shtohet edhe një transformator 31.5MVA me qellim të plotësimit në tërësi të kushtit N-1 në anën 110kV-she.
2. Te gjitha linjat mbrenda qytetit dhe në rrethinën e paraparë për zgjerim të qytetit në të ardhmen duhet të kryhen me kabllo 20kV-she. Kabllot duhet të vendosen në kanale kabllovikë nëntokësore.
3. Te gjitha kabllot në qytet duhet të jenë të tipit XHP 49A (185 deri 300) mm<sup>2</sup>. Këto kabllo duhet të bartin ngarkesen e qarkut të cilit i takojnë dhe ngarkesen e qarkut të unazës në të cilën ndodhet në rast të ndonjë havarie në SEE.
4. Linjat ekzistuese ajrore në qytet dhe rrëthinen e planifikuar për zgjërim deri në vitin 2020 duhet tërsisht të zëvendësohen me linja kabllore 20kV-she.
5. Në fshatra të komunës së Klinës linjat edhe më tutje mund të mbisin ajrore. Linjat e reja duhet të ndërtohen në shtylla betoni dhe për tension punues 20kV.
6. Për të kaluar nga niveli i tensionit 10kV në nivelin 20kV, sipas rekondimeve të master planit për zhvillimin e sistemeve distributive të Kosovës, duhet që deri në vitin 2020 të zëvendësohen të gjithë transformatoret e paraparë për punë vetem nën tension 10kV me transformatorë të tensionit 10(20)/0.4kV/kV.
7. Trafostacionet e reja duhet të ndërtohen për punë nën tensione 10(20)kV.

E6

8. Fuqia elektrike e nevojshme dhe numri i trafostacioneve në vendbanime është caktuar në mënyrë empirike duke u bazuar në numrin e banorëve. Nën supozimin se nxemja e objekteve nuk do të jetë me rrymë është parashikuar që për një banorë të sigurohet fuqi e instaluar në trafostacione në vlerë prej 1kVA/banorë.
9. Rrjetet e tensionit të ulët duhet të planifikohen gjithashtu me shtylla betoni dhe me kabllo vetëmbajtëse Alumini. Në këto shtylla duhet të planifikohet edhe ndriçimi publik i rrugëve.

#### PLANIFIKIMI I NDRIÇIMIT TE RRUGËVE

Të gjitha rrugët që do të ndërtohen duhet të jenë të ndriçuara. Rruget me gjërsi të përgjithshme deri në 12 duhet të ndriçohen vetem nga njëra anë. Rrugët me të gjëra se 12m ndriçohen nga të dy anet.

Ndriçimi publik i rrugëve kryesore në pjesët urbane duhet të bëhet me llampa natriumi me fuqi 250 $\ddot{E}$  të vendosura në shtylla metalike me lartësi (8-10)m. Kyçja dhe shkyçja e llampave do të jetë automatike, ndërsa në kohën kur rrugët nuk janë shumë të frekuentuara (pas mesnate) llampat më mënyrë automatike do të ndizen në gjysmën e fuqisë nominale.

Në fshatra duhet të parashifet ndriçimi i rrugëve me llampa të vendosura në linjat e tensionit të ulët të tipit natrium me fuqi 250 $\ddot{E}$ .


#### PLANIFIKIMI I SISTEMIT TË TELEKOMUNIKIMIT

Rrjeti telekomunikues, ku përfshihet edhe internet, deri në vitin 2020 në pjesët urbane të qytetit duhet të bëhet tërsishtë nëntokësorë dhe me mundësi të tipit “*Kabllo optik në shtëpi*”

Në pjesën rurale duhet të planifikohet zgjërimi i rrjetit telekomunikues dhe atë përmes kabllove me fije optike të vendosura në shtyllat e njëjtë me ato të tensionit të ulët. Këto kabllo duhet të mundësojnë bartjen edhe të internetit dhe të televizionit kablovik.

## PLANI ZHVILLIMOR I KOMUNËS SË KLINËS

URBAN PLUS



Harta 7. Rrjeti aktual dhe ai i propozuar i SEE dhe SK në komunën e Klinë

### **2.2.5.5 MENAXHIMI I MBETURINAVE**

Komuna duhet të ndërmerr masat dhe veprimet e nevojshme për trajtimin e mbeturinave në bazë të kompetancave të deleguara nga kompania rajonale e menaxhimit te mbeturinave. Se bashku me kompaninë rajonale është I mundshëm përmirësimi I situatës aktuale në menaxhimin e mbeturinave. Ku krijimi I një rrjeti funksional I mbledhjes së mbeturinave është bazë për manxhimin efikas të tyre.

Një çështje tjeter me rëndësi është riciklimi I mbeturinave. Komuna duhet të shqyrtojë politikat e selektimit të mbeturianve dhe riciklimit. Kjo mund të ketë ndikimi në krijimin e vendeve të reja të punës, kurse riciklimi mund të zhvillohet si veprimtari ekonomike. Secili rast duhet I deponimit ilegal duhet të trajtohet ndaras dhe duhet të mdërmirren masat për mbylljen, spastirmin dhe konsolidiin e tokës. Këto veprime duhet të ndërmirren sa bashku me Agjensionin për Mbrotjen e Mjedisit.

### **2.2.6 MJEDISI DHE PEIZAZHI**

Peizazhi I pasur dhe i bukur luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e turizmit. Së bashku me monumentet kulturore paraqet një resurs me vlerë për komunën I cili duhet të shfrytëzohet për zhvillimin e turizmit dhe aktiviteteve rekreative si dhe në të njëjtën kohë të mbrohen nga zhvillimet e paplanifikuar dhe ndotjet e llojeve të ndryshme. Monumentet natyrore dhe kulturore si dhe peizazhet me vlerë duhet të konsiderohen si trashëgimi nacionale dhe të shfrytëzohen në mënyrë të qëndrueshme.

#### **2.2.6.1 TRASHËGIMIA DHE RESURSET NATYRORE**

Trashëgimia dhe resurset natyrore kanë rol të rëndësishëm për zhvillim ekonomik në komunën e Klinës. Këtu ekzistojnë shumë monumente dhe tërësi natyrore të mbrojtura me Ligjin për Konservimin e Natyrës, sipas të cilës biodiversiteti dhe peizazhet e larmishme me vlerë duhet të mbrohen me çdo kusht. Prandaj, komuna duhet të ndërmerr një sërë masash dhe veprimesh për të penguar veprimet e dëmshme të njeriut në natyrë.

**Monumenti I natyrës “Mirusha”**- karakterizohet si zonë me interes të veçantë e cila përfshinë sipërfaqe prej 598.4 ha<sup>6</sup>. Kanoni I Mirushës e cila gjendet në rrjedhën e poshtme të lumit Mirusha shquhet me format e saj impozante morfollogjike të sajaura nga 16 liqene dhe 12 ujëvara me forma, sipërfaqe dhe lartësi të ndryshme.

Plani i Monumentit të natyrës “Mirusha” do të përcaktojë mundësitë e zhvillimit të turizmit dhe veprimtarive tjera ekonomike si dhe përgjegjësive të komunës në mbrojtjen e vlerave natyrore dhe kulturore të identifikuara.

<sup>6</sup> Draft Plani Hapësinor Ujëvarat e Mirushës, fq 14.

**Monumente tjera natyrore-** në territorin e komunës së Klinës ka vendbanime në të cilën gjenden një ose më shumë monumente natyrore me veçri specifike dhe vlera unike-rariteti, veçori natyrore, vlera rekreative ose estetike dhe vlera të posaçme kulturore.

Llojet e ndryshme të monumenteve natyrore duhet të trajtohen me metoda të ndryshme të mbrojtjes. Janë dy lloje të monumenteve natyrore në komunën e Klinës :

- Hidrologjike
- Botanike

Monumentet natyrore më veçori hidrologjike janë të rëndësisë së veçantë të cilat gjenden në listën e zonave të mbrojtura natyrore:

- Burimi i ujit mineral në Drsnik
- Burimi i ujit minaral në Rudicë
- Gryka e lumit Klinë
- Kompleksi i trungjeve të rrënjos në Gllarevë (*Quercus robus*)
- Trungu i qarrit në Zllakuqan (*Quercus cerris*)
- Trungu i rrënjos në Deiq (*Quercus robus*)
- Trungu i qarrit në Nagllavkë (*Quercus cerris*)
- Trungu i bungut në Ujëmirë (*Quercus pubescens*)

Burimet e ujërave minerale në Klinë hyjnë në kategorinë e tretë të mbrotjes (neni 4, nr. 40 – 13/07 Udhëzimi Administrativ- Kriteret për përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Ujore dhe masat e tyre mbrojtëse për burimet e ujit që përdoren për pije)

**Shpellat-** në komunën e Klinës shumica e shpellave gjenden në zonën e kanjonit të Mirushës si dhe në Dush, si : shpella e Kishës së madhe, shpella e kishës së vogël, shpella te liqeni i dhjetë, shpella te liqeni i nëntë, shpella karstike, shpella e madhe dhe shpella e Dushit.

Këto shpella duhet të hulumtohen dhe të shpallen me të drejtë për shfrytëzim për vizita turistike ose të tjera (neni 21, Ligji për Konservimin e natyrës, pika 3). Të gjitha këto duke i paraprirë me informata, harta dhe pajisje të nevojshme për vizitorët.

#### 2.2.6.2 PEIZAZHI

Pjesën më të madhë të territorit të komunës së Klinës e përbëjnë rrafshinat dhe tokat pjellore por bashkë me pojesën tjeter bën që Klina të këtë peizazhe natyrore të llojeve të ndryshme si: peizazhe bujqësore, peizazhe rurale, peizazhe të livadheve, peizazhe lumore, peizazhe shkëmbore- ujore etj.

## 2.2.7 RREZIQET

### 2.2.7.1 MASAT E MBROTJES

Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni duhet të deklarohen si zona në të cilat komuna merr përgjegjësinë për masat dhe veprimat e nevojshme për të parandaluar vërshimet dhe erozionin dhe të minimizojë pasojat e fatkeqësive. Këto masa dhe veprime duhet të kryhen në bashkëpunim me insitucionat përgjegjëse si : MMPH, MBPZHR, MSHP, MEF, Agjensioni për Mbrojejn e Mjedisit, Megjensioni e pyjeve si dhe SHPK, TMK dhe KFOR-i.

Masat e domosdoshme të mbrojtjes janë dhënë në Planin Hapësinor të Kosovës, në kapitullin “Strategjia e Zhvillimit Hapësinor/ kreu 12 – Vërshimet dhe Zonat e Rrezikut nga Erozioni”. Këto masa janë dhënë si udhëzime për komunat, institucionet e qeverisë dhe institucionet tjera publike. Ato duhet të janë të organizuara mirë dhe të koordinuara nga institucionet publike, siç janë Shërbimi Policor i Kosovës, Trupat Mbrotjëse të Kosovës dhe zjarrfikësit. Këtu përfshihet edhe KFOR-i, si një nga partnerët e komunës. Përgjegjësia e këtyre institucioneve është të ndërmarrin veprime të domosdoshme parapërgatitore për sigurimin e mobilitetit të njerëzve të involvuar në veprimet që duhet të kryhen. Ndërtimi i bazës së shënimeve për rrjedhën e lumenjve dhe erozionit, është e domosdoshme për ndërmarrjen e masave mbrojtëse dhe veprime të zbutjes së pasojave nga fatkeqësitet. Së bashku me MMPH, baza e shënimeve do të plotësohet me shënimë të reja, në harmoni me rregulloret e Departamentit të Ujërave në MMPH.

Parandalimi i erozionit është i nevojshëm për mbrojtjen e resurseve natyrore si toka bujqësore, rrjedhat lumore, pyjet, peizazhet natyrore, por edhe të mirave të krijuara nga njeriu siç janë vendbanimet, infrastruktura rrugore. Erozioni mund të parandalohet nëse komuna e ndërtzon një politikë e cila kërkon nga të gjithë banorët, shfrytëzuesit e tokës, maleve, pyjeve, ujit dhe pasurive tjera natyrore, t'i shmangen veprimeve që mund të shkaktojnë erozion.

Masat e domosdoshme për të parandaluar erozionin janë:

- Masat Hidraulike
- Masat Bujqësore
- Masat Biologjike

Sistemi paralajmërues mbi fatkeqësitetë si vërshimet, erozioni, zjarri dhe rreziku seizmik duhet të ndërtohet së bashku me SHPK, FAK, UNMIK dhe KFOR.

## **2.3 SHËNIMI I ZONAVE URBANE EKZSITUQE DHE TË PROPOZUAR PËR ZHVILLIMIN E ARDHSHËM DHE NDËRTIMIN E ZONAVË JASHTË ZONËS URBANE**

Zonat e propozuara për zhvillim jashtë zonës urbane, varen nga interesit për investime. Më poshtë janë dhënë zhvillimet e mundshme jashtë zonës urbane:

- Parku Industrial/Biznesi
- Shkolla profesionale

Zhvillimet të cilat mund të ndodhin jashtë zonës urbane, duhet të ndjekin procedurën e posaçme bazuar në Ligjin mbi Planifikim Hapësinor.

## **2.4 SHËNIMI I NDËRTIMEVE TË RËNDËSISHME, PROJEKT STRATEGJIK OSE ZONA TË VEÇANTA TË APROVUARA NË PLANIN HAPËSINOR TË KOSOVËS OSE PLANET TJERA**

Sipas Planit Hapësinor të Kosovës si zonë e veçantë është propozuar:

- Monumenti i Natyrës "Mirusha"

Kanjoni i Mirushës si një monument natyror me vlera të posaçme do të këtë ndikim direkt në zhvillimin ekonomik. Me këtë monument, përfitim i rëndësishëm për komunën konsiderohen hapësirat të cilat do të ndikojnë në zhvillimin e turizmit.

Me planin e Ahtisaarit zona të veçanta të mbrojtura janë:

- Manastiri i Budisalcit
- Manastiri i Dollcit
- Hermitazhi me kishë apo Kisha e Heremitëve

Këto zona duhet të trajtohen sipas ligjit për Zonat e Veçanta të Mrojtura dhe kufijtë e tyre të përcaktohen sipas hartave.

*"Zonë e Veçantë e Mbrojtur do të jetë një zonë e përcaktuar në hartë ose me një zonë të përcaktuar që rrëthon një monument, ndërtesë, grup ndërtesash, tèrësi, fshat ose qendër historike të qytetit që mbrohet nga çdo zhvillim apo aktivitet i cili mund të dëmtojë kontekstini e tij historik, kulturor, arkitektural apo arkeologjik, mjedisin natyror apo kuadrin vizual estetik.*

*Çdo aktivitet i ri në fushat e mëposhtme do të ndalohet (sipas nenit 5 të Ligjit për ZVM-të):*

a) *ndërtimet apo zhvillimet industriale, të tillë si eksplorimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerale dhe ndërtimi i digave, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave dhe fabrikave dhe rrugëve tranzite në zonat rurale: dhe*

b) *Ndërtimet apo zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit*

*Çdo aktivitet i ri nga lista e mëposhtme e aktiviteteve mund të kufizohet nëse e kërkojnë rrethanat (sipas nenit 6 të Ligjit për ZVM-të). Para se të kryhen aktivitetet e tillë në fushat e mëposhtme, komuna përkatëse do të kërkojë marrëveshjen e Kishës Ortodokse Serbe. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje, palët do t'ia referojnë çështjen KZM-së për shqyrtim, nëpajtueshmëri me pikën e tij 4 të këtij ligji:*

- a) *ndërtimet apo zhvillimet komerciale të tillë si: strukturat apo godinat më të larta si manastiri /kisha/, monumenti kulturor që duhet të mbrohet: ndërtimi i rrugëve, ndërtimi i magazinave, punëtorive, shitoreve, restoranteve, bareve, kafititoreve, hoteleve/moteleve, tezgave dhe kiosqeve ushqimore, stacioneve të furnizimit me karburant dhe riparimit të automjeteve, supermarketeve, klubeve të natës apo ndonjë ndërtim tjetër në shkollë më të gjërë në zonat rurale:*

b) Tubimet, argëtimi dhe zbavitja publike; dhe

c) Urbanizimi i tokës bujqësore.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të sigurojë që planet hapësinore brenda Zonave është Veçanta Të Mborjtura të jenë në pajtueshmëri me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të këtij ligji dhe në pajtueshmëri me nenet 12,13,14 të Ligjit mbi Planifikimin Hapësinor (sipas nenit 10 të Ligjit të ZVM-ve).


10.2 Autoritetet lokale do t'i përbahen plotësisht dispozitave të nenit 10"



Hart a 8 . Manastiri i Budisalcit, Budisalc..



Harta 9. Manastiri i Dollcit, Dollc



Harta 10. Hermitazhi me kishë-Kisha e Heremitëve, Ularicë.

## 2.5 VLERËSIMI I NDIKIMIT SOCIO-EKONOMIK DHE MJEDISOR TË KORNIZËS SË PROPOZUAR

Planifikimi manifestohet me ndikime në jetën e njerëzve – zhvillimin social dhe ekonomik. Të gjitha zhvillimet ekonomike, pos ndikimeve në shoqëri, karakterizohen edhe me ndikime në mjedisin që e rrethon.

Zhvillimet në raport me territorin mund të jenë të shprehura në tri forma:

- Okupimi i territorit të ri
- Transformimi i zonës ekzistuese të ndërtuar nga shfrytëzimi ekzistues në lloje tjera të destinimit me një ose më shumë funksione
- Rikonstruktimi dhe rigjenerimi i zonave të trashëgimisë historike dhe kulturore.

Të gjitha ndryshimet të cilat pasojnë nga zhvillimi, kanë ndikimet e veta pozitive dhe negative në jetën e njeriut, zhvillimin ekonomik dhe social si dhe në mjedis. Meqenëse hapësira planifikohet në bazë të parimeve të cilat kanë për qëllim përmirësimin e kualitetit të jetës së banorëve, plani vjetvjeti nënkupton se zhvillimet të cilat parashihen duhet t'i minimizojnë ndikimet në mjedis, që është kushti ekzistencial për njeriun dhe gjallesat. Zhvillimi karakterizohet edhe me ndikime negative, jo vetëm në mjedis, por edhe në jetën shoqërore të njerëzve, zhvillimin e tyre socio-ekonomik. Për të minimizuar dhe eliminuar këto ndikime, plani do të përcaktojë strategjitet e veprimit dhe dispozitat të cilat sigurojnë një kornizë të zhvillimit socio-ekonomik, për të përmirësuar kualitetin e jetës dhe mirëqenien e njerëzve në një mjedis të shëndoshë dhe me shkallë sa më të vogël të ndikimeve negative.

Korniza e paraparë zhvillimore është e orientuar kah veprimi. Ajo parasheh zhvillime, të cilat banorëve të komunës së Klinës duhet t'u sjellin përparim në aspektin social dhe ekonomik. Zhvillimi i mbështetur në tri shtylla, tenton t'i mobilizojë të gjitha resurset e zhvillimit ekonomik, me qëllim të shtimit të numrit të vendeve të punës, rritjes së kualitetit të prodhimeve dhe për t'i dhënë një identitet regionit. Zhvillimi ekonomik duhet të përkrahet nga një zhvillim social i përparuar në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe sportit. Zhvillimi ekonomik dhe social duhet të mbështeten nga një infrastrukturë funksionale si dhe shërbime më të mira për qytetarët. Në zonat ku zhvillimi ekonomik është i bazuar në resurset natyrore si psh. në Banjë nga ujërat termal, duhet të kufizohet shfrytëzimi i resurseve, bazuar në hulumtimet mbi ndikimin në mjedis.

Kufizimi i zhvillimeve në zonat e mbrojtura mund të ketë ndikim negativ te pronarët e tokave, megjithëse përveç kufizimeve ekzistojnë edhe mundësi të cilat duhet të artikulohen dhe shfrytëzohen, psh. për zhvillimin e turizmit në këto zona të cilat kanë potencial për zhvillimin e veprimtarive bazuar në resurset natyrore.

Përveç ndikimeve ekonomike dhe sociale, ekzistojnë edhe ndikimet e mundshme në mjedis, të cilat duhet të merren parasysh gjatë implementimit të planit Zhvillimor Komunal – planeve të veprimit për zbatim, planeve rregulluese dhe planeve detaje për lokacione të caktuara.

## **NDIKIMI NË TOKË – ZËNIA E TOKËS BUJQËSORE**

Njëri nga priorititetet e planit është mbrojtja e tokës kualitative bujqësore dhe ndalimi i ndërtimit në tokat e kategorisë I-IV. Të gjitha veprimet në lidhje me mbrojtjen e tokës dhe evitimin e ndikimeve negative në tokë, duhet të mbështeten mbi parimin për mbrojtjen e tokës kualitative bujqësore. Edhe pse strategjia parasheh ndalimin e ndërtimit në tokën kualitative bujqësore, përvèç në rastet e pëershruara me Ligjin mbi Planifikimin Hapësinor, zgjerimi i paraparë në vendbanime në principet e dendësimit të ndërtimit megjithatë do të zhvillohet edhe në tokën kualitative.

### **NDIKIMI NË AJËR**

Ndotja e ajrit kryesisht shkaktohet nga dy faktorë:

- Trafiku
- Gurëthyesit

TRAFIKU – Rrjeti i propozuar i trafikut në territorin e Komunës me strategjinë e propozuar, ka paraparë shkurtimin e distancave në mes të vendbanimeve dhe përmirësimin e kualitetit të rrugëve, gjë që ndikon edhe në zvogëlimin e ndotjes. Ndikim të madh këtu kanë edhe brezat e gjelbërimit përgjatë rrugëve.

GURËTHYESIT – duhet të analizohen vendet e caktuara per nxjerrjen e gurit.

### **NDIKIMI NË VEGJETACION**

Ndikimi në vegjetacion duhet të kuptohet si një ndikim kompleks i shumë faktorëve. Po ashtu ai duhet të shikohet ndaras në format gjeografike të mbulesës bimore:

- Fushat
- Pyjet
- Peizazhi

Ndikime në të tri këto hapësira shkaktohen nga ndërtimi i objekteve dhe infrastrukturës si dhe nga veprimet ilegale, sidomos prerja e pyjeve, ndotja me mbeturina dhe nga gurëthyesit. Zhvillimi i turizmit si veprimitari ekonomike do të mund të sjellë ndikime të padëshirueshme në vegjetacion. Ndikimet nga zhvillimet e turizmit mund të manifestohen në pyje, në kullosa si dhe vet peizazhin, por nëse ato konsiderohen si resurse të zhvillimit të turizmit, përqëndrimi në mbrojtjen e tyre do të jetë i domosdoshëm.

Strategjitet e dispozitat e zbatimit përcaktojnë kornizën e rregullimit të hapësirës, që konsiderohet resurs për zhvillimin e veprimitarive ekonomike të lidhura me to. Mbrojtja e mjedisit dhe resurseve do të konsiderohet si parim themelor për të lejuar zhvillimin. Prandaj, ndikimet negative të mundshme nga implementimi i planit zhvillimor, mund të konsiderohen si ndikime të cilat mund të kontrollohen dhe minimizohen.

## 3.0 STRATEGJITË



### **3.1 STRATEGJITË DHE VEPRIMET E IMPLEMENTIMIT**

#### **3.1 STRATEGJITË DHE VEPRIMET E IMPLEMENTIMIT**

##### **3.1.1 STRATEGJITË DHE VEPRIMET E ZHVILLIMIT EKONOMIK**

###### **3.1.1.1 AGRIKULTURA**

Strategjia 1: FUQIZIMI I DREJTORISË SË BUJQËSISË DHE I SHOQATËS SË BUJQVE

- Informimi i bujqve përmes shoqatës së tyre për zhvillimin bujqësor si dhe produktet dhe teknologjitet e reja, me qëllim të rritjes së kapacitetit të njohurive për produkte bujqësore më cilësore.
- Nxitja e ekskursioneve dhe vizitave në terren në regionet ku mund të mësohen përvoja të dobishme, qoftë në Kosovë apo në shtete fqinje, me qëllim që buqit të njoftohen me të arriturat më të fundit në zhvillimin e prodhimeve dhe teknologjive te reja.

*Vlerësim: Kapacitetet e njohurive të bujqve për produktet dhe teknologjitet e reja bujqësore, nuk janë të mjaftueshme për arritjen e prodhimeve cilësore të cilat mund të jenë konkurruese në tregun kosovar apo rajonal. Andaj, fuqizimi i drejtorisë së bujqësisë dhe i shoqatës së bujqve duhet të konsiderohet si një nga qëllimet kryesore që duhet të arrihet në pesë vitet e ardhshme.*

Strategjia 2: PËRKRAHJA E SINERGJIVE ME FORMA TJERA TE AKTIVITETEVE AFARISTE

- Inicimi i pilot projekteve për agro-turizëm; krijimi i strukturave organizative informuese. Gjatë zhvillimit të prodhimit bujqësor përpunim ushqimor, është e nevojshme që aktivitetet zhvillimore turistike të përshtaten me prodhimin bujqësor që është i veçantë për regjionin e Klinës –mjalti, dhredhëza, molla, fidane etj..
- Vendosja e prodhimtarisë ushqimore në parkun e ri të biznesit. Parku i ri i biznesit duhet të reflektojë vizionin e Klinës për bujqësinë si sektor kryesor zhvillimor, duke krijuar mundësi përpunimin e ushqimit dhe tregtimin e produkteve lokale përmes panaireve dhe ngjarjeve në nivel rajonal.
- Tërheqja e investimeve të jashtme drejtpërdrejt në industrinë e prodhimit të dredhzës mollës, mjaltit, drithërave, prodhimit të mishit, qumështit dhe produkteve të tij.
- Krijimi i një platforme të internetit për promovimin e prodhimeve rajonale. Për përkrahjen e prodhimtarisë bujqësore si dhe bizneseve tjera është e nevojshme që të krijohet një “broadband” (brez i gjerë), infrastrukturë tërësisht e re dhe sigurim i internetit për të gjitha bizneset sidomos në parkun e ri të biznesit.

- Identifikimi i pjesëmarrësve të mundshëm për procesimin dhe përpunimin e prodhimit bujqësor. Krijimi i një sistemi të bashkëpunimit për procesimin dhe përpunimin e ushqimit në mënyrë që të ndahet investimi për teknologjinë e nevojshme si dhe tregtimin e prodhimeve. Pjesëmarrësit e mundshëm në këtë bashkëpunim do ti shfrytëzojnë bashkërisht pajisjet dhe teknologjinë e përbashkët si dhe administratën dhe marketingun.

*Vlerësim: Krijimi i sinergjive dhe shhangjia e konflikteve të mundshme është një nga parimet kryesore zhvillimore. Klinë i ka të gjitha parakushtet për krijimin e sinergjisë në mes shtyllave kryesore ekonomike të theksuara në vizion. Bujqësia dhe blegtoria përkrahin përpunimin e ushqimit, zhvillimin e turizmit dhe shërbimet e biznesit. Këto aktivitete komplementare ekonomike krijojnë një bazë të fortë për investime të jashtme. Parku i biznesit paraqet një mundësi për integrimin e të gjithë akterëve për zhvillimin e Klinëut në të ardhmen.*

#### Strategjia 3: NGRITJA E NJOHURIVE PËR TEKNOLOGJITË DHE MARKETINGUN E PRODHIMTARISË

- Krijimi i shkollës së mesme të bujqësisë - Programi shkollor do të duhej të përqendrohej në prodhimtarinë e drithërave, pemëve dhe perimeve, fidaneve dhe pylltarisë. Kjo shkollë do të duhej të jetë e aftë të tërheqë nxënës dhe mësimdhënës - profesionistë, jo vetëm nga Klinë por edhe nga Kosova e më gjerë.
- Krijimi i një marke për prodhimet bujqësore në bashkëpunim me shoqatën e fermerëve dhe specialistët e marketingut. Kriteret për cilësinë e markave duhet të përcaktohen me qëllim të ekzistimit të prodhimeve me cilësi të vërtetuar.
- Krijimi i një qendre informative bujqësore, të vendosur në shkollën e mesme përkatëse e cila ofron arsimim të vazhdueshëm. Hapësirat eksperimentuese (fermë) do të përfshihen në përbajtjet shkollore. Me qëllim të funksionimit të suksesshëm, kjo hapësirë do të udhëhiqet nga bordi i bujqësisë në kuadër të komunës.
- Krijimi i një prodhimtarie të organizuar të dredhzës, mollës dhe produkteve të saj; Krijimi i një marke të dredhzës dhe mollës me qëllim të prezantimit të prejardhjes gjografike.

*Vlerësim: Arsimimi dhe mësimi i vazhdueshëm në bujqësi, blegtori, prodhimtari të pemëve dhe perimeve, do të kontribuojnë në krijimin e prodhimeve cilësore dhe ngritjen e mundësive në marketing. Andaj, qendra bujqësore mund të jetë vend për integrimin e të gjitha aktiviteteve të cilat mund ta shtyjnë përpëra zhvillimin bujqësor në Komunën e Klinës.*

#### Strategjia 4: NGRITJA E EFIKASITETIT TË FERMAVE

- Fermat e vogla të qumështit duhet të rriten, ndërsa kooperativa e prodhimtarisë të qumështit duhet të zgjerohet edhe me ferma të reja, me qëllim të ngritjes së efikasitetit të prodhimit.

- Krijimi i parkut të makinave të shoqatës së fermerëve me qëllim të sigurimit të makinave dhe teknologjisë së nevojshme bujqësore, ashtu që fermerëve t'u mundësohet një sistem i huazimit dhe shmangies së shpenzimeve te panevojshme për makinat të cilat mund të shfrytëzohen bashkërisht.

*Vlerësim: Fermat e vogla mund të jenë të suksesshme nëse punojnë së bashku, duke i shfrytëzuar shërbimet dhe pajisjet e përbashkëta si dhe duke i shmangur shpenzimet e panevojshme për sigurimin e teknologjisë së nevojshme. Andaj krijimi i kooperativave është masë e nevojshme dhe mund të kontribuojë në krijimin e mundësive në treg.*

#### Strategja 5: MBROJTJA E TOKËS BUJQËSORE

Me qëllim të mbrojtjes së tokës cilësore bujqësore, komuna duhet të marrë masat vijuese:

- Identifikimi dhe klasifikimi i zonave me tokë cilësore për prodhime të veçanta bujqësore si dhe me peizazhe të bukura, të rëndësishme për komunën dhe zona të veçanta rurale.
- Hartimi i planeve zhvillimore dhe rregulluese për subqendra dhe qendrat lokale, të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë. Me qëllim të zhvillimit dhe rritjes, prioritet duhet ti jepet djerrinave dhe tokave me cilësi të ulët bujqësore.
- Rehabilitimi i tokës së degraduar bujqësore nga vërshimet, erozioni dhe rrëshqitjet si dhe zonat e deponieve të dikurshme legale apo ilegale. Konsolidimi në zonat me tokë të cilësisë së lartë bujqësore është i nevojshëm, ndërsa kadastri i tokës bujqësore do të jetë instrument për mbrojtjen e tokës bujqësore.
- Rehabilitimi i sistemit të ujitjes me qëllim të sigurimit të kushteve për kultivimin e tokës.
- Shfrytëzimin efikas i përbajtjeve industriale që tashmë janë të pajisura me infrastrukturë për zhvillime të reja si dhe rehabilitimin e industrive ekzistuese, me qëllim të parandalimit të humbjes së tokës bujqësore.

*Vlerësim: Toka cilësore bujqësore është një nga resurset më të rëndësishme, jo vetëm në Klinë por gjithashtu edhe në Kosovë. Identifikimi dhe klasifikimi është hapi i parë për ruajtjen e tokës. Zhvillimi i planifikuar mund të kontribuojë për ruajtjen e tokës bujqësore dhe përkrahë zhvillimet të cilat mund të zënë vend në toka të cilësisë më të ulët apo djerrina.*

#### 3.1.1.2 TURIZMI

Strategja 1: KRIJIMI I BORDIT VENDOR TË TURIZMIT ME QËLLIM TË KOORDINIMIT TË ZHVILLIMIT TË TURIZMIT

- Krijimi i një sistemi të përgjithshëm informativ turistik (hartat, udhëzuesit, broshurat, ueb faqja...)
- Ngritura e kapaciteteve të njohurive mbi turizmin përmes kurseve të specializuara, vizitave studimore dhe programeve të specializuara në kuadër të shkollimit të mesëm me mësimdhënës vendor apo ndërkombëtar.
- Organizimi i vizitave pa pagesë për operatorët turistik ndërkombëtar, në mënyrë që të bëhet një vlerësim në vend për mundësitet turistike dhe veprimet e nevojshme për zhvillimin e turizmit, duke u bazuar në interesat e investitorëve.
- Hartimi i studimeve të fizibilitetit për komunën, në mënyrë që detalisht të identifikohen potencialet për aktivitete turistike

*Vlerësim: Zhvillimi i turizmit në Klinë ka një potencial të madh. Për zhvillimin e tij në mënyrë të qëndrueshme, është i nevojshëm një organizim i mirëfilltë turistik. Andaj, për krijimin e një sistemi informativ turistik, krijimin e kapaciteteve dhe krijimin e një plani të përgjithshëm zhvillimor turistik, është i nevojshëm krijimi i një bordi vendor turistik.*

#### Strategji 2: PROMOVIMI I NJË QENDRE TË VIZITORËVE NË PARKUN NATYROR ‘MIRUSHA’

- Komuna e Klinë duhet të jetë e angazhuar intensivisht në procesin e planifikimit në parkun e natyrës Mirusha. Ndërtimi i qendrës së vizitorëve do ta promovonte atraksionin turistik në park,. Kjo qendër, po ashtu do të duhej të zhvillonte programe të vizitave dhe aktiviteteve rekreative në pikë të ndryshme atraktive (gryka e Klinës etj )
- Harmozinimi i PZHK –Klina, Malishevë, Rahovec me Planin Hapësinor të MN “Ujëvarat e Mirushës”
- Hartimi i planit rregullues për zoënën e tretë
- Hartimi i planeve rregulluese për vendbanimet rrëth parkut si: Dush, Volljakë.

*Vlerësim: Shpallja “monument natyre” i Mirushës ka rëndësi ndërkombëtare për Kosovën, andaj Klinë duhet ta shfrytëzojë mundësinë për zhvillimin e turizmit të komunës. Qendra e vizitorëve në kuadër të parkut mund të kontribuojë, jo vetëm për tërheqjen e vizitorëve për shkak të atraksioneve të ndryshme, por po ashtu për ruajtjen e zonave të mbrojtura në park.*

#### Strategji 3: KRIJIMI I INFRASTRUKTURËS TURISTIKE

- Ndërtimi i infrastrukturës bazike turistike - qasja, informimi etj. Kjo nënkupton krijimin e rrjetit të shtigjeve për ecje, në zonat në kuadër të Parkut natyror Mirusha si dhe në zonat me vlera të shquara natyrore apo të trashëgimisë kulturore.

- Ndërtimi i një sistemi të përshtatshëm informativ—ueb faqe, harta, broshura dhe mjete tjera informuese, për ta përkrahë zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit, varësisht nga resurset.

Bordi i turizmit do të krijojë qendrat informative turistike, në bazë të planit të përgjithshëm zhvillimor turistik. Në fillim, qendra informative turistike duhet të krijohet në qytetin e Klinë dhe ajo pasuese do të mund të krijohej në kuadër të qendrës së vizitorëve në Parkun natyror ‘Mirusha’

*Vlerësim: Një zhvillim i organizuar i turizmit është i përkrahur me rrjet të duhur infrastrukturor. Lidhja e atraksioneve turistike me forma të ndryshme të vijave të lëvizjes / transporti dhe qasja e lehtë, krijojnë më tepër mundësi për vizita. Të gjitha lidhjet duhet të jenë të koordinuara përmes qendrës informative turistike.*

#### Strategjia 3: MBROJTJA E NATYRËS DHE MJEDISIT

- Promovimi i natyrës dhe mjedisit si resurs për turizëm ekologjik. Sigurimi i të gjitha të dhënavë të nevojshme për lokacionet, vijat e transportit publik si dhe shtigjet për ecje apo çiklizëm.
- Sigurimi i pajisjeve dhe shërbimeve të nevojshme për mbajtjen e zonave të pastra dhe të sigurta. Shfrytëzimi i zonave të mbrojtura natyrore dhe peizazheve të vlefshme në mënyrë të qëndrueshme, në mënyrë që të zvogëlohen ndikimet nga turizmi dhe të mbrohen vlerat e këtyre zonave.

*Vlerësim: Shtimi i interesit për turizmin natyror është një mundësi për natyrën e Klinës. Andaj, komuna duhet të sigurojë të gjitha informatat e nevojshme për atraksionet natyrore dhe mënyrat e transportit që furnizojnë këto zona. Mbajtja e natyrës së pastër dhe të sigurt, mund të kontribuojë në rritjen e interesit të turistëve.*

#### Strategjia 4: PROMOVIMI I SPELEOTURIZMIT

- Krijimi i shoqatës së speleologëve të Klinës, e cila së bashku me bordin e turizmit do të jenë përgjegjëse për hulumtimin e shpellave dhe përgatitjen e të gjitha informatave të nevojshme për zhvillimin e speleoturizmit.
- Organizimi i hulumtimeve speleologjike, përkatesisht hulumtimeve kimike, biologjike, gjeologjike, meteorologjike dhe hartografike.
- Përgatitja e planit menaxhues, duke i përfshirë të gjitha llojet e informatave mbi lokacionet e identikuara për vizita turistike dhe vizita studimore.

*Vlerësim: Aktivitetet e speleoturizmit duhet të jenë të organizuara mirë, në mënyrë që të ofrojnë turizëm tèrheqës dhe të sigurt. Komuna duhet të promovojë planin menaxhues për speleoturizëm.*

#### Strategja 5: PROMOVIMI I GJUETISË SI AKTIVITET PLOTËSUES I OFERTËS TURISTIKE

- Shoqata e gjuetarëve do të jetë përgjegjëse për organizimin dhe kontrollimin e gjuetisë. Shoqata, së bashku me bordin vendor të turizmit, do të jenë përgjegjës për turizmin e gjuetisë.
- Përgatitja e planit menaxhues për gjuetinë, dukë përfshirë të gjitha zonat e përcaktuara për gjueti. Ky plan duhet të përcaktojë të gjithë akterët përgjegjës për menaxhim dhe masat e nevojshme të sigurisë.
- Komuna, në bashkëpunim të ngushtë me shoqatën e gjuetarëve, duhet të aplikojë të gjitha masat për mbrojtjen e biodiversitetit të zonave të përcaktuara për gjueti.

*Vlerësim: Vetëm aktivitetet e organizuara rekreative të gjuetisë mund të ofrojnë turizëm tèrheqës dhe të sigurt të gjuetisë. Andaj, komuna duhet të promovojë planin menaxhues për zonat e përcaktuara për gjueti.*

#### 3.1.1.4 NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

##### Strategja 1: PËRKRAHJA E ZHVILLIMIT TË NVM NË BUJQËSI DHE TURIZËM PËR MES AGJENCISË PËR ZHVILLIM RAJONAL

- Krijimi i qendrës trajnuese profesionale për profesionistët e rinj, për ngritjen e aftësive në bujqësi, turizëm, ndërmarrësi. Po ashtu, në kuadër të qendrës së aftësimit, mund të ofrohen seminare dhe kurse për zhvillim ekonomik dhe njohuri mbi marketingun.
- Krijimi i agjencisë lokale për ofrimin e hapësirave për zhvillim ekonomik, lokacionet e biznesit apo menaxhim.
- Përkrahja e ndërmarrësve të rinj përmes implementimit të “qendrës nismëtare” (inkubatorit të biznesit), ku ndërmarrjet mund të shfrytëzojnë infrastrukturën e përbashkët dhe të përfitojnë në mënyrë të ndërsjellë. Kjo qendër duhet të ofrojë:
  - Huazimin e hapësirave për zyre dhe seminare me çmime të ulëta
  - Qendrën e përbashkët të shitjes
  - Këshillime mbi kontabilitetin
  - Këshilla ligjore për taksat

*Vlerësim: Biznesi i organizuar është dëshmuar si më i suksesshmi. Agjencia lokale për Zhvillim mund të përkrahë rritjen e biznesit, duke ofruar tokë me çmim të volitshëm për NVM, ngritjen e kapaciteteve përmes trajnimeve dhe specializimeve dhe t'ua mundësojë personave të rinj të nisin biznese të reja.*

### **3.1.2 STRATEGJITË DHE VEPRIMET E SISTEMIT TË TRAFIKUT DHE TRANSPORTIT**

Strategjia 1: ZHVILLIMI I NJË SISTEMI TRANSPORTUES TË SIGURT, TË BESUESHËM, TË ARRITSHËM DHE EFIKAS, I CILI I RUAN RESURSET HISTORIKE, PEIZAZHORE, BUJQËSORE DHE NATYRORE SI DHE I PËRMBUSHË NEVOJAT E BANORËVE PËR TRANSPORT

- Përmirësimin e rrjetit rrugor komunal me fondet ekzistuese dhe të zotuara nga BQK (Komuna dhe MTPT). Fondet do të përqendrohen në zonat me qasje të dobët rrugore si dhe në zonat e parapara për zhvillim, duke i lidhur këto zona me lidhjet kryesore – rrugët nacionale, rrugët rajonale si dhe ato kryesore lokale.
- Identifikimi i rrugëve prioritare të cilat duhet të ndërtohen, me qëllim që të përmirësohet qasje dhe lidhjet në mes subqendrave dhe qendrave lokale në Komunën e Klinës apo me komunat fqinje.
- Hulumtimi i mundësive për ruajtjen e vlerave historike dhe peizazhore në komunë, përmes kufizimit të zhvillimit përgjatë rrugëve kryesore dhe rajonale.

*Vlerësim: Rrjeti rrugor ekzistues është i shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme dhe është funksional. Për ta përparuar sistemin transportues, duhet të ngritet cilësia e rrugëve lokale dhe e fshatrave. Zhvillimi i një sistemi funksional të transportit të bazuar në priorititetet e përcaktuara, ka rol kyç në përkrahjen e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror në Klinë.*

Strategjia 2: BASHKËPUNIMI ME MTPT PËR PËRMIRËSIMIN E RRJETIT TË TRANSPORTIT

- Ndërtimi i rrugëve nëpër tokat pyjore me qëllim të zhvillimit të blegtorisë, pylltarisë dhe turizmit.
- sigurimi i qasjes për na monumintn e natyrës "Mirusha"

*Vlerësim: Lidhjet me zonën kodrinore konsiderohen si çështje e rëndësishme për zhvillimin ekonomik, mbrojtjen e resurseve natyrore si dhe pengimin e shpërnguljes së popullatës nga zonat malore. Ato po ashtu do të ofronin mundësi të zhvillimit në zonat e largëta si turizmi, pylltaria si dhe fermat -produktet e qumështit dhe mjaltit. Andaj, komuna duhet të bashkëpunojë me MTPT për përmirësimin e rrjetit rrugor në këto zona.*

Strategjia 3: PËRMIRËSIMI I QASJES SË TË GJITHA VENDBANIMEVE NË SHËRBIMET E TRANSPORTIT PUBLIK

- Vlerësimi i qasjes së çdo fshati në mjetet e transportit publik si dhe lidhjeve në mes Klinës, subqendrave dhe vendbanimeve tjera.
- Përmirësimi i rrugëve, të shtruara apo të pashtuara, në mënyrë që të mundësohen vijat e transportit publik për në secilin fshat.
- Inkurajimi i përpjekjeve për shërbime të transportit publik dhe privat

*Vlerësim: Mungesa e transportit efikas publik në të gjitha vendbanimet, ndikon në cilësinë e jetës dhe mund të shkaktojë migrimin dhe shpopullimin e zonave më të largëta. Përmirësimi i qasjes në sistemin e transportit, do të përmirësojë cilësinë e jetës në vendbanime si dhe do të ulë migrimin në drejtim të qendrës kryesore apo subqendrave.*

#### Strategja 4: ZHVILLIMI DHE INKURAJIMI I PËRDORIMIT TË MËNYRAVE ALTERNATIVE TË TRANSPORTIT

- Krijimi i shtigjeve për çiklistë dhe këmbësorë dhe lidhjeve nëpër tërë komunën.
- Zhvillimi dhe promovimi i shfrytëzimit të parkut dhe shtigjeve, në mënyrë që të përkrahë turizmi dhe rekreimi në natyrë.

*Vlerësim: Rritja e transportit automobilistik është duke shkaktuar probleme në trafik si dhe ndotje të mjedisit në vendbanime dhe natyrë (toka bujqësore, peizazhi, zonat e përcaktuara për turizëm etj.). Andaj, mënyrat alternative të transportit mund të kontribuojnë për përmirësimin e lëvizjes dhe uljen e ndotjes. Ato po ashtu mund të ofrojnë mundësi për referimin në natyrë, si pjesë e ofertës turistike të komunës.*

#### 3.1.3 POPULLSIA, BANIMI DHE VENDBANIMET

##### Strategja 1: KUFIZIMI I RRITJES SË VENDBANIMEVE NË ZONAT PËRKATËSE

- Ndërtimi i infrastrukturës nuk do të ofrohet jashtë zonave të definuara për ndërtim, përveç për funksionet e përcaktuara me nenin 17.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinor
- Shfrytëzimi i densifikimit brenda kufijve aktual të territorit të ndërtuar të vendbanimeve dhe shmangia e zgjerimeve të pakontrolluara në zhvillimet e reja
- Komuna është e lejuar të kontrollojë politikën e zgjerimit me të gjitha mjetet që janë në kompetencë të komunës

*Vlerësim: Ruajtja e tokës bujqësore dhe sigurimi i infrastrukturës, janë masa të nevojshme të cilat duhet të ndërmerren. Kufizimi i zhvillimit përmes densifikimit ndikon në uljen e kostos së infrastrukturës.*

##### Strategja 2: SIGURIMI QË KLINËU DHE VENDBANIMET JANË ATRAKTIVE PËR TË JETUAR DHE PUNUAR

- Sigurimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në fshatra, me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës
- Promovimi i jetës dhe punës në Klinë dhe fshatra, duke ofruar përbajtje publike për ngritjen e nivelit të jetesës.
- Hulumtimi i mundësive për ripërdorimin dhe mirëmbajtjen e strukturave ekzistuese si dhe mënjanimin e degradimit fizik të strukturave të vendbanimeve ekzistuese të ndërtuara pa plan.

*Vlerësim: Transformimi i fshatrave në vende tërheqëse për jetë, mund ta ulë migrimin dhe shpopullimin e zonave të largëta. Andaj, infrastruktura dhe shërbimet si dhe përbajtjet publike janë të nevojshme për përmirësimin e cilësisë së jetesës.*

#### Strategji 3: SIGURIMI QË ZHVILLIMI I ARDHSHËM I KOMUNËS SË KLINËS DO TË JETË I ORIENTUAR PËRMES PLANEVE ZHVILLIMORE

- Zhvillimi i planeve rregulluese për Klinë apo subqendra, si dhe për zonat e tjera të nevojshme zhvillimore. Qëllimi i këtyre planeve është orientimi i zhvillimit të ardhshëm përbrenda dhe përreth zonave përkatëse duke iu përshtatur karakterit të veçantë të secilës subqendrë.
- Krijimi i një trupi këshillëdhënës, i cili do ti këshillojë anëtarët e Asamblesë për çështjet e ujësjellësit dhe kanalizimit, në zonat ku këto shërbime mungojnë.

*Vlerësim: Zhvillimi i planifikuar sjell deri te përmirësimi i cilësisë së përgjithshme të jetesës. Andaj, komuna duhet të vazhdojë me planet rregulluese në zonën urbane dhe rurale – subqendrat si dhe zonat e parapara për zhvillim, jashtë zonës urbane të Klinës.*

#### VEDNBANIMET JOFORMALE

#### Strategji 1: GARANTIMI QË VENDBANIMET JOFORMALE JANË TË PËRFSHIRA NË PLANIN ZHVILLIMOR KOMUNAL DHE URBAN TË KLINËS

Veprimet vijuese janë të nxjerra nga udhëzuesi për rregullimin e vendbanimeve joformale, i hartuar nga DPH - MMPH.

- Përgatitja e profilit të gjendjes ekzistuese të vendbanimeve joformale në territorin e saj. Kjo do të duhej të shërbente për përcaktimin e prioriteteve për rregullimin e vendbanimeve joformale, ndërsa do t'u shërbente donatorëve të mundshëm për ofrimin e informatave të nevojshme për përkrahje financiare, njerëzore dhe teknike në kuadër të këtij rregullimi.
- Çështjet pronësore – ekziston nevoja për angazhim intensiv të komunës për zgjidhjen e problemeve në lidhje me të drejtat pronësore. Çështjet e pazgjidhura pronësore duhet të

zgjidhen në mënyrë që të sigurohet baza ligjore për inicimin e procesit të planifikimit. Kadastra dhe departamentet pronësore duhet të ofrojnë të dhëna dhe harta të përditësuara, në mënyrë që të shmangen problemet me të dhëna gjatë planifikimit.

- Procesi i planifikimit – rregullimi i vendbanimeve joformale duhet të realizohet përmes një procesi gjithëpërfshirës, në mënyrë që pjesëmarrësve t'u mundësohet shprehja e kërkesave dhe një vendimmarrje transparente.
- Bashkëpunimi me Agjencinë Kosovare të privatizimit, me qëllim të shmangies së problemeve në raport me tokën publike nën menaxhimin e AKP, e nevojshme për vodosjen e infrastrukturës publike, sigurimin e hapësirave për shkolla, çerdhe dhe ndërtesa tjera komunale.

*Vlerësim: Në kudër të planit të veprimit për partneritet evropian bën pjesë edhe rregullimi i vendbanimeve joformale, që është pjesë e standardeve për Kosovën. Andaj, Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban duhet që në procesin e planifikimit të përfshijë vendbanimet joformale dhe të merret me formalizimin, në përputhshmëri me udhëzimet e publikuara nga MMPH.*

### **3.1.4 STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR INFRASTRUKTURËN SOCIALE**

#### **3.1.4.1 ARSIMI**

**Strategji 1: OFRIMI I PËRMBAJTJEVE ARSIMORE NË VENDBANIME, NË PËRPUTHSHMËRI ME FUNKSIONIN E TYRE SI DHE HIERARKINË**

- Ngritja e objekteve për çerdhe në përputhshmëri me standartet ndërkombëtare
- Ngritja e objekteve për edukimin parashkollor
- Themelimi i shkollës për arsim të mesëm të lartë – arsimim profesional në Zajm
- Përmirësimi i cilësisë së përbajtjeve në të gjitha llojet e shkollave

*Vlerësim: Reformat arsimore në Kosovë kërkojnë programe të specializuara arsimore dhe përmirësimin e përbajtjeve të ndërtësave shkollore në të gjitha nivelet e arsimit. Andaj, janë të nevojshme hapësirat plotësuese shkollore, me programe të reja arsimore për zhvillimin e Klinës në të ardhmen, duke u bazuar në potencialet lokale.*

#### **3.1.4.2 SHËNDETËSIA**

**Strategji 1: OFRIMI I PËRMBAJTJEVE SHËNDETËSORE NË VENDBANIME, NË PËRPUTHSHMËRI ME FUNKSIONIN E TYRE SI DHE HIERARKINË**

- Ndërtimi i ambulancës në subqendrën e Gllarevës
- Shndërrimi i ambulancës në Grabanicë në QMF – qendër të mjekësisë familjare

*Vlerësim: Shërbimeve shëndetësore iu duhen përmirësime në kapacitete njerëzore, shërbime si dhe në përmbajtjet mjekësore. Andaj, përmirësimi i atyre ekzistuese, do të sigurojë përmirësim të shërbimeve shëndetësore.*

### **3.1.4.3 QENDRAT LOKALE TË KOMUNITETIT**

Strategja 1: SIGURIMI I QENDRAVE TË KOMUNITETIT NË KUADËR TË QENDRAVE LOKALE

- Shndërrimi i zyrave ekzistuese të vendit në qednra të komunitetet si dhe themelimi i qendrave të reja komunitetit në qednrat lokale të cilat nuk posedojnë.

*Vlerësim: Roli i qendrave lokale të komunitetit është afrimi i shërbimeve ndaj banorëve dhe ofrimi i mundësive për zhvillim social në zonat urbane dhe rurale. Andaj, është e nevojshme që të ofrohen përmbajtje ku njerëzit mund ti përmushin nevojat për shërbime komunitare.*

### **3.1.4.4 KULTURA**

Strategja 1: OFRIMI I PËRMBAJTJEVE KULTURORE NË VENDBANIME, NË PËRPUTHSHMËRI ME FUNKSIONIN E TYRE SI DHE HIERARKINË

- Ofrimi i përmbajtjeve për veprimtari kulturore në të gjitha qendrat. Këto përmbajtje mund të vodosën në ndërtesat shkolllore ose në qendrat lokale të komunitetit.

*Vlerësim: Veprimtaritë kulturore sjellin cilësi në jetën e banorëve në zonat urbane dhe rurale. Alokimi i hapësirave të nevojshme për kulturë nuk është e kufizuar vetëm në kuadër të ndonjë ndërtese përkatëse për kulturë, por ato mund të vendosen në kuadër të ndërtesës shkolllore apo qendrës së komunitetit .*

### **3.1.4.5 SPORTI DHE REKREIMI**

Strategja 1: OFRIMI I PËRMBAJTJEVE SPORTIVE DHE REKREATIVE NË VENDBANIME, NË PËRPUTHSHMËRI ME FUNKSIONIN E TYRE SI DHE HIERARKINË

- Ofrimi i përmbajtjeve për veprimtari sportive dhe rekreative në të gjitha vendbanimet. Hapësirat sportive shkolllore mund të shërbejnë për shfrytëzim publik, nëse nuk ekzistojnë mundësi për ndërtimë të veçanta.

*Vlerësim: Veprimtaritë sportive dhe rekreative janë të nevojshme për banorët në zona urbane dhe rurale. Fushat e lojës dhe hapësirat sportive mund të vendosen në ndërtesa shkolllore apo në ambient të jashtëm.*

## **3.1.5 STRATEGJITË DHE VEPRIMET PËR INFRASTRUKTURËN TEKNIKE**

### **3.1.5.1 FURNIZIMI ME UJË**

Strategjia 1- Përfundimi i sistemit të furnizimit me ujë në tërë komunën e Klinës .

- Ndërtimi i një rezervuari në Qabiq nga do të furnizoheshin më ujë këto vendbanime: Siqevë, uëmirë, Dobërdoll, gjurgjevik i Madh, Zabërgjë, Qabiq, Caravik, Gllarevë, Rigjevë, urim dhe Përqevë.
- Shtimi i edhe i një rezervuari të ri në qytet i cili do të shkoj deri të rezervuari i ri i planifikuar që do të jetë mbi Leskoc, përmes së cilit do të furnizoheshin këto vendbanime: Leskoc, Drashaniq, Renoc, Zllakuqan, Radulloc, Krushevë e madhe, Gjurgjevik i Vogël, Rudicë, Stupë, Budisalc, Nagllavë, Krushevë e madhe, Jagodë, Videjë, Deiq, Zajm, Dollovë, Petriq i Poshtëm , Petriq i Epërm, Drenoc, Dugajevë dhe Bokshiq.

*Vlerësim: Sistemi i integruar i ujësjellësit përmirëson furnizimin me ujë të pastër dhe të kontrolluar të vendbanimeve me çka përmirësohen shërbimet e kompanisë rajonale të ujësjellësit. Andaj komuna duhet të synojë integrimin e të gjitha sistemeve lokale të ujësjellësit.*

### 3.1.5.2 SISTEMI I KANALIZIMIT

Strategjia 1 – Ndërtim i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza në tërë komunën e Klinës

- Ndërtimi i kolektorit kryesor në anën e djathtë të lumit Drini i Bardhë ku do të shkarkoheshin ujërat e zeza të këtyre vendbanimeve: Stupë, Budisalc, Nagllavë, Krushëvë e Madhe, Jagodë, Videjë, Deiq, Zajm, Dollovë, Petriq i Poshtëm, petriq i Epërm, Drenoc, Dugajevë, Bokshiq, Grabanicë, Qeskovë dhe Këpuz.
- Ndërtimi i kolektorit kryesor në anën e majtë të lumit Drini i Bardhë ku do të shkarkoheshin vendbanimet: Bërkovë, Leskoc, Drashaniq, Zllakuqan, Grapc, Bingjë, Shtupel, Radulloc, Krushëv e Vogël, Gjurgjevik i Vogël, Klinë, Jashanicë e Epërme, Kërnicë, jashanicë, Resnik, jelloçë, Siqevë, Dush, Pogragjë, Gjurgjevik i Madh, Dërsnik, Dollc, Gremnik, Qupevë, Qabiq, Zabërgjë, Dobërdoll, Ujëmirë, Gllarevë, përqevë, Sferkë, Dushi i vogël dhe Volljakë
  - Ndërtimi i impiantit në Caravik
  - Ndërtimi i kolektorit të përbashkët për vendbanimin Rixhevë dhe Burim.

Strategjia 2- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave atmosferik

- Sistemi i shkarkimit të ujërave atmosferik duhet të jetë i ndarë nga kanalizimi i ujërave të zeza
- Shkarkimi i ujërave sanitare ose industrial të bëhet në sistemin e ujërave të zeza.
- Rrjeti duhet të zgjerohet deri në fshatra.

*Vlerësim: Kanalizimi i ujërave të zeza mbron resurset ujore të Klinë shumë të vlefshme për zhvillimin e bujqësisë. Kanalizimi atmosferik ndahet nga ai i ujërave të zeza për t'i evitar*

vërshimet.

### **3.1.5.3 FURNIZIMI ME RRYMË DHE RRJETI I TELEKOMUNIKIMIT**

Strategjia 1: BASHKËPUNIMI ME KEK ME QËLLIM QË GRADUALISHT TË KALOHET NGA RRJETI 10 (20) KV NË ATE 20 KV

- Ndërrimi i rrjetit ekzistues OL - 10(20) kV në 20 kV. Rrjetet me voltazh të ulët duhet të ndërtohen me shtylla betoni dhe kabllo vetmbajtëse alumini. Të shfrytëzohen shtyllat për ndriçim publik në rrugët fshatrave.

*Vlerësim: Edhe pse zhvillimi i rrjetit të furnizimit me rrymë është përgjegjësi e KEK-ut, komuna duhet të kuptojë domosdoshmërinë e përmirësimit të rrjetit.*

Strategjia 2: BASHKËPUNIMI ME PTK ME QËLLIM TË SHTRIRJES SË RRJETIT TË TELEKOMUNIKIMIT NË ZONA RURALE

- Shtrirja e rrjetit të telekomunikimit në fshatra përmes kabllove me fibra optike që mundësojnë lidhjen me internet dhe televizion kabllor.

*Vlerësim: Rrjeti i telekomunikimit, gjithashtu përgjegjësi e PTK, duhet të shtrihet në të gjitha fshatrat.*

### **3.1.6 STRATEGJITË DHE VEPRIMET MJEDISORE DHE PEIZAZHORE**

Strategjia 1: MBROJTJA E SHUMËLLOJSHMËRISË PEIZAZHORE

- Sigurimi i mbrojtjes së integruar të monumenteve natyrore dhe kulturore
- Ruajtja e kulturave tradicionale të bujqësisë në mënyrë që të ruhet struktura historike peizazhore
- Parandalimi i ndotjes aktuale të lumenjve, tokës dhe ujërave nëntokësor përmes ndërtimit të rrjetit të kanalizimit. Parandalimi i shpyllëzimit dhe erozionit përmes prezantimit të formave të qëndrueshme të shfrytëzimit të pyjeve.
- Forcimi i bashkëpunimit me MMPH
- Kufizimi i zhvillimit në zonat me tokë bujqësore cilësore si dhe në peizazhet pitoreske
- Përgatitja e planeve rregulluese për mbrojtjen e peizazheve përgjatë lumenjve
- Mbrojtja e shumëllojshmërisë së biotipeve të ndryshme në region

*Vlerësim: Peizazhi dhe zonat me vlera të shquara janë atraksionet më të rëndësishme turistike në Komunën e Klinës. Andaj, është e nevojshme mbrojtja e peizazhit për shkak të veprimtarive për zhvillimin e turizmit dhe atyre rekreative.*

Strategjia 2: ZVOGËLIMI I NDIKIMEVE TË DËMSHME TË VEPRIMEVE NGA NJERIU NË MJEDIS

- Përkrahja për MMMPH përmes identifikimit, dekontaminimit dhe rinatyrimit të deponieve ilegale
- Përkrahja për përmirësimin e sistemeve të largimit të mbeturinave në vendbanimet e vogla  
*Vlerësim: Zhvillimi ekonomik përcillet me ndikime të dëmshme në mjedis nga veprimet e njeriut. Deponimi i mbeturinave duhet të përcillet me masa të trajtimit.*

### Strategjia 3: PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË HAPËSIRAVE TË GJELBRA

- Rritja e numrit të parqeve dhe hapësirave të gjelbra në vendbanimet me popullatë të dendur
- Krijimi i një rrjeti integral të gjelbër në qytet dhe komunë
- Krijimi i hapësirës së gjelbër përgjatë lumenjve dhe mbrojtja nga veprimtaritë ndërtimore

*Vlerësim: Zonat e gjelbra kanë nevojë për kujdes, sidomos në zonat e ndërtuara. Parqet e reja, hapësirat e gjelbra përgjatë rrjedhave ujore si dhe mbrojtja e hapësirave të lira nga zhvillimet, mund të kontribuojnë në përmirësimin e mjedisive natyrore.*

### Strategjia 4: TRAJTIMI I MBETURINAVE

- Bashkëveprimi i Komunës me Agjencionin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Kompaninë publike të menaxhimit të mbeturinave në trajtimin e mbeturinave
- Promovimi i ndarjes së mbeturinave në bazë të llojit, për riciklimin e tyre
- Promovimi i riciklimit si veprimtari profitabile ekonomike
- Myllja e deponieve ilegale, pastrimi dhe konsolidimi i tokës, si veprim për përmirësimin e kushteve mjedisore

*Trajtimi i mbeturinave është esencial për një mjedis të shëndoshë, mbrojtjen e resurseve natyrore – tokën bujqësore, lumenjtë dhe peizazhet me vlerë. Riciklimi i mbeturinave zgjeron edhe shpenzimin e resurseve për trajtimin e tyre dhe krijon mundësitë për zhvillimin e aktiviteteve profitabile ekonomike dhe krijon mundësi për vende të reja të punës.*

#### 3.1.7 ZONAT E RREZIKSHME

##### 3.1.7.1 MASAT MBROJTËSE

###### Strategjia: ZVOGËLIMI I NDIKIMEVE TË DËMSHME PËR RREZIQET NË KUADËR TË KOMUNËS

- Komuna do të krijojë bazën e të dhënavë për rrjedhat lumore dhe erozionet dhe ti vendosë ato në GIS harta, për të treguar zonat ku vërvshimet mund të ndodhin. Këto të dhëna do të

shërbejnë për mbikëqyrje të vazhdueshme të lumenjve si dhe për analiza hapësinore rrëth nivelistë ndikimeve nga vërvshimet.

- Komuna në bashkëpunim me institucionet përkatëse të nivelistë qendror – MMPH, MBPZHR, SHPK, TMK dhe KFOR, duhet të krijojë sistem të paralajmërimi për vërvshime. Duhet të hartohet plani i veprimeve emergjente dhe masave zbutëse për përgjigje të menjëherëshme ndaj rreziqeve nga vërvshimet. Ky plan duhet të përcaktojë veprimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin e krizave në rast të fatkeqësive.

**Masat dhe veprimet** e cekura më poshtë janë të nxjerra nga objektivat e përcaktuara në Planin hapësinor të Kosovës. Çdo masë specifike e cila mund të aplikohet për shkak të rreziqeve që mund të ndodhin, janë temë e konsultimeve dhe koordinimeve me institucionet përkatëse.

## VËRSHIMET

- Komuna, në kuadër të kapaciteteve të veta, duhet të ndërmarrë masat vijuese hidrologjike në mënyrë që të parandalojë apo të zgogëlojë ndikimet nga rreziku i vërvshimeve.
- Komuna do të ndërmarrë masat e nevojshme për kontrollimin e zhvillimit në tokat bujqësore përgjatë lumenjve, sidomos për ndërtimet dhe veprimet tjera që mund ta rrisin rrezikun nga vërvshimet.
- Zhvillimi i infrastrukturës i cili nuk ka ndikime të dëmshme në rrjedhën e lumenjve – si ura, kanale të ujitjes dhe shkarkimit, mund të përjashtohen nga kjo masë.
- Komuna do të ndërmarrë masat përkatëse për mbrojtjen e botës bimore në brigjet e lumenjve. Prerja e domosdoshme do të lejohet në zonat ku ato do të mund të shkaktonin ndikime negative. Komuna do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për përmirësimin e vlerave peizazhere të brigjeve të lumenjve përmes mbjelljeve dhe veprimeve për konstruktive peizazhere për rekreim siç është modelimi i terrenit dhe mbjellja e barit.
- Edhe pse kontrollimi i eksploatimit të zhavorrit nga shtrati i lumenjve është përgjegjësi e Departamentit për Menaxhimin e Ujërave në MMPH dhe DMM, komuna do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për mbikëqyrjen dhe kontrollimin e këtyre aktiviteteve me qëllim të parandalimit të ndotjes së ujit, shkatërrimit të botës shtazore lumore dhe dëmtimeve të shtratit të lumit, gjë që mund të shkaktojnë vërvshime.
- Çdo ndryshim i rrjedhës së lumit do të ndalohet nga komuna dhe veprimet që mund të çojnë deri në rritjen e rreziqeve për vërvshime do të kontrollohen në mënyrë strikte po ashtu.

*Vlerësim: Parandalimi i vërvshimeve do të duhej të jetë qëllim i të gjithë banorëve dhe shfrytëzuesve të tokës bujqësore. Parandalimi i vërvshimeve është i nevojshëm me qëllim të*

*mbrojtjes së tokës dhe prodhimtarisë bujqësore, peizazhit natyror por po ashtu edhe aseteve të krijuara nga njeriu, vendbanimet, infrastruktura rrugore etj.*

## EROZIONI

Me qëllim të parandalimit të erozionit dhe zvogëlimit të ndikimeve, komuna duhet të ndërmarrë hapat e menjëhershëm vijues:

- Parandalimi i prerjes dhe degradimit të pyjeve
- Parandalimi i kullojës së tepërt
- Parandalimi i shfrytëzimit joracional të resurseve natyrore që mund të shkaktojnë erozion.

Duke i përcjellur objektivat nga Plani Hapësinor i Kosovës, komuna do të ndërmarrë masat vijuese mbrojtëse ndaj erozionit:

### Masat inxhinierike

- Krijimi i pendave mbrojtëse për mbrojtje nga rrokullisja e gurëve si dhe nga orteqet.

**Masat hidraulike** - Masat hidraulike janë të njëjtë sikurse për vërvshime duke qenë se vërvshimi është një nga shkaktarët kryesor të erozionit

### Masat bujqësore

- Mbrojtja dhe shfrytëzimi i tokës bujqësore
- Përdorimi i përvojave të mira bujqësore
- Shfrytëzimi i duhur i sistemeve të ujitjes dhe shkarkimit
- Rritja e investimeve për mbrojtjen e tokave përgjatë brigjeve të lumenjve.

### Masat biologjike

- Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerje e pakontrolluar dhe zjarret
- Parandalimi i kullotjes në zonat me bimësi të varfër
- Pyllëzimi i zonave të zhveshura apo të degraduara
- Krijimi i brezave të gjelbër në zonat ku mundësia e erozionit është më e lartë
- Mbjellja përgjatë shtretërve të lumenjve, përrrenjve dhe rrjedhave ku erozioni është aktiv.

*Vlerësim: Parandalimi i erozionit duhet të jetë qëllim i të gjithë banorëve, shfrytëzuesve të tokës bujqësore, tokave malore, pyjeve, ujërave dhe aseteve tjera natyrore. Parandalimi i erozionit është i dobishëm për mbrojtjen e resurseve natyrore si tokat bujqësore, rrjedhat e lumenjve, pyjeve, peizazhit natyror por po ashtu edhe për asetet e krijuara nga njeriu, vendbanimet, infrastruktura rrugore etj.*

### **3.1.8 PROJEKTET E RËNDËSISHME STRATEGJIKE APO NDËRTIMORE SI DHE ZONAT E VEÇANTA TË APROVUARA NË PLANIN HAPËSINOR TË KOSOVËS**

Strategjia 1: KOMUNA SË BASHKU ME MINISTRITË PËRKATËSE DUHET TË PËRCAKTOJË PËRGJEGJËSITË LIDHUR ME ZONAT E VEÇANTA

- Përcaktimi i përgjegjësive të komunës në lidhje me ndikimet mjedisore dhe sociale në monumentin e natyrës “Mirusha”
- Përcaktimi i përgjegjësive të komunës në lidhje me ndikimet mjedisore dhe sociale në zonat e mbrojtura: Manastiri i Budisalcit, Manastiri i Dollcit dhe Hermitazhi me kishë apo Kisha e Heremitëve
- Harmonizimi i Planit tëi zhvillimit të komunës dhe urban me planet zhvillimore të këtyre zonave.

*Vlerësim: Këto projekte të rëndësishme do të ndikojnë në jetën e banorëve në të ardhmen e afërt, por mund të kontribuojnë edhe në zhvillimin e përgjithshëm të komunës. Andaj, është e nevojshme që komuna të jetë e kyçur aktivisht në procesin e planifikimit dhe implementimit të projekteve.*

### **3.2 KORNIZA KOHORE, IMPLIKIMET FINANCIARE, KORNIZA INSTITUCIONALE**

#### **3.2 KORNIZA KOHORE, IMPLIKIMET FINANCIARE, KORNIZA INSTITUCIONALE**

##### **3.2.1 STRATEGJIA DHE VEPRIMET PËR ZHVILLIMIN E AGRIKULTURËS**

<b>STRATEGJIA / AKTIVITETI</b>	<b>Implikimet financiare</b>	<b>Horizonti kohor / intervalet e planifikimit</b>	<b>Korniza institucionale subjekti</b>	<b>Prioriteti (1,2,3)</b>
<b>Strategja 1: FUQIZIMI I DREJTORISË SË BUJQËSISË DHE I SHOQATËS SË BUJQVE</b>				
A1- Informimi i bujqve përmes shoqatës së tyre për zhvillimin bujqësor si dhe produktet dhe teknologjite e reja, me qëllim të rritjes së kapacitetit të njohurive për produkte bujqësore më cilësore.	I ulët	Në vazhdimësi	Komuna, Asociacioni i fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1
A2- Nxitja e ekskursioneve dhe vizitave në terren, në regionet ku mund të mësohen përvoja të dobishme, qoftë në Kosovë apo në shtete fqinje, me qëllim që bujqit të njoftohen me të arriturat më të fundit në zhvillimin e prodhimeve dhe teknologjive te reja.	I ulët	Afatshkurtër	Komuna, Asociacioni i fermerëve dhe ndërmarrjet private,	1

<b>STRATEGJIA / AKTIVITETI</b>	<b>Implikimet financiare</b>	<b>Horizonti kohor / intervalet e planifikimit</b>	<b>Korniza institucionale subjekti</b>	<b>Prioriteti (1,2,3)</b>
<b>Strategja 2: PËRKRAHJA E SINERGJIVE ME FORMA TJERA TE AKTIVITETEVE AFARISTE</b>				

A1- Inicimi i pilot projekteve për agroturizëm; krijimi i strukturave organizative informuese. Gjatë zhvillimit të prodhimtarisë bujqësore për përpunimin e produkteve ushqimore, është e nevojshme që aktivitetet zhvillimore turistike të përshtaten me prodhimtarinë bujqësore karakteristike për regionin e Klinës.	I lartë	Afatshkurtër	Komuna, Asociacioni i fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	2
A2- Tërheqja e investimeve të jashtme drejtëpërdrejt në industrinë e prodhimit të mjaltit, drithërave, mollës, dredhzës, vishnjës,,, prodhimit të mishit si dhe qumështit dhe produkteve të tij.	I lartë	Afatgjatë	Komuna, Asociacioni i fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1
A3- Krijimi i një platforme të internetit për promovimin e produkteve rajonale. Për përkrahjen e prodhimtarisë bujqësore si dhe bizneseve tjera është e nevojshme që të kriohet një “broadband” (brez i gjerë), infrastrukturë tërësishët e re dhe sigurim i internetit për të gjitha bizneset, sidomos në parkun e ri të biznesit.	I mesëm	Afatgjatë	Komuna, Asociacioni i fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1
A4- Identifikimi i pjesëmarrësve të mundshëm për procesimin dhe përpunimin e prodhimit bujqësor. Krijimi i një sistemi të bashkëpunimit për procesimin dhe përpunimin e ushqimit, në mënyrë që të ndahet investimi për teknologjinë e nevojshme si dhe tregtimin e prodhimeve. Pjesëmarrësit e mundshëm në këtë bashkëpunim, do ti shfrytëzojnë bashkërisht pajisjet dhe teknologjinë e përbashkët si dhe administratën dhe marketingun.	I lartë	I vazhdueshëm	Komuna, Asociacioni i fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1

<b>STRATEGJIA / AKTIVITETI</b>	<b>Implikimet financiare</b>	<b>Horizonti kohor / intervalet e planifikimit</b>	<b>Korniza institucionale subjekti</b>	<b>Prioriteti (1,2,3)</b>
<b>Strategjia 3: NGITJA E NJOHURIVE PËR TEKNOLOGJITË DHE MARKETINGUN E PRODHIMTARISË</b>				
A1- Krijimi i shkollës së mesme të bujqësisë. Programi shkollor do të duhej të përqëndrohej në prodhimtarinë e drithërave, pemëve dhe perimeve, dhe pylltarisë. Kjo shkollë do të duhej të jetë e aftë të tërheqë nxënës dhe mësimdhënës - profesionistë ,jo vetëm nga Kлина por edhe nga Kosova e më gjerë.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Asociacioni I fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministria e Arsimit. Shkencës dhe Teknologjisë	1
A2- Krijimi i një marke për prodhimet bujqësore në bashkëpunim me shoqatën e fermerëve dhe specialistët e marketingut. Kriteret për cilësinë e markave duhet të përcaktohen me qëllim të ekzistimit të prodhimeve me cilësi të vërtetuar.	I ulët	Afatshkurtër	Komuna, Asociacioni I fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1
A3- Krijimi i një qendre informative bujqësore të vendosur në shkollen e mesme përkatëse e cila ofron arsimim të vazhdueshëm. Hapësirat eksperimentuese (fermat) do të përfshihen në përbajtjet shkollore. Me qëllim të funksionimit të suksesshëm, kjo hapësirë do të udhëhiqet nga bordi i bujqësisë në kuadër të komunës.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Asociacioni I fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1
aA4-Përparimi i teknologjisë së përpunimit të mjaltit, me qëllim të përmirësimit të prodhimtarisë së organizuar të mjaltit dhe krijimit të një sistemi të klasifikimit të saj.	I mesëm	Afatshkurtër	Komuna, Asociacioni I fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe	1

			Zhvillimit Rural	
A5- Krijimi i një prodhimtarie të organizuar të mollës dhe produkteve të saj. Krijimi i një marke të mollës me qëllim të prezantimit të prejardhjes gjeografike.	I ulët	Afatshkurtër	Komuna, Asociacioni i fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1

STRATEGJIA / AKTIVITETI	Implikimet financiare	Horizonti kohor / intervalet e planifikimit	Korniza institucionale subjekti	Prioriteti (1,2,3)
-------------------------	-----------------------	---	---------------------------------	--------------------

#### Strategja 4: NGRITJA E EFIKASITETIT TË FERMAVE

A1- Fermat e vogla të qumështit duhet të rriten ndërsa kooperativa e prodhimit të qumështit duhet të zgjerohet edhe me ferma të reja me qëllim të ngritjes së efikasitetit të prodhimit.	I lartë	Afatgjatë	Komuna, Asociacioni i fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	1
A2- Krijimi i parkut të makinave të shoqatës së fermerëve, me qëllim të sigurimit të makinave dhe teknologjisë së nevojshme bujqësore, ashtu që fermerëve t'u mundësohet një sistem i huazimit dhe shmangies së shpenzimeve të panevojshme për makinat të cilat mund të shfrytëzohen bashkërisht.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Asociacioni i fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	2

<b>STRATEGJIA / AKTIVITETI</b>	<b>Implikimet financiare</b>	<b>Horizonti kohor / intervalet e planifikimit</b>	<b>Korniza institucionale subjekti</b>	<b>Prioriteti (1,2,3)</b>
<b>Strategjia 5: MBROJTJA E TOKËS BUJQËSORE</b>				
A1- Identifikimi dhe klasifikimi i zonave me tokë cilësore për prodhime të veçanta bujqësore si dhe me peizazhe të bukura, të rëndësishme për komunën dhe zona të veçanta rurale.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Asociacioni I fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	
A2- Hartimi i planeve zhvillimore dhe rregulluese për subqendra dhe qendrat lokale të rëndësishme për zhvillimin e bujqësisë Me qëllim të zhvillimit dhe rritjes, prioritet duhet ti jepet djerrinave dhe tokave me cilësi të ulët bujqësore.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Asociacioni I fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	
A3- Rehabilitimi i tokës së degraduar bujqësore nga vërshimet, erozioni dhe rrëshqitjet si dhe zonat e deponieve të dikurshme legale apo ilegale. Konsolidimi në zonat me tokë të cilësisë së lartë bujqësore është i nevojshëm, ndërsa kadastri i tokës bujqësore do të jetë instrument për mbrojtjen e tokës bujqësore.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Asociacioni I fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	

A4- Rehabilitimi i sistemit të ujitjes me qëllim të sigurimit të kushteve për kultivimin e tokës	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Asociacioni I fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	
A5- Shfrytëzimi efikas i përmbajtjeve industriale që tashmë janë të pajisura me infrastrukturë për zhvillime të reja si dhe rehabilitimi i industrive ekzistuese me qëllim të parandalimit të humbjes së tokës bujqësore	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Asociacioni I fermerëve dhe ndërmarrjet private, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	

#### 4.2.2 STRATEGJA DHE VEPRIMET PËR ZHVILLIMIN E TURIZMIT

STRATEGJIA / AKTIVITETI	Implikimet financiare	Horizonti kohor / intervalet e planifikimit	Korniza institucionale subjekti	Prioriteti (1,2,3)
<b>Strategja 1: KRIJIMI I BORDIT VENDOR TË TURIZMIT ME QËLLIM TË KOORDINIMIT TË ZHVILLIMIT TË TURIZMIT</b>				
A1- Krijimi i një sistemi të përgjithshëm informativ turistik (hartat, udhëzuesit, broshurat, ueb faqja...)	I mesëm	Afatmesëm	Komuna, ndërmarrjet private, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	2

A2- Ngritja e kapacitetave të njohurive mbi turizmin përmes kurseve të specializuara, vizitave studimore dhe programeve të specializuara, në kuadër të shkollimit të mesëm me mësimdhënës vendor apo ndërkombëtar.	I mesëm	Afatshkurtër	Komuna, ndërmarrjet private, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	1
A3- Organizimi i vizitave pa pagesë për operatorët turistik ndërkombëtarë, në mënyrë që të bëhet një vlerësim në vend për mundësitë turistike dhe veprimet e nevojshme për zhvillimin e turizmit, duke u bazuar në interesat e investitorëve.	I mesëm	Afatshkurtër	Komuna, ndërmarrjet private, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	2
A4- Hartimi i studimeve të fisibilitetit për komunën, në mënyrë që detajisht të identifikojen potencialet për aktivitete turistike	I mesëm	Afatshkurtër	Komuna, ndërmarrjet private, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1
<b>Strategjia 2: PROMOVIMI I NJË LIDHJEJE EFIKASE NE MES TE QYTETITT DHE MONUMENTIT TË NATYRËS "Mirusha" SI DHE KRIJIMI I QENDRËS SË VIZITORËVE NË KUADËR TË MONUMENTIT TË NATYRËS, NË BASHKËPUNIM ME MINISTRINË E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE KUNUNAT PJESËMARRËSE</b>				
A1- Komuna e Klinës duhet të jetë e angazhuar intensivisht në procesin e planifikimit për monumentin e natyrës "Mirusha". Ndërtimi i qendrës së vizitorëve do ta promovonte atraksionin turistik në Mirushë. Kjo qendër po ashtu do të duhej të zhvillonte programe të vizitave dhe aktiviteteve rekreative në pikat e ndryshme atraktive (ujëvarat, shpellat etj)	I lartë	Afatmesëm	Komuna, ndërmarrjet private, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,	2

STRATEGJIA / AKTIVITETI	Implikimet financiare	Horizonti kohor / intervalet e planifikimit	Korniza institucionale subjekti	Prioriteti (1,2,3)
-------------------------	-----------------------	---	---------------------------------	--------------------

**Strategjia 3: KRIJIMI I INFRASTRUKTURËS TURISTIKE**

A1- Ndërtimi i infrastrukturës bazike turistike - qasja, informimi etj. Kjo nënkupton krijimin e rrjetit të shtigjeve i, ecje, në zonat në kuadër të Monumentit të Natyrës si dhe në zonat me vlera të shquara natyrore apo të trashëgimisë kulturore.	I lartë	Afatgjatë	Komuna, ndërmarrjet private, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	2
A2 - Ndërtimi i një sistemi të përshtatshëm informativ—ueb faqe, harta, broshura dhe mjete tjera informuese, për ta përkrahur zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit, varësisht nga resurset.	I lartë	Afatgjatë	Komuna, ndërmarrjet private, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1
A3- Bordi i turizmit do të krijojë qendrat informative turistike, në bazë të planit të përgjithshëm zhvillimor turistik. Në fillim, qendra informative turistike duhet të krijohet në qytetin e Klinës, ndërsa ajo pasuese do të mund të krijohej në kuadër të qendrës së vizitorëve në Monumentin e Natyrës .	I mesëm	Afatmesëm	Komuna, ndërmarrjet private, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	2

**Strategjia 5: MBROJTJA E NATYRËS DHE MJEDISIT**

A1- Promovimi i natyrës dhe mjedisit si resurs për turizëm ekologjik. Sigurimi i të gjitha të dhënavë të nevojshme për lokacionet, vijat e transportit publik si dhe shtigjet për ecje apo çiklizëm.	I ulët	Afatshkurtër	Komuna, ndërmarrjet private, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1
--	--------	--------------	---	---

A2- Sigurimi i pajisjeve dhe i shërbimeve të nevojshme për mbajtjen e zonave të pastra dhe të sigurta. Shfrytëzimi i zonave të mbrojtura natyrore dhe peizazheve të vlefshme në mënyrë të qëndrueshme, në mënyrë që të zgjedhohen ndikimet nga turizmi dhe të mbrohen vlerat e këtyre zonave.	I mesëm	Afatshkurtër	Komuna, ndërmarrjet private, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1
---	---------	--------------	---	---

**Strategja 7: PROMOVIMI I SPELEOTURIZMIT**

A1- Krijimi i shoqatës së speleologëve të Klinës, e cila së bashku me bordin e turizmit do të jenë përgjegjëse për hulumtimin e shpellave dhe përgatitjen e të gjitha informatave të nevojshme për zhvillimin e speleoturizmit.	I ulët	Afatshkurtër	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	
A2- Organizimi i hulumtimeve speleologjike, përkatesisht hulumtimeve kimike, biologjike, gjeologjike, meteorologjike dhe hartografike.	I lartë	Afatgjatë	Komuna, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	
A3- Përgatitja e planit menaxhues, duke i përfshirë të gjitha llojet e informatave mbi lokacionet e identikuara për vizita turistike dhe vizita studimore.	I mesëm	I vazhdueshëm	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	

STRATEGJIA / AKTIVITETI	Implikimet financiare	Horizonti kohor / intervalet e planifikimit	Korniza institucionale subjekti	Prioriteti (1,2,3)
-------------------------	-----------------------	---	---------------------------------	--------------------

**Strategja 8: PROMOVIMI I GJUETISË SI AKTIVITET PLOTËSUES I OFERTËS TURISTIKE**

A2– Përgatitja e planit menaxhues për gjuetinë, dukë përfshirë të gjitha zonat e përcaktuar për gjeti. Ky plan duhet të përcaktojë të gjithë akterët përgjegjës për menaxhim dhe masat e nevojshme të sigurisë.	I mesëm	Afatshkurtër	Komuna, ndërmarrjet, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1
A3- Komuna, në bashkëpunim të ngushtë me shoqatën e gjuetarëve, duhet të aplikojë të gjitha masat për mbrojtjen e biodiverzitetit të zonave të përcaktuara për gjeti.	I mesëm	Në vazhdimsi	Komuna, ndërmarrjet, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1

#### 4.2.2 STRATEGJITË PËR ZHVILLIMIN E NVM-ve

STRATEGJIA / AKTIVITETI	Implikimet financiare	Horizonti kohor / intervalet e planifikimit	Korniza institucionale subjekti	Prioriteti (1,2,3)
<b>Strategjia 1: PËRKRAHJA E ZHVILLIMIT TË NVM-ve NË BUQËSI DHE TURIZËM PËRMES AGJENSISË PËR ZHVILLIM RAJONAL</b>				
A1- Krijimi i qendrës trajnuese profesionale për profesionistët e rinj për ngritjen e aftësive në bujqësi, turizëm, ndërmarrësi. Po ashtu, në kuadër të qendrës së aftësimit, mund të ofrohen seminare dhe kurse për zhvillim ekonomik dhe njohuri mbi marketingun.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, ndërmarrjet private, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	1

A2- Krijimi i agjencisë lokale për ofrimin e hapësirave për zhvillim ekonomik, lokacionet e biznesit apo menaxhim.  Përkuqja e ndërmarrësve të rinj përmes implementimit të "qendrës nismëtare: (inkubatorit të biznesit) ku ndërmarrjet mund të shfrytëzojnë infrastrukturën e përbashkët dhe të përfitojnë në mënyrë të ndërsjellë. Kjo qendër duhet të ofrojë: huazimin e hapësirave për zyre dhe seminare me me çmime të ulëta, qendrën e përbashkët të shitjes, këshillime mbi kontabilitetin, këshilla ligjore dhe përtaksat	I lartë	Afatmesëm	Komuna, ndërmarrjet private, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	1
--	---------	-----------	--	---

**Strategja 2: SIGURIMI I LOKACIONIT DHE INFRASTRUKTURËS PËR PËRMBAJTJET PRODHUESE TË NVM**

A3-Krijimi i parkut të biznesit / industrial me infrastrukturë përkatëse dhe kyçjeve me rrjetin regional rrugor. Vendimi për lokacionin duhet të bazohet në një varg kriteresh si: qasja e mire në korridoret rruvore – jo përmes zonave të banuara,, disponimi i tokës me çmim të ulët,, zgjedhimi i ndikimeve të dëmshme në vendbanime dhe peizazh,, mundësitë përzgjerim; toka, infrastruktura përkatëse (kanalizimi, uji, rrëryma, komunikimi, ngrohja)	I lartë	Afatmesëm	Komuna, ndërmarrjet private, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	1
---	---------	-----------	--	---

#### 4.2.2 STRATEGJITË DHE VEPRIMET E SISTEMIT TË TRAFIKUT DHE TRANSPORTIT

STRATEGJIA / AKTIVITETI	Implikimet financiare	Horizonti kohor / intervalet e planifikimit	Korniza institucionale subjekti	Prioriteti (1,2,3)
<b>Strategjia 1: ZHVILLIMI I NJË SISTEMI TRANSPORTUES TË SIGURT, TË BESUESHËM, TË ARRITSHËM DHE EFIKAS I CILI I RUAN RESURSET HISTORIKE, PEIZAZHORE, BUQËSORE DHE NATYRORE SI DHE I PËRMBUSHË NEVOJAT E BANORËVE PËR TRANSPORT</b>				
A1- Përmirësimin e rrjetit rrugor komunal me fondet ekzistuese dhe të zotuara nga BQQ (Komuna dhe MTPT). Fondet do të përqendrohen në zonat me qasje të dobët rrugore si dhe në zonat e parapara për zhvillim duke i lidhur këto zona me lidhjet kryesore - rrugët rajonale si dhe ato kryesore lokale	I lartë	Afatgjatë	Komuna, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit,	1
A2- Identifikimi i rrugëve prioritare të cilat duhet të ndërtohen me qëllim që të përmirësohet qasja dhe lidhjet në mes sub-qendrave dhe qendrave lokale në Komunën e Klinës apo me komunat fqinje.	I ulët	Afatshkurtër	Komuna, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit,	1
A4- Hulumtimi i mundësive për ruajtjen e vlerave historike dhe peizazhore në komunë përmes kufizimit të zhvillimit përgjatë rrugëve kryesore dhe rajonale.	I ulët	Afatshkurtër	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1
<b>Strategjia 2: BASHKËPUNIMI ME MTPT PËR PËRMIRËSIMIN E RRJETIT TË TRANSPORTIT</b>				
A1- Ndërtimi i rrugëve malore me qëllim të zhvillimit të blegtorisë, pylltarisë dhe turizmit.	I lartë	Afatgjatë	Komuna, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit,	1
A2- Ndërtimi i rrugës për në monumentin e natyrë s”Mirusha”	I lartë	Afatgjatë	Komuna, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit,	2

<b>STRATEGJIA / AKTIVITETI</b>	<b>Implikimet financiare</b>	<b>Horizonti kohor / intervalet e planifikimit</b>	<b>Korniza institucionale subjekti</b>	<b>Prioriteti (1,2,3)</b>
<b>Strategjia 3: PËRMIRËSIMI I QASJES SË TË GJITHA VENDBANIMEVE NË SHËRBIMET E TRANSPORTIT PUBLIK</b>				
A1- Vlerësimi i qasjes së çdo fshati në mjetet e transportit publik si dhe lidhjeve në mes Klinës, subqendrave dhe vendbanimeve tjera.	I ulët	Afatshkurtër	Komuna	1
A2- Përmirësimi i rrugëve, të shtruara apo të pashtuara, në mënyrë që të mundësohen vijat e transportit publik për në secilin fshat.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, ndërmarrjet private, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	1
A3- Inkurajimi i përpjekjeve për shërbime të transportit publik dhe privat.	I ulët	Afatshkurtër	Komuna, ndërmarrjet private, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit	1
<b>Strategjia 4: ZHVILLIMI DHE INKURAJIMI I PËRDORIMIT TË MËNYRAVE ALTERNATIVE TË TRANSPORTIT</b>				
A1- Krijimi i shtigjeve përçtikës së komunën.	I lartë	Afatgjatë	Komuna	2
A2- Zhvillimi dhe promovimi i shfrytëzimit të parkut dhe shtigjeve në mënyrë që të përkrahë turizmi dhe rekreimi në natyrë.	I mesëm	Afatmesëm	Komuna	2

### 3.2.2 STRATEGJIA DHE VEPRIMET PËR POPULLSINË, BANIMIN DHE VENDBANIMET

STRATEGJIA / AKTIVITETI	Implikimet financiare	Horizonti kohor / intervalet e planifikimit	Korniza institucionale subjekti	Prioriteti (1,2,3)
<b>Strategja 1: KUFIZIMI I ZGJERIMIT TË VENDBANIMEVE NË ZONAT PËRKATËSE</b>				
A1- Ndërtimi i infrastrukturës nuk do të ofrohet jashtë zonave të definuara për ndërtim, përveç përfunkzionet e përcaktuara me nenin 17.3 të Ligjit për Planifikim Hapësinor.	I lartë	Afatgjatë	Komuna , Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1
A2- Shfrytëzimi i densifikimit brenda kufijve aktual të territorit të ndërtuar të vendbanimeve dhe shmangia e zgjerimeve të pakontrolluara në zhvillimet e reja.	I mesëm	Afatgjatë	Komuna	1
A3- Komuna është e lejuar të kontrollojë politikën e zgjerimit, me të gjitha mjetet që janë në kompetencë të komunës.	I ulët	Afatgjatë	Komuna , Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,	1
<b>Strategja 2: SIGURIMI QË KLINA DHE VENDBANIMET TJERA JANË ATRAKTIVE PËR TË JETUAR DHE PUNUAR</b>				
A1- Sigurimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në fshatra me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës.	I lartë	Afatgjatë	Komuna, Sektori privat	1
A2- Promovimi i jetës dhe punës në Klinë dhe fshatra, duke ofruar përmbytje publike për ta ngritur nivelin e jetesës.	I lartë	Afatgjatë	Komuna, Sektori privat	1

A3- Hulumtimi i mundësive për ripërdorimin dhe mirëmbajtjen e strukturave ekzistuese, si dhe mënjanimin e degradimit fizik të strukturave të vendbanimeve ekzistuese të ndërtuara pa plan.	I lartë	Afatmesëm	Komuna	1
--	---------	-----------	--------	---

STRATEGJIA / AKTIVITETI	Implikimet financiare	Horizonti kohor / intervalet e planifikimit	Korniza institucionale subjekti	Prioriteti (1,2,3)
-------------------------	-----------------------	---	---------------------------------	--------------------

**Strategja 3: SIGURIMI QË ZHVILLIMI I ARDHSHEM I KOMUNËS SË KLINËS DO TË JETË E ORIENTUAR PËRMES PLANEVE ZHVILLIMORE**

A1- Zhvillimi i planeve rregulluese për subqendra si dhe për zonat e tjera të nevojshme zhvillimore. Qëllimi i këtyre planeve është orientimi i zhvillimit të ardhshëm përbrenda dhe përreth zonave përkatëse, duke iu përshtatur karakterit të veçantë të se cilës subqendër.	I lartë	Afatmesëm	Komuna , Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	
A2- Krijimi i një trupi këshillëdhënës i cili do ti këshillojë anëtarët e Asamblesë për çështjet e ujësjellësit dhe kanalizimit, në zonat ku këto shërbime mungojnë.	I lartë	Në vazhdimësi	Komuna	

STRATEGJIA / AKTIVITETI	Implikimet financiare	Horizonti kohor / intervalet e planifikimit	Korniza institucionale subjekti	Prioriteti (1,2,3)
-------------------------	-----------------------	---	---------------------------------	--------------------

**Strategja 1: GARANTIMI QË VENDBANIMET JOFORMALE JANË TË PËRFSHIRA NË PLANIN ZHVILLIMOR TË KOMUNËS SË KLINËS**

A1– Përgatitja e profilit të gjendjes ekzistuese të vendbanimeve joformale në territorin e komunës. Kjo do të duhej të shërbente për përcaktimin e prioriteteve për rregullimin e vendbanimeve joformale, ndërsa do t'u shërbente donatorëve të mundshëm për ofrimin e informatave të nevojshme për përkrahje financiare, njerëzore dhe teknike në kuadër të këtij rregullimi.	I ultë	Afatshkurtër	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1
A2- Çështjet pronësore – ekziston nevoja për angazhim intensiv të komunës për zgjidhjen e problemeve në lidhje me të drejtat pronësore. Çështjet e pazgjidhura pronësore duhen të zgjidhen në mënyrë që të sigurohet baza ligjore për iniciimin e procesit të planifikimit. Kadastra dhe departamentet pronësore duhet të ofrojnë të dhëna dhe harta të përditësuara, në mënyrë që të shmangen problemet me të dhëna gjatë planifikimit.	I lartë	Afatmesëm	Komuna	1
A3- Procesi i planifikimit – rregullimi i vendbanimeve joformale, duhet të realizohet përmes një procesi gjithëpërfshirës, në mënyrë që pjesëmarrësve t'u mundësohet shprehja e kërkeseve dhe një vendimmarrje transparente.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Donatorët	2
A4- Bashkëpunimi me Agjencinë Kosovare të privatizimit – me qëllim tëshmangies së problemeve në raport me tokën publike nën menaxhimin e AKP, e cila është e nevojshme për vendosjen e infrastrukturës publike, sigurimin e hapësirave për shkolla, çerdhe dhe ndërtesa tjera komunale.	I mesëm	Afatgjatë	Komuna, Agjioni Kosovar i Privatizimit	2

### 3.2.2 STRATEGJIA DHE VEPRIMET PËR INFRASTRUKTURËN SOCIALE

<b>STRATEGJIA / AKTIVITETI</b>	<b>Implikimet financiare</b>	<b>Horizonti kohor / intervalet e planifikimit</b>	<b>Korniza institucionale subjekti</b>	<b>Prioriteti (1,2,3)</b>
<b>Strategjia 1: OFRIMI I PËRMBAJTJEVE ARSIMORE NË VENDBANIME, NË PËRPUTHSHMËRI ME FUNKSIONIN E TYRE SI DHE HIERARKINË</b>				
A1- Ngritja e objekteve për çerdhe, në përputhshmëri me standartet ndërkontinentare.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	2
A2- Ngritja e objekteve për edukimin parashkollor	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1
A3- Sigurimi i transportit publik për fshatrat ku distanca deri te shkolla më e afërt është më shumë se 15 minuta ecje.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1
A4- Themelimi i një shkollave për arsim të mesëm të lartë – arsimim profesional në Zajm.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1
A5- Përmirësimi i cilësisë së përmbajtjeve në të gjitha llojet e shkollave.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe teknologjisë	1
<b>Strategjia 2: OFRIMI I PËRMBAJTJEVE SHËNDETËSORE NË VENDBANIME, NË PËRPUTHSHMËRI ME FUNKSIONIN E TYRE SI DHE HIERARKINË</b>				
A1-Ndërtimi i ambulancës së subqendrën e Gllarevës.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Ministria e Shëndetsisë	1

A2- Shndërrimi i ambulancës në Grabanicë në QMF – qendër të mjekësisë familjare.	I mesëm	Afatmesëm	Komuna, Ministria e Shëndetsisë	1
---	---------	-----------	---------------------------------	---

STRATEGJIA / AKTIVITETI	Implikimet financiare	Horizonti kohor / intervalet e planifikimit	Korniza institucionale subjekti	Prioriteti (1,2,3)
-------------------------	-----------------------	---	---------------------------------	--------------------

**Strategja 3: SIGURIMI I QENDRAVE TË KOMUNITETIT NË KUADËR TË QENDRAVE LOKALE**

A1- Themelimi i qendrave të komunitetit në të gjitha qendrat e bashkësive lokale.	I lartë	Afatmesëm	Komuna	2
---	---------	-----------	--------	---

**Strategja 4: OFRIMI I PËRMBAJTJEVE KULTURORE NË VENDBANIME, NË PËRPUTHSHMËRI ME FUNKSIONIN E TYRE SI DHE HIERARKINË**

A1- Ofrimi i përmbajtjeve për veprimtari kulturore në të gjitha qendrat. Këto përmbajtje mund të vendosën në ndërtesat shkollore ose në qendrat lokale të komunitetit.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	2
--	---------	-----------	--	---

**Strategja 5: OFRIMI I PËRMBAJTJEVE SPORTIVE DHE REKREATIVE NË VENDBANIME, NË PËRPUTHSHMËRI ME FUNKSIONIN E TYRE SI DHE HIERARKINË**

A1- Ofrimi i përmbajtjeve për veprimtari sportive dhe rekreative në të gjitha vendbanimet. Hapësirat sportive shkollore mund të shërbejnë për shfrytëzim publik, nëse nuk ekzistojnë mundësi për ndërtim si të veçanta.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	2
---	---------	-----------	--	---

### 3.2.2 STRATEGJIA DHE VEPRIMET MJEDISORE DHE PEIZAZHORE

<b>STRATEGJIA / AKTIVITETI</b>	<b>Implikimet financiare</b>	<b>Horizonti kohor / intervalet e planifikimit</b>	<b>Korniza institucionale subjekti</b>	<b>Prioriteti (1,2,3)</b>
<b>Strategjia 1: MBROJTJA E SHUMËLLOJSHMËRISË PEIZAZHORE</b>				
A1- Sigurimi i mbrojtjes së integruar të monumenteve natyrore dhe kulturore.	I lartë	Afatgjatë	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	1
A2- Ruajtja e kulturave tradicionale të bujqësisë (drithërat, pemëtaria dhe kullosat) në mënyrë që të ruhet struktura historike peizazhere.	I ulët	Afatgjatë	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1
A3- Parandalimi i ndotjes aktuale të lumenjve, tokës dhe ujërave nëntokësor përmes ndërtimit të rrjetit të kanalizimit. Parandalimi i shpyllëzimit dhe erozionit në male, përmes prezantimit të formave të qëndrueshme të shfrytëzimit të pyjeve.	I ulët	Afatgjatë	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1
A4- Forcimi i bashkëpunimit me MMPH.	I ulët	Afatgjatë	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1
A5- Kufizimi i zhvillimit në zonat me tokë bujqësore cilësore si dhe në peizazhet pitoreske.	I ulët	Afatgjatë	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1
A6- Përgatitja e planeve rregulluese për mbrojtjen e peizazheve përgjatë lumenjve.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1

A7- Mbrojtja e shumëlojshmërisë së biotipeve të ndryshme në region.	I ulët	Afatgjatë	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1
---	--------	-----------	---	---

STRATEGJIA / AKTIVITETI	Implikimet financiare	Horizonti kohor / intervalet e planifikimit	Korniza institucionale subjekti	Prioriteti (1,2,3)
-------------------------	-----------------------	---	---------------------------------	--------------------

**Strategjia 2: ZVOGËLIMI I NDIKIMEVE TË DËMSHME TË VEPRIMEVE NGA NJERIU NË MJEDIS**

A1- Përkatja përmirësimin e sistemeve të largimit të mbeturinave në vendbanimet e vogla.	I lartë	Afatshkurtër	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	1
--	---------	--------------	---	---

**Strategjia 3: PËRMIRËSIMI I CILËSISË SË HAPËSIRAVE TË GJELBRA**

A1- Rritja e numrit të parqeve dhe hapësirave të gjelbëra në vendbanimet me popullatë të dendur.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	
A2- Krijimi i një rrjeti integral të gjelbër në qytet dhe komunë.	I lartë	Afatmesëm	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	
A3- Krijimi i hapësirës së gjelbër përgjatë lumenjve dhe mbrojtja nga veprimtaritë ndërtimore.	I lartë	Afatgjatë	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	

**Strategjia 4: TRAJTIMI I MBETURINAVE**

A1- Bashkëveprimi i Komunës me Agjensionin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Kompaninë publike të menaxhimit të	I ulët	Afatgjatë	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	
--	--------	-----------	---	--

mbeturinave, në trajtimin e mbeturinave.				
A2- Promovimi i ndarjes së mbeturinave në bazë të llojit, për riciklimin e tyre.	I ulët	Afatgjatë	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	
A3- Promovimi i riciklimit si veprimtari profitabile ekonomike.	I ulët	Afatgjatë	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	
A4- Mbyllja e deponieve ilegale, pastrimi dhe konsolidimi i tokës, si veprim përmirësimin e kushteve mjedisore.	I lartë	Afatshkurtër	Komuna, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	



## 4.0 DISPOZITAT



## 4. DISPOZITAT PËR ZBATIM

### 4.1 UDHËZIME MBI ÇËSHTJET E INTERPRETIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR TË KOMUNËS GJATË HARTIMIT TË PLANEVE RREGULLUESE DHE PLANEVE TJERA

Ligji për Planifikim Hapësinor definon dy nivele të planifikimit – qendror dhe komunal. PZHK është dokument udhëzues për zhvillimin e tërë territorit të komunës. Ai (PZHK) përcakton kushtet obligative për PZHU dhe planet rregulluese urbane jashtë zonës urbane. Përveç rolit udhëzues për zhvillimin e zonës urbane, PZHU definon kushtet e zhvillimit të pjesëve të qytetit – planeve rregulluese për lagjet dhe blloqet urbane. Planet rregulluese nuk duhet të jenë në konflikt me dispozitat e Planit Zhvillimor Komunal.

Pasi që Plani Hapësinor i Kosovës është i miratuar, një numër i vendimeve nga autoritetet komunale duhet të pasojnë, sa i përket komunës së Klinës.

Dispozitat:

- PZHK duhet të jetë i bazuar në Planin Hapësinor të Kosovës dhe vendimet për zhvillimet me rëndësi për nivelin e Kosovës duhet të respektohen në tërësi.
- PZHK duhet të marrë parasysh zhvillimet rreth shpalljes së Mirushës në monument natyre, , sa i përket territorit që gjendet brenda kufijve administrativ të komunës së Klinës. Plani Hapësinor i cili do të hartohet, do të përcaktojë një kornizë të shfrytëzimit të hapësirave dhe zhvillimet brenda parkut. Planet Rregulluese Urbane për zonat e rekreacionit dhe turizmit përbrenda Monumentit te natyrës Mirusha, duhet të jenë të hartuara në bashkëpunim të ngushtë me Institutin për Planifikim Hapësinor dhe Agjensionin për mbrojtje të Mjedisit nga MMPH.
- PZHK do të jetë plan bazë për çfarëdo plani rregullues që do të hartohet për nën-qendrat dhe cilindro zhvillim të përcaktuar jashtë zonës urbane. Këto plane nuk duhet të cenojnë dispozitat e Planit (PZHK).
- Çfarëdo vendimi nga PZHU ose planet rregulluese urbane, që mund të jenë në kundërshtim me vendimet e PZHK, kërkojnë rishikim adekuat dhe miratim në Asamblenë Komunale.

### 4.2 KUSHTE TË PËRCAKTUARA NGA QEVERIA LOKALE MBI ÇËSHTJE TË RËNDËSISHME PËR ZHVILLIMIN DHE SHFRYTËZIMIN E TOKËS NË KOMUNË

#### 4.2.1. KUSHTET PËR PËRCAKTIMIN E DESTINIMIT TË SIPËRFAQeve NË TERRITORIN E KOMUNËS

Vizioni për komunën e Klinës përcakton katër shtylla kryesore, në të cilat duhet të jetë i bazuar zhvillimi i ardhshëm. Zhvillimi i çdonjërës nga këto shtylla ka dimensionin e vet hapësinor, dhe ndikim në zonat e përcaktuara për zhvillim.

Parimet për zhvillim dhe mbrojtje, të cekura në kapitullin 2, formulojnë bazën për përcaktimin e kushteve për çështjet e shfrytëzimit të tokës dhe zhvillimit. Zhvillimi i ardhshëm duhet të jetë i planifikuar dhe i bazuar në vendime adekuate. Me Planin Zhvillimor Komunal për Klinën, toka për zhvillim dhe rregullim është e destinuar për këto lloje të shfrytëzimit:

- 1) Vendbanimet
- 2) Tokë e punueshme
  - 2a) Bujqësia
  - 2b) Kullosat
- 3) Vegjetacioni i lartë
- 4) Zonat me interes të veçantë
  - 4a) Monumenti i natyrës "Mirusha"
  - 4b) Gryka e lumit Klina
  - 4c) Resurset nënëtokësore
  - 4d) Manastiri i Budisalcit
  - 4e) Manastiri i Dollcit
  - 4f) Hermitazhi me kishë apo Kisha e heremitëve
- 5) Lumenjtë
- 6) Sipërfaqet për transport
- 7) Qendrat
  - 7a) Qendra kryesore
  - 7b) Subqendrat
  - 7c) Qendrat lokale

**Kategoritë e shfrytëzimit të tokës së komunës janë:**

### **1) VENDBANIMET**

Sipërfaqja e vendbanimeve nënkupton sipërfaqen e ndërtuar të qendrës urbane- Klinëut, subqendrave, qendrave lokale dhe fshatrat. Në kuadër të saj përfshihen banimi, infrastruktura sociale dhe fizike.

## **2) TOKË E PUNUESHME**

Tokë e shfrytëzuar .

### 2a) BUJQËSIA

Zonë e shfrytëzuar për kultivimin e kulturave bujqësore: arë, kopsht, pemishte, livadh, kullotë, si dhe tokat tjera që nuk do të thotë se janë për qëllime bujqësore, por që shfrytëzimi optimal i të cilave përfshin prodhimin bujqësor dhe zhvillimin e blegtorisë, duke marrë parasysh vetitë e tyre natyrore dhe kushtet ekonomike

### 2b) KULLOSA

Tokë e mbuluar, kryesisht me vegjetacion natyror bimor, e cila shërben për kullotjen, lëshuarjen dhe pushimin e bagëtisë.

## **3) VEGJETACION I LARTË**

Këtu përfshihen të gjitha sipërfaqet me mbi 0.2 ha, të populluara në mënyrë të dendur me bimësi drunore.

## **4) ZONAT ME INTERES TË VEÇANTË**

Janë zonat të cilat për vlerat që i kanë ose shërbimet që i ofrojnë janë më interesë ë posaçëm në nivel kombëtar:

4a) MONUMENTI I NATYRËS ‘MIRUSHA’- vlerë natyrore me interes kombëtar, resurs me potencial për zhvillimin e turizmit, speleoturizmit. Poashtu i rëndësishëm për zhvillimin e ekskurzioneve hulumtuese si për nevoja shkencore ashtu edhe ato arsimore.

4b) GRYKA E LUMIT KLINE- nënkupton vlerë natyrore të çmuar me potencial për zhvillimin e turizmit. Për shkak të karakteristikave gjeomorfologjike, hidrologjike dhe botanike i rëndësishëm edhe për nevoja arsimore.

4c) RESURSET NËNTOKËSORE- rezerva të nevojshme për zhvillimin e miheve të mëdha të thengjillit, të rezervave të boksitit, zhavorrit dhe argjillës për prodhimin e tullave. Gjithashtu edhe të plakave të gurit si identifikuase të komunës së Klinës.

4d) Manastiri i Budislacit

4e) Manastiri i Dollcit

4f) Hermitazhi me kishë apo Kisha e heremitëve

## **5) LUMENJTË- SIPËRFAQET UJORE / UJËRAT**

Të gjitha ujërat sipërfaqësor të përhershëm ose periodik, si lumenjtë, pellgjet, liqenet dhe sipërfaqe të ngashme.

## 6) SIPËRFAQET PËR TRANSPORT

Sipërfaqet për transport përbëhen nga korridoret për transport:

- Rrugët nacionale

Ruga nacionale nënkupton rrugën publike e cila lidh Kosovën me shtetet fqinje.

- Rrugët rajonale

Ruga rajonale nënkupton rrugën publike e cila lidhë dy ose më shumë qytete të mëdha.

- Rrugët kryesore lokale

Rrugët kryesore lokale janë rruget publike që lidhin qendrat e bashkësive lokale brenda komunës së Klinëut.

- Rrugët lokale

janë rruget publike që lidhin qendrat e bashkësive lokale brenda komunës së Klinës

- Rrugët tjera

Rrugët tjera përfshijnë të gjitha rruget tjera publike (përpos rrugëve kryesore lokale dhe rrugëve lokale) që lidhin fshatrat brenda komunës së Klinëut.

- Ruga malore

Ruga malore shfrytëzohet për mirëmbajtjen dhe kontrollimin e maleve, pyjeve si dhe për zhvillimin e turizmit

- Ruga turistike

paraqet rrugën publike që lidh pikat të rëdnësishme atraktive natyrore dhe kulturore në territorin e komunës.

## 7) QENDRAT

### 7a) QENDRA KRYESORE

Qendra urbane ku gjenden të gjitha shërbimet në nivel komunal.

### 7b) SUBQENDRA

Qendrat lokale ku ofrohen veprimtaritë shërbyese të decentralizuara, në mënyrë që të zvogëlojnë qarkullimin e panevojshëm në drejtim të qendrës kryesore - Klinës për shërbimet të cilat do të mund të ofroheshin në kuadër të subqendrave.

### 7c) QENDRAT LOKALE

Qendrat e bashkësive lokale ku ofrohen shërbimet në nivel të bashkësisë lokale

#### **4.2.2 KUSHTET PËR RREGULLIMIN E HAPËSIRËS**

- Ndërtimi do të lejohet vetëm në zonat e destituara për ndërtim, të përcaktuara me PZHK.
- Zhvillimi në qendrën kryesore - Klinë dhe në katër sub-qendrat duhet të rregullohet me Plane Rregulluese Urbane
- Infrastruktura publike do të ofrohet vetëm në zonat e destituara për ndërtim. Në zonat ku Planet Rregulluese Urbane nuk janë të miratuara, duhet zbatuar hulumtimin për kërkesat dhe mundësitë e ofrimit të infrastrukturës.
- Zhvillimet në hapësirën e lirë (peizazhin natyror), duhet bazuar në rregullat mjedisore për mbrojtjen e natyrës dhe peizazhit. Në mungesë të planit rregullues urban, komuna duhet të nxjerrë udhëzimet përkatëse të karakterit obligues.
- Në zonat ku zhvillimi është i lejuar, kushtet si dhe lokacioni duhet të përcaktohen me sa vijon:
  - a) Formën dhe madhësinë e zonës së zhvillimit;
  - b) Mënyrën e shfrytëzimit apo përdorimin e autorizuar për ngastrën tokësore;
  - c) Rregullat e ndërtimit dhe distancën në mes të ndërtesave në ngastër;
  - d) Rregullat për kyçjen e ndërtesës në rrjetin e infrastrukturës;
  - e) Masat për mbrojtjen mjedisore dhe mbrojtjen e tërësive të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.
  - f) Përgatitja e lokacionit, siç është largimi i ndërtesave dhe rehabilitimi i dheut (tokës), hulumtimet gjeo-mekanike etj.

#### **4.2.2.1 NDËRTESAT ME RËNDËSI PËR KOSOVËN NË KOMUNËN E KLINËS**

- Komuna do të ofrojë tokë për shkollat profesionale me infrastrukturën e nevojshme. Lokacioni duhet të plotësojë të gjitha kushtet sa i përket madhësisë së ngastrës, zonës mbrojtëse, orientimit, qasjes në sistemin e transportit publik.

— Komuna do ta marrë përgjegjësinë e plotë lidhur monumentin e natyrës ‘Mirusha’, si dhe hartimin e planit të monumentit si plan për zonë të veçantë, sa i përket mbrojtjes dhe zhvillimit për pjesën e monumentit që shtrihet në komunën e Klinës.

#### **4.2.2.2 ZONAT NDËRTIMORE PËR VENDBANIME**

Zhvillimi i ndërtimeve duhet të zë vend në vendbanimet ekzistuese, ku vetëm zhvillimi dhe ndërtimi plotësues duhet lejuar. Dendësimi i ndërtimit dhe metodat e ndërtimit për shfrytëzim më racional të tokës, duhet të jenë parim kryesor për zhvillimin e ardhshëm.

Definicioni përkatës i veçorive dhe karakterit të ndërtesave në zonat kufizuese me peizazh me vlerë, duhet përcaktuar me planet rregulluese urbane. Planet rregulluese urbane si instrument i planifikimit, duhet të shfrytëzohen po ashtu edhe për të arritur harmoninë e ansambleve ndërtimore me rrethinën.

Infrastruktura dhe shërbimet duhet të ofrohen në zonat e reja për ndërtim (rrjeti elektro-energetik, sistemi i ujit dhe kanalzimit). Zhvillimi i infrastrukturës duhet ofruar gradualisht, bazuar në kërkesat dhe në përputhje me mundësitë financiare të komunës. Alternativat tjera si partneriteti publik-privat ose skemat private të financimit, duhet dakorduar me komunën. Pronari i ndërtesës duhet të paguajë taksat për infrastrukturë, ndërsa mënyra e shpërndarjes duhet të elaborohet.

#### **4.2.2.3 STRUKTURAT E NDËRTUARA JASHTË VENDBANIMEVE**

— Për zonat e përcaktuara në Planin Zhvillimor Komunal si të lira nga cilido lloj i zhvillimit dhe të mbrojtura nga ndërtimi duhet garantuar:

- a) Mbrojtjen e zonave për zhvillimin e vazhdueshëm të bujqësisë
- b) Zonat me vlera të veçanta ekologjike
- c) Mbrojtjen e peizazhit natyror dhe lokacioneve të trashëgimisë, dhe po ashtu zonat e lidhura natyrore për rekreacion. (duke mos kundërshtuar zhvillimin e vendbanimit)

— Jashtë zonës ndërtimore do të lejohen vetëm këto ndërtesa: (Ligji për Planifikim Hapësinor)

- a) Ndërtesat publike për mbrojtje ose mbrojtje civile;
- b) Ndërtesa për mbrojtje nga zjarri dhe materialet e dëmshme – eksploziv etj;
- c) Ndërtesat për menaxhimin e resurseve ujore;
- d) Infrastruktura;
- e) Ndërtesa për hulumtimin dhe shfrytëzimin e materialit mineral të eksplotuar;
- f) Rekreacion dhe turizëm rural

- Komuna nuk do të jetë përgjegjëse për ofrimin e infrastrukturës jashtë vendbanimeve. Bazuar në shfrytëzimin e përcaktuar të tokës, ofrimi i infrastrukturës për zhvillimin e ri do të jetë përgjegjësi e pronarëve ose ndërmarrësve.

#### **4.2.3 KUSHTET PËR VENDOSJEN E VEPRIMTARIVE EKONOMIKE**

- Komuna do të alokojë tokë të mjaftueshme që të përkrahë zhvillimin e biznesit i cili është i bazuar në shfrytëzimin e fuqisë punëtore vendore.
- Komuna do të përkrahë themelimin e Agjensionit Rajonal për Zhvillim, për ofrimin e hapësirës për zhvillim ekonomik, lokacion të biznesit dhe menaxhim.
- Komuna do të alokojë tokë ndërtimore prej së paku 5 Ha, të pajisur me infrastrukturë, për shkollën e mesme të re me specializim përkatës për bujqësi si dhe qendrën informative për bujqësi
- Në zonat e përcaktuara për biznes dhe industri, do të lejohet vetëm ndërtimi i përmbajtjeve të pastra për prodhimtari bujqësore dhe industriale, depot, shërbimet dhe përmbajtjet tregtare të cilat nuk kanë ndikim negativ në mjedis.
- Lokacioni për përmbajtje të pastra të prodhimtarisë dhe shfrytëzim përkatës komercial, mund të zhvillohen në kuadër të vendbanimeve, vetëm nëse ato nuk shkaktojnë ndikim negativ në mjedisin që i rrethon (emisioni i gazrave, ndotja e ajrit dhe ujit, zhurma).
- Bizneset industriale dhe komerciale me ndotje të shprehur nuk do të lejohen fare.
- Zgjerimi i zonave ekzistuese të industrisë dhe biznesit, do të lejohet vetëm nëse qëndrueshmëria e zonës është paraprakisht e dëshmuar, në rast të urgjencës dhe mungesës së hapësirës së përshtatshme për t'u zgjeruar.
- Parqet e reja të biznesit duhet të dëshmojnë furnizim energjetik të vet-qëndrueshëm, me prodhim të energjisë nga burimet e ripërtërishme nëse ato gjenden në afërsi të potencialit të lartë për energji të ripërtërishme.
- Në fshatra do të jetë i lejuar vetëm ndërtimi i akomodimeve të vogla, me maksimum 20 shtretër për turistë, dhe atë nëse në tërësi respektohen kushtet mjedisore.
- Komuna do të lejojë ndërtimin e infrastrukturës, që përkrahë atraksionet turistike dhe aktivitetet e rekreacionit, të cilat nuk kanë asnjë ndikim negative në mjedis – shtigjet për bjeshkatarë dhe çiklistë, pikat e vizitës, bujtinat për periudha të shkurtra, etj.

#### **4.2.4 KUSHTET PËR VENDOSJEN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE**

- Nga ana e komunës do të udhëhiqet një politikë, për të mbrojtur zonën e infrastrukturës me interes për komunën.

- Plani Zhvillimor Komunal duhet të alokojë tokë rezervë për kërkesa të veçanta (banimi për të moshuarit, institucionet për persona me kërkesa specifike, jetimore etj.), si dhe për zgjerimin e zonave të aktivitetit publik në përputhje me funksionin e vendbanimit – qendra kryesore, nën qendra, qendër lokale dhe fshat.
- Komuna duhet të alokojë hapësirë për shkolla të reja dhe institucione parashkollore. Ato duhen rregulluar me breza mbrojtës dhe të jenë të arritshme me transport publik. Ngastrat e alokuara për këtë ndërtim, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
  - a) Institucionet parashkollore 20 - 40 m<sup>2</sup>/fëmijë
  - b) Shkollat fillore 20 - 50 m<sup>2</sup>/fëmijë
- Komuna mund të alokojë një ngastër të përbashkët për ndërtimin e përbajtjeve siç janë: edukimi, kultura, shëndetësia dhe shërbimet sociale, qendra të komunitetit. Kjo posaçërisht është e rëndësishme për sub-qendrat dhe qendrat lokale.
- Zonat e destinuara për sport dhe rekreacion duhet te jenë të furnizuara me shtigje, infrastrukturë dhe gjelbërim. Ne kuadër te këtyre zonave do te lejohet vetëm ndërtimi i objekteve te hapura dhe te myllura sportive, hapësira për parkim, restorante te vogla dhe dyqane për blerjen dhe marrjen me qira të pajisjeve sportive. Maksimumi i indeksit të shputës nuk guxon të kalojë 10% të sipërfaqes së ngastrës.

#### **4.2.5 KUSHTET PËR VENDOSJEN E KORRIDOREVE APO TRASEVE, SIPËRFAQEVE KOMUNIKUESE DHE SISTEMEVE TJERA TË INFRASTRUKTURËS**

- Korridoret rrugore duhet të garantohen në shkallë të përshtatshme, në harmoni me funksionin e gendrave dhe kërkesave kombëtare e rajonale.
- Gjatë procesit të përcaktimit të zonave të ndërtimit, duhet të dëshmohet se është shmangur kostoja e lartë e zhvillimit dhe mirëmbajtjes. Ndërtimi duhet ti respektojë rregulloret për një ndërtim të qëndrueshëm – orientimi, kushtet klimatike etj.
- Duhet te hartojet koncepti detaj i mobilitetit (përfshirë edhe transportin publik, këmbësorët dhe çiklistët) për komunën e Klinës. Ky koncept duhet te përcillet me plan detaj për zhvillimin e turizmit.
- Problemet teknike lidhur me sigurinë e rrugëve (gjerësia e rrugëve, kalimet e rrezikshme, pjerrësia....), duhet të shmangen dhe të lehtësohen me masa të përshtatshme.
- Qasje direkte për zhvillim në rrugët kryesore (p.sh. Kategoria 1) me kufizim të shpejtësisë me më shumë se 60 Km/h nuk do të lejohet.
- Ministria e transportit dhe Post Telekomunikacionit është përgjegjëse për rrugët kryesore ,rajonale e nacionale kështu që rregulloret dhe standarde teknike meritore janë dhënë nga Ministria.

- Ne komunën e Klinës, rrugët kryesore lokale, rrugët lokale dhe rrugët e tjera duhet të dimensionohen në mënyrë që të mund të lejojnë rrjedhë të sigurt të trafikut për të gjitha automjetet në çfarëdo kushte atmosferike. Shtigjet e trafikut duhet të respektojnë rregulloret ekzistuese. Shtigjet duhet të jenë të gjëra së paku 3.0m'. Aty ku ka probleme dhe mund të paraqiten barrierat fizike vështirë të kalueshme, shtigjet mund të ngushtohen.
- Nëse pozita financiare e komunës nuk mund te sigurojë zbatimin e rrugëve me hapësira te veçanta për këmbësorë - në zonat e banimit, rekomandohet që rruga të përfshijë shtigjet për këmbësorë.
- Rruga për qasje në ngastrat për ndërtim duhet te jetë minimum 3.0 m' e gjerë dhe maksimum 60.0 m' e gjatë.
- Të gjitha udhëkryqet në nivelin e terrenit, duhet te sigurojnë pamje prej te gjitha drejtimeve.
- Shtigjet për çiklizëm të një drejtimi, nëse janë te ndara, duhet të jenë 0,8m' të gjëra.
- Nëse hapësirat për çiklizëm janë të ndara, atëherë shtegu i gjelbër duhet të jetë 0,35m'.
- Në zonat për parkim që shërbejnë për transportin publik, shtegu i ndaljeve të autobusëve duhet të jetë 2.0 m' i gjerë.
- Standardet për parkim janë si në vijim:
  - a) Shtëpi banimi për një familje(1VP/shtëpi) në ngastër;
  - b) Banimi shumë familjar (1VP/1 banesë, në ngastër mbi tokë apo në garazh)
  - c) Zyre: 1 VP në 75 m<sup>2</sup> btto zone; (12 VP/1000 m<sup>2</sup> btto)
  - d) Dyqane: 1 VP në 50 m<sup>2</sup> btto zone; (20 VP/1000 m<sup>2</sup> btto)
  - e) Qendër tregtare: 1 VP në 40 m<sup>2</sup> btto zone; (25 VP/1000 m<sup>2</sup> btto)
  - f) Industri dhe depo: 1 VP / 5 të punësuar;
  - g) Shërbime 1 VP / 3 të punësuar;
  - h) Restorante 1 VP /1 tavolinë;
  - i) Ndërtesa sportive: 1 VP / 20 ulëse:
  - j) Shkolla dhe jetimore: 1 VP/ klasa dhe grupe te fëmijëve;
  - k) Shërbimet e shëndetësisë: 1 VP /40 m<sup>2</sup> btto . (25 VP/1000 m<sup>2</sup> btto)
- Në korridorin rrugor të rrugëve kryesore rajonale, është i lejuar ndërtimi i ndërtesave në vijim:
  1. Pompa të benzinës me dyqane, restorant dhe përmbytje shërbyses

## 2. Larje dhe shërbime të automjeteve

- Këto ndërtesa duhet pasur hapësirën e dedikuar për parkim brenda ngastrës.
- Gjatë kërkimit për leje ndërtimore, miratimi i kushteve speciale për qasje në rrugën nationale, duhet të lëshohet nga Drejtoria për Rrugë në Ministrinë për Transport dhe Post-Telekomunikim.
- Prioritetet për zhvillimin e infrastrukturës teknike do t'i jepen Klinës dhe sub-qendrave, si dhe zonave rurale të pazhvilluara.
- Korridoret duhet të garantohen në një shkallë të caktuar sipas funksioneve të qendrave dhe nevojave nacionale dhe rajonale.

### **4.2.6 MASAT PËR MBROJTJEN E PEIZAZHEVE, VLERAVE NATYRORE DHE TËRËSIVE KULTURO-HISTORIKE**

- Komuna, së bashku me Institucionet e nivelit Qendror, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrinë e Kulturës, Rinise dhe Sporteve, duhet ta përgatitë planin menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës dhe monumenteve kulturore. Plani duhet të mbrojë çfarëdo zhvillimi që do të afektojë vlerat e monumenteve, përvèç atyre që shërbejnë për mbrojtjen e tyre.
- Komuna nuk do të lejojë asnjë zhvillim në tokën kualitative bujqësore, përvèç atyre zhvillimeve që shërbejnë për mirëmbajtje të veprimtarisë bujqësore (lavërtaria, pemëtaria, bletaria, mbjellja e barit etj.). Komuna, së bashku me Autoritetin Kosovar të pyjeve, do të organizojë pastrimin sanitari të drunjve në zonat pyjore.
- Komuna do të nënshkruajë marrëveshjen e bashkëpunimit me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për veprime të përbashkëta të mbrojtjes së vlerave të monumentit natyror “Mirusha”.
- Komuna, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, do të hartojë planet rregulluese për bregun e lumit si hapësirë publike, që të mbrojë vlerën e peizazhit.
- Të gjitha vlerat natyrore të evidentuara duhet të trajtohen si monumente të mbrojtura të natyrës dhe të mbrohen nga zhvillimet të cilat mund të kenë ndikime negative.
- Komuna, së bashku me MMPH-në, duhet të ndërmerr masat e nevojshme për t'a vënë nën mbrojtje burimin e ujërave minearale në Drsnik dhe Rudicë .
- Komuna, së bashku me MMPH-në, duhet të bëjë evidentimin e peizazheve të cilat duhet të mbrohen.
- Komuna, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, do të ndërmarrë masa për konsolidim të tokës në zonat e deponieve ilegale.

- Komuna, së bashku me Kompaninë Publike Rajonale për menaxhim te mbeturinave, bazuar ne ligjin dhe kompetencat e deleguara, duhet të përmirësojë shërbimet për menaxhim te mbeturinave në Komunën e Klinës dhe vendbanimet tjera.
- Komuna duhet të hartoje Rregulloren për hapësirat e gjelbra dhe politikat për gjelbërim.

#### **4.2.7 MËNYRA E TRAJTIMIT TË HEDHURINAVE**

- Komuna do të hartoje konceptin detaj të Menaxhimit të Mbeturinave për zonën urbane të Klinës dhe sub-qendrave.
- Komuna duhet të ndërtojë një politikë për mbledhjen e materialeve sekondare si dhe për riciklimin e mbeturinave. Komuna e Klinës, së bashku me kompaninë publike rajonale për menaxhimin e mbeturinave, duhet të organizojnë ndarjen, mbledhjen dhe riciklimin e mbeturinave.
- Komuna do të fillojë ndërtimin e sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza. Ajo do të identifikojë dhe alokojë tokën e përshtatshme për nënstacionin e ujërave të zeza, për trajtimin primar të tyre, duke u bazuar në strategjinë për trajtimin e ujërave të ndotura.
- Hedha e mbeturinave dhe ujërave të zeza duhet të jetë e qëndrueshme, duke u përqendruar në prodhimin e energjisë ripërtëritëse dhe biomasës në të gjitha zonat e përcaktuara si zona për prodhimin e energjisë ripërtëritëse.
- Komuna, së bashku me MMPH, do të hartoje programe dhe politika të vetëdijesimit për trajtimin e ujërave, ndotjes, menaxhimit të mbeturinave dhe çështje të tjera lidhur me mjedisin.

#### **4.2.8. MASAT PËR PENGIMIN E NDIKIMEVE TË DËMSHME NË MJEDIS**

- Strategjitet për menaxhimin e mbeturinave duhet të kontrollohen gjithmonë nga komuna, në mënyrë që të shmangen ndikimet në mjedis.
- Projektet zhvillimore në shkallë prej 5 hektarëve, duhet të dëshmojnë që nuk shkaktojnë ndikime në mjedis.
- Gjatë dhënies së lejeve për objekte zhvillimore ekonomike, në pajtim me rregullat mjedisore, duhet të sigurohen masat parandaluese për ndikimet negative në mjedis siç janë ndotja e ajrit dhe zhurma, vibrationet, rezatimi, ndotja e ujit dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis është i nevojshëm për përmbytjet prodhuese.

##### **4.2.8.1 MBROJTJA E UJIT**

- Burimet e ujit duhet të mbrohen. Gjatë dhënies së lejeve për planifikim, me qëllim të mbrojtjes së ujit nëntokësor, është e nevojshme që të rregullohen masat për mbrojtje në vijim:

- Ndërtimi i sistemit të ujërave të zeza me elemente të papërshkueshme nga uji
- Ujërat atmosferik duhet të kanalizohen në sistem të veçantë të drenazhit
- Kujdes të veçantë duhet ti kushtohet drenazhit të ujërave atmosferike në varreza
- Në mënyrë që të mbrohet rrjedha e lumenjve, është e nevojshme të kontrollohen të gjitha shkarkimet dhe të bëhet një inventar i ndotësve.

#### **4.2.8.2 MBROJTJA NGA ZHURMA**

- Në mënyrë që vendbanimet të mbrohen nga ndotja e zhurmës është e nevojshme të ndërtohen pengesa dhe të zhvillohen breza të gjelbër në mes të korridoreve për motoçikleta dhe vendbanimeve.

#### **4.2.8.3 MBROJTJA E AJRIT**

- Në mënyrë që të mbrohet ajri, është e nevojshme që të kontrollohet lokacioni për prodhimin e pajisjeve dhe llojin e teknologjisë, llojin e energjisë dhe të stimulohet energjia e pastër dhe energjia ripërtëritëse.

#### **4.2.8.4 MBROJTJA E SHTAZËVE**

- Meqenëse Klina është e pasur dhe peizazhe kodrinore, është e nevojshme të kontrollohet gjuetia, në mënyrë që të mbrohet zhdukja e specieve shtazore.

#### **4.2.9 MASAT PËR PARANDALIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE SOCIALE**

- Komuna duhet të ofrojë infrastrukturë të nevojshme sociale (edukim, shërbim mjekësor, kulturë, sport) që të shmanget ndikimi negativ social i zhvillimit. Një seri e masave për infrastrukturë duhet të jenë sipas funksionit të vendbanimit (qendra kryesore, sub-qendra, qendra lokale).
- Dendësia e vendbanimit duhet të harmonizohet dhe të jetë në pajtim me zhvillimet sociale të vendbanimit.
- Komuna do të vlerësojë problemet specifike në lidhje me vendbanimet joformale dhe do të propozojë zgjedhje në ato vende ku hartimi i PRRU është prioritet.
- Udhëheqja e projekteve për të kthyerit pas luftës së vitit 1999, do të integrohet në vizionin më të gjërë për zhvillimin e komunës.
- Komuna duhet të ballafaqohet me ndërtimet ilegale konform ligjit të ri mbi ndërtimet ilegale. Për këtë arsyë do të krijohet një bazë e të dhënave, e cila për çdo ngastër do të përmbajë informata të nevojshme në lidhje me lejen e lëshuar.

#### **4.2.10 MASAT PËR ZBATIMIN E PLANIT**

#### **4.2.10.1 DETYRIMI PËR HARTIMIN PLANEVE RREGULLUESE URBANE**

- Sipas ligjit, plani duhet të rishikohet çdo 5 vite. Plani Zhvillimor Komunal duhet të rishikohet në rastin e ndryshimeve thelbësore të kushteve të përgjithshme.
- Plani Zhvillimor Urban duhet të rishikohet çdo 5 vite, edhe pse komuna e ka bërë rishikimin e parë.
- Planet Rregulluese Urbane duhet të hartohen për Zllakuqan, Gllarëv, Grabanicë dhe Sferkë.
- Prioritet duhet ti jepet zonave ku problemet hapësinore duhet të adresohen urgjentisht. Kjo përfshin zonat ku kërkon zhvillimi i brendshëm apo ku qyteti rritet në mënyrë të pakontrolluar dhe të paorganizuar dhe ku rigjenerimi i hapësirave publike është nevojë prioritare.
- Lejet ndërtimore për zhvillimet jashtë zonës urbane, mund të lëshohen sipas vendimeve me Plan Zhvillimor Komunal.
- Për çfarëdo zhvillimi jashtë zonës urbane, më të madhe se 2.0 ha, duhet të hartohen planet rregulluese. Kjo përfshin hapësirat për park të biznesit/industrial, hapësirat për zhvillimin e turizmit dhe hapësirat për sport dhe rekreacion.

#### **4.2.10.2 APLIKIMI I MASAVE ZHVILLIMORE DHE I MASAVE TJERA**

- Komuna duhet ta konsiderojë prioritet hartimin e kadastrit të ri modern, si bazë për hartimin Planeve Rregulluese Urbane dhe zhvillimin e mëtutjeshëm. Qendrës kryesore – Klinës dhe katër sub-qendrave do ti jepet prioritet në këtë aspekt.
- Kur vendoiset për zhvillime, prioritet duhet të kenë zhvillimet që paraqesin densifikim apo zgjerim gradual të zonave ekzistuese për ndërtim.
- Planet rregulluese duhet të ofrojnë masa mbrojtëse kundër zjarrit. Këto masa përfshijnë rrjetin për shuarjen e zjarrit në të gjitha pozitat e ndërtesave, qasje të lehtë për kamionët e zjarrfikësve dhe hapësirë për manovrimin e teknologjisë kundër zjarrit sipas rregullave ekzistuese për mbrojtje kundër zjarrit.

#### **4.2.10.3 RIKONSTRUKTIMI I NDËRTESAVE, DESTINIMI I SË CILAVE ËSHTË NË KUNDËRSHTIM ME DESTINIMIN E PLANIFIKUAR**

- Ndërtesat ekzistuese në zonat e gjelbra nuk duhet lejuar të zgjerohen përmes rindërtimit.
- Problemët specifike në lidhje me vendbanimet joformale do të vlerësohen dhe do të propozohen zgjidhjet sipas direktivave të IPH dhe DPH. Për këtë arsy, duhet të krijohet një bazë e të dhënave, bazuar në një kadastër modern me informata detaje për çdo ndërtesë.

- Rrënimi i ndërtesave, mund të vie në konsiderim në ato raste ku ndërtimet ilegale nuk mund të legalizohen sipas Ligjit mbi ndërtimet ilegale.
- Komuna do të ofrojë një lokacion për ndërtimin e shtëpive të reja për njerëzit që duhen ti lëshojnë shtëpitë e tyre në rast të rrënimeve. Gjatë zbatimit të planit, nëse kërkohet, ndërtesat e ndërtuara legale mund të largohen pas shpronësimit apo marrëveshjes me pronarin. Në këtë rast komuna duhet të ofrojë kompensim të mirëfilltë.

#### **4.3. DISPOZITAT LIDHUR ME KONSULTIMIN, BASHKËPUNIMIN DHE PJSËMARRJEN;**

##### **4.3.1 Përmirësimi i përfshirjes, pjesëmarrjes dhe vetëdijesimi**

- Zbatimi dhe përforcimi i planeve zhvillimore dhe planeve rregullative do të jetë i suksesshëm vetëm nëse komuna do të krijojë përkrahje të mjaftueshme dhe mirëbesim midis qytetarëve të saj për këto aktivitete.
- Në mënyrë që të forcohet njohuria e qytetarëve dhe të rritet mbështetja e tyre për planifikim dhe zbatim të planeve, duhet të organizohen fushata mediale me qytetarë.

##### **4.3.2 Centralizimi i informatave hapësinore**

- Informatat hapësinore në dispozicion, do të centralizohen dhe integrohen në Sistemin Gjeografik të informatave (GIS), i cili duhet të plotësohet të paktën nga të gjitha drejtoritë e administratës komunale.

##### **4.3.3 Leja ndërtimore**

- Procesi i ofrimit të lejes apo refuzimit të kërkesës për leje, përfshirë garancinë për rolet transparente të të gjitha palëve me interes (aplikuesit, banorët, palët tjera me interes dhe administrata), do të përmirësohen përmes qartësimit të procedurave.
- Lejet ndërtimore mund të lëshohen vetëm nga PRRU (planet rregulluese urbane). Një bazë adekuate e të dhënavët në GIS-it, duhet të asistojë në procesin e lëshimit të lejeve. Ky aktivitet duhet realizuar në bashkëpunim me sektorin për Gjeodezi dhe Kadastër.

##### **4.3.4 Vlerësimi dhe monitorimi**

- Plani Zhvillimor Komunal do të vlerësohet në mënyrë të rregullt (një herë në dy vjet, përvèç nëse ka ndonjë kërkesë të veçantë). Gjatë vlerësimit, duhet të merren parasysh zhvillimet aktuale, të dhëna më të kompletuara demografike, të dhëna në lidhje me nevojat për banim dhe faktorë të tjerë ekonomik.
- Çdo pesë vite plani duhet të revidohet në tërsi.

— Në mes të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe AKM-së ka qenë dakorduar e ashtuquajtura “procedura për shkëmbimin e tokave”, në lidhje me kërkesat komunale për të siguruar tokë shoqërore për projektet e interesit publik. Një marrëveshje e tillë, pas shuarjes së AKM, duhet të vazhdojë edhe me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP). Kjo politikë udhëzon që kërkesat të vlerësohen “rast për rast”, ku ndërmarrjet në pronësi shoqërore do të kompensohen në mënyrë të duhur për cilëndo pronë të tyre që do ti transferohet komunës.

#### **4.3.5 Bashkëpunimi**

- Komuna, sipas procedurave ekzistuese administrative, do të ndërtojë bashkëpunim të nevojshëm në mes institucioneve të ndryshme lokale dhe departamenteve, dhe institucioneve në nivelin qendror, në mënyrë që të sigurohet zbatimi i planit.
- Komuna, sipas interesit, do të ndërtojë marrëveshje bashkëpunimi me komunat fqinje dhe komunat në rajon, në mënyrë që të zgjedhin çështjet e përbashkëta, të rëndësishme për jetën e banorëve.
- Komuna, do të bashkëpunojë me institucionet nacionale- institutet zhvillimore dhe kërkimore, që mund të kontribuojnë në procesin e planifikimit dhe zbatimin e planit.
- Komuna duhet të themelojë bashkëpunim të mirëfilltë me shoqatat e organizatave civile në mënyrë që të sigurojë procedurë transparente të procesit të planifikimit.

#### **4.4 DISPOZITAT MBI RENDIN KRONOLOGJIK APO ETAPAT E IMPLEMENTIMIT**

Buxhetimi i shpenzimeve komunale sipas PZHU-së dhe PZHK-së

- Planifikimi i investimit komunal në lidhje me ato investime me komponent hapësinor (duke përfshirë aktivitetet e planifikimit, punët publike, shpërndarja e shërbimeve publike, banimi dhe ndërtimet tjera), do të bazohen veprimet prioritare të definuar nga autoritetet komunale në procesin e planifikimit e të dy draft planeve Plani Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe Urban (PZHU).
- Brenda tre muajve pas miratimit final të dy planeve Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban të reviduar, Kuvendi Komunal duhet të miratojë një plan buxhetor shtesë i cili qartë paraqet se si planet e zbatuara do të financohen brenda tri viteve të ardhshme. Ky plan buxhetor do të definojë financimin dhe procesin e hartimit të Planeve Regulluese dhe dokumente shtesë të politikave dhe studimet e nevojshme për zbatimin e planit.
- Tre muaj pas miratimit final të PZHK-së, Komuna do të rishikojë të gjitha politikat sektoriale në mënyrë që ti harmonizojë ato më dispozitat e Planit Zhvillimor Komunal.

#### **4.5 DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

##### **4.5.1 HYRJA NË FUQI**

— Ky plan do të jetë i efektshëm 8 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

##### **4.5.2 VALIDITETI / VLEFSHMËRIA**

— Ky plan do të jetë valid së paku për **5 (10)** vite

##### **4.5.3 ELEMENTET DHE UDHËZIMET PËR HULUMTIM TË MËTUTJESHËM.**

Hulumtimet, politikat dhe planet shtesë që duhet të hartohen

- Kadastro
- Koncepti i zhvillimit ekonomik
- Plani i politikës së mobilitetit dhe trafikut
- Plani i veprimit në mjedis (me fokus të veçantë në ndotjen e ujit, impiantet për pastrimin e ujit dhe ujërave të zeza, politika për tokat pyjore, menaxhimi i mbeturinave dhe të tjera)
- Shqyrtim i mëtutjeshëm i zonave të trashëgimisë kulturore dhe natyrore- zonat arkeologjike dhe shpellat
- Plani i zhvillimit të turizmit
- Plani i rrjetit të gjelbërimit
- Planet detaje të infrastrukturës teknike - Sistemi për furnizim me ujë dhe kanalizimi

**ANEKS****Përbajtjet në vendbanimet****REFERENCAT**

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Instituti i Planifikimit Hapësinor (2010) **PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS-STRATEGJIA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR 2010-2020.**
- “**STRATEGJIA PËR ZHVILLIM RAJONAL PËR RAJONIN EKONOMIK PERËNDIM**”. Projekt i finansuar nga BE-ja , menaxhuar nga zyrja ndërlidhëse e Komisionit Evripian dhe implementuar nga ËEST Regional Development Agency .
- N. Jeëell, E.Krasniqi, A.Kusel, A. Zhuri (2007)**PROJEKTI PËR MENAXHIMIN E TOKËS BUJQËSORE-PLANI PËR MENAXHIMIN E TOKAVE RURALE NË KLINË .**
- Kuvendi Komunal i Klinës &Urban Plus (2005) **PLANI ZHVILLIMOR URBAN- KLINË..**
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- Instituti për Planifikimi Hapësinor (2012) “**Draft Plani Hapësinor- Monumenti i natyrës me rëndësi të veçantë ‘Ujëvarat e Mirushës”**
- International Civilian Office-ICO “**Implementation of Special Protective Zones for Religious and Cultural Heritage in Kosovo**”- Progress report. September 2011.
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2010) “**Raporti i gjendjes se vendbanimeve joformale në Kosovë”**